

Haxhere Dervisholli - Zylfiu

**TRAJNIMI I
MËSIMDHËNËSVE PËR
PROGRAMIN E ECDL-SË**
(zbatimi dhe ndikimi në
mësimdhënie dhe nxënie)

Prishtinë, 2013

M.Sc. Haxhere Dervisholli - Zylfiu

**TRAJNIMI I MËSIMDHËNËSVE PËR PROGRAMIN E
ECDL-SË**
(zbatimi dhe ndikimi në mësimdhënie dhe nxënie)

Raport i studimit kërkimor

Prishtinë, 2013

Botues

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Autor:

M.Sc. Haxhere Dervisholli - Zylfiu

Kryeredaktor:

M.Sc. Nezir Çoçaj

Bashkëpunëtorë profesionalë:

M.Sc. Selim Mehmeti

Sahare Reçica

Ekipi hulumtues:

M.Sc. Haxhere Dervisholli - Zylfiu

Sahare Reçica

Arbneshë Mexhuani

Lektor:

Bekim Morina

Përgatitja teknike:

Skender Mekolli

*Shprehim falënderime për drejtorët e shkollave,
mësimdhënësit, nxënësit dhe të gjithë ata që kontribuuan në
realizimin e këtij studimi!*

Përmbajtja

Shkurtesat	5
Tabela dhe figura	6
Përmbledhje	8
I. Hyrje	14
1.1. Konteksti i studimit	14
1.2. Metodologjia e studimit	17
1.2.1. Qëllimi dhe objektivat e studimit	17
1.2.2. Popullacioni dhe mostra	18
II. Përfshirja, përfitimet dhe certifikimi i personelit arsimor në programin e ECDL-së	23
III. Rezultatet e studimit në terren	35
3.1. Rezultatet e dala nga hulumtimi i realizuar me drejtorë/zv.drejtorë të shkollave	36
3.1.1. Të dhëna personale të drejtorëve/zv.drejtorëve, kalueshmëria në modulet e programit të ECDL-së.....	36
3.1.2. Niveli i kënaqësisë së i drejtorëve/zv.drejtorëve për programit të ECDL-së	38
3.1.3. Zbatimi i njohurive dhe shkathtësive të reja të përfituara përmes programit të ECDL-së.....	39
3.1.4. Ndikimi i trajnimit të mësimitdhënësve për programin e ECDL-së në praktikat e mësimitdhënies dhe nxënies	43
3.1.5. Mbështetja që u ofrohet mësimitdhënësve për zbatimin e TIK-ut në procesin e mësimitdhënies dhe nxënies	47
3.1.6. Kërkesat/nejovat e drejtorëve/zv.drejtorëve lidhur me realizimin praktik të njohurive dhe shkathtësive të reja në procesin e mësimitdhënies dhe nxënies	51
3.2. Rezultatet e dala nga hulumtimi i realizuar me mësimitdhënës	54

3.2.1. Të dhëna personale të mësimitdhënësve, kalueshmëria në modulet e programit të ECDL-së	54
3.2.2. Njohuritë dhe shkathtësitë e mësimitdhënësve për përdorimin e kompjuterit dhe programeve të tij para dhe pas trajnimit	57
3.2.3. Zbatimi i TIK-ut dhe programeve të tij nga ana e mësimitdhënësve	58
3.2.4. Ndikimi i trajnimit të mësimitdhënësve për programin e ECDL-së në procesin e mësimitdhënies dhe nxënies.....	73
3.2.5. Kërkesat/nevojat e mësimitdhënësve për realizimin praktik të njohurive dhe shkathtësive të reja në praktikat e mësimitdhënies dhe nxënies	78
3.3. Rezultatet e dala nga hulumtimi i realizuar me nxënës.....	79
3.3.1. Rezultatet e hulumtimit të realizuar me nxënësit e klasës së pestë	80
3.3.2. Rezultatet e hulumtimit të realizuar me nxënësit e klasës së nëntë	83
3.3.3. Rezultatet e hulumtimit të realizuar me nxënësit e klasës së dymbëdhjetë	88
IV. Përfundime dhe rekomandime	94
Referencat	104
Shtojca	105

SHKURTESAT

AUK	Universiteti Amerikan në Kosovë
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
ECDL	Patenta Evropiane për Përdorimin e Kompjuterit (European Computer Driving License)
SPSS	Statistical analysis in Social Science
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë
IPK	Instituti Pedagogjik i Kosovës
KKK	Korniza e Kurrikulës së Kosovës
KB	Kurrikula Bërthamë
MASHT	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
PSAK	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë
SMIA	Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim
SNKA	Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit (UNESKO-ISCED)
TIK	Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit

Tabela dhe figura

Tabela 1	<i>Specifikat e mostrës për një rajon</i>
Tabela 2	<i>Përfshirja në raport me të dhënat e MASHT-it-SMIA-s</i>
Tabela 3	<i>Përfshirja sipas lëndës/angazhimit</i>
Tabela 4	<i>Certifikimi sipas lëndës/angazhimit, niveleve të certifikimit dhe përfshirjes</i>
Tabela 5	<i>Certifikimi për programin e ECDL-së sipas komunave në raport me përfshirjen</i>
Tabela 6	<i>Përfshirja dhe kalueshmëria në modulet e ECDL-së</i>
Tabela 7	<i>Rangimi sipas numrit (përqindjes) së kalueshmërisë në modulet e ECDL-së</i>
Tabela 8	<i>Shpërndarja e mostrës së drejtorëve, zv.drejtorëve të përgjigjur në pyetësorë</i>
Tabela 9	<i>Të përfshirë në modulën përkatës</i>
Tabela 10	<i>Niveli i kënaqësisë së drejtorëve, zv.drejtorëve lidhur me ECDL-në</i>
Tabela 11	<i>Përqindja e përgjigjeve lidhur me zbatimin e njohurive dhe</i>
Tabela 12	<i>Zbatimi i njohurive dhe shkathtësive të përfituara përmes programit të ECDL-së</i>
Tabela 13	<i>Përqindja e përgjigjeve lidhur me për ndikimin e trajnimit në proces</i>
Tabela 14	<i>Ndikimi trajnimit të mësimdhënësve për programin e ECDL-së</i>
Tabela 15	<i>Përqindja e përgjigjeve lidhur me kushtet/bashkëpunimin që ofron shkolla</i>
Tabela 16	<i>Mbështetja e ofruar në funksion të realizimit praktik të njohurive dhe shkathtësive</i>
Tabela 17	<i>Përqindja e përgjigjeve lidhur me kërkesat/nevojat e mësimdhënësve</i>
Tabela 18	<i>Ndonjë koment</i>
Tabela 19	<i>Mosha dhe kualifikimi i mësimdhënësve të përfshirë në studim</i>
Tabela 20	<i>Mostra e mësimdhënësve specifikuar në fushën mësimore/lëndën</i>
Tabela 21	<i>Të dhënat për kalueshmërinë e moduleve përkatëse nga ana e mësimdhënësve</i>
Tabela 22	<i>Njohuritë dhe shkathtësitë para dhe pas trajnimit</i>

Tabela 23	<i>Zbatimi i njohurive dhe shkathtësive të reja në praktikat e mësimdhënies dhe nxënies</i>
Tabela 24	<i>Zbatimi i njohurive dhe shkathtësive të reja specifikuar në tipin/profilin e shkollës</i>
Tabela 25	<i>Angazhimi i nxënësve për përdorimin e TIK-ut dhe programeve të tij</i>
Tabela 26	<i>Angazhimi i nxënësve krahasuar me profilin/lëndën mësimore</i>
Tabela 27	<i>Kushtet që ofron shkolla për zbatimin e njohurive dhe shkathtësive të reja</i>
Tabela 28	<i>Kushtet që ofron shkolla krahasuar me tipin/profilin e shkollës përkatëse</i>
Tabela 29	<i>Alternativat kur shkolla nuk ofron aparaturën e TIK-ut</i>
Tabela 30	<i>Mbështetja bashkëpunuese brenda shkollës</i>
Tabela 31	<i>Ndikimi i trajnimit të mësimdhënësve në procesin e mësimdhënies dhe nxënies</i>
Tabela 32	<i>Ndikimi i trajnimit të mësimdhënësve specifikuar në tipin/profilin e shkollës</i>
Tabela 33	<i>Kërkesat/nevojat e mësimdhënësve për zbatim të TIK-ut</i>
Tabela 34	<i>Struktura e nxënësve të përfshirë në studim</i>
Tabela 35	<i>Përdorimi i programeve kompjuterike nga nxënësit</i>
Tabela 36	<i>Angazhimi i nxënësve të klasës së nëntë për përdorim të TIK-ut</i>
Tabela 37	<i>Përdorimi i TIK-ut dhe programeve kompjuterike nga nxënësit</i>
Tabela 38	<i>Njohuritë dhe shkathtësitë e nxënësve për përdorimin e programeve kompjuterike</i>
Tabela 39	<i>Zbatimi i programeve kompjuterike nga mësimdhënësit e lëndëve përkatëse</i>
Tabela 40	<i>Përdorimi i pajisjeve të TIK-ut nga ana e mësimdhënësve</i>
Tabela 41	<i>Angazhimi i nxënësve të klasës së dymbëdhjetë nga mësimdhënësit e tyre</i>
Tabela 42	<i>Përdorimi i TIK-ut dhe programeve kompjuterike nga nxënësit</i>
Tabela 43	<i>Njohuritë dhe shkathtësitë e nxënësve për përdorimin e programeve kompjuterike</i>
Tabela 44	<i>Zbatimi i programeve kompjuterike nga mësimdhënësit e lëndëve përkatëse</i>
Figura 1.	<i>Mësimdhënësit 2012/2013 dhe përfshirja në programin e ECDL-së</i>

Përmbledhje

Studimi *Trajnimi i mësimdhënësve për programin e ECDL-së (zbatimi dhe ndikimi në mësimdhënie dhe nxënie)* u realizua nga hulumtuesit e Institutit Pedagogjik të Kosovës, me autorizimin e Këshillit Shkencor.

Objektiv i studimit ishin personeli arsimor i përfshirë në trajnimin për programin e ECDL-së, kurse qëllimi i studimit është analiza e përfshirjes dhe përfitimit të stafit arsimor nga trajnimi për programin e ECDL-së, zbatimi dhe ndikimi i trajnimit në procesin e mësimdhënies dhe nxënies.

Metodologjia e studimit konsiston në një analizë cilësore dhe sasiore të gjendjes aktuale në fushën e trajnimit për programin e ECDL-së dhe rezultatet në shkolla në raport me këtë trajnim. Të dhënat kualitative janë marrë nga burime të shumta, duke përfshirë të dhënat nga shqyrtimi i literaturës, raporteve narrative të trajnimeve dhe raporteve statistikore. Të dhënat sasiore janë marrë nga pyetësorët e anketës dhe intervistës, të administruar në shkolla me drejtorë, zv.drejtorë, mësimdhënës dhe nxënës.

Studimi u realizua në nëntë komuna të Kosovës: Prishtinë, Fushë-Kosovë, Pejë, Prizren, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Mitrovicë dhe Vushtrri. Në studim janë përfshirë 4 shkolla nga secili rajon i Kosovës.

Të gjeturat më të rëndësishme nga studimi janë përmbledhur në këtë raport, i cili është përgatitur me qëllim të pasqyrimin të: (i) përfshirjes dhe përfitimit të stafit arsimor të arsimit parauniversitar nga trajnimi për programin e ECDL-së, (ii) zbatimit të njohurive dhe shkathtësive të reja për TIK-un në procesin e mësimdhënies dhe nxënies, (iii) ndikimeve të para të trajnimit për këtë program në procesin e mësimdhënies dhe nxënies dhe (iv) identifikimit të mundësive për avancim të

zbatimit dhe ndikimit sa më efektiv të njohurive dhe shkathtësive të reja për TIK, të përfituara përmes programit të ECDL-së në procesin e mësimdhënies dhe nxënies në të ardhmen.

Lidhur me përfshirjen dhe kalueshmërinë e stafit arsimor në trajnimin për programin e ECDL-së, analiza e bazës statistikore *TeachECDL - AUK MasterFile 2013* tregon se:

- Nga 28254, sa ka qenë gjithsej numri i personelit arsimor i angazhuar në arsimin parauniversitar në vitin akademik 2012/2013, në nivel vendi, në programin e ECDL-së (2009-2013) kanë qenë të përfshirë gjithsej 12960 (45,87%);
- Nga numri i përgjithshëm i të përfshirëve, 6939 (53,54 %) e tyre kanë arritur të certifikohen për nivelet e programit (ECDL Start ose ECDL Core), ndërsa, bazuar në llojin e certifikimit të fituar, rezulton se 3140 (45,25%) e stafit përfitues në këtë program janë certifikuar për nivelin e *ECDL Start*, kurse 3799 (62,44%) janë certifikuar për nivelin e ECDL Core;
- Mbi baza komunale, përqindja më e madhe e përfshirjes në programin e ECDL-së ka qenë në Mitrovicë, Prishtinë dhe Prizren;
- Mbi bazën e angazhimit/lëndës mësimore që realizon në shkollë, certifikimi në raport me përfshirjen ka qenë: mësimdhënës të matematikës 70,34%, mësimdhënës të gjuhëve të huaja 65,90% dhe mësimdhënës/edukatorë të nivelit parashkollorë/parafillorë 65,22%. Specifikuar në nivele të certifikimit kemi këtë raport:

- ECDL Start: mësimdhënës të ciklit klasor 24,27%, të shkencave të natyrës (Biologji, Fizikë, Kimi) dhe të shkencave shoqërore (Gjeografi, Ed. qytetare, Histori, Pedagogji, Sociologji, etj) 9,14%, si dhe mësimdhënës të lëndëve profesionale 7,83%;
- ECDL Core: mësimdhënës të ciklit klasor 26,43%, të lëndëve profesionale 10,87%, si dhe mësimdhënës të Matematikës 10,66% të certifikuar.
- Krahasuar mbi bazën komunale, përqindje më të lartë të të certifikuarve ka:
 - ECDL Start: komuna e Prishtinë 12,68%, e Prizrenit 13,98% dhe komuna e Gjilanit 8,15% të certifikuar;
 - ECDL Core: komuna e Prishtinës 16,16%, e Prizrenit 10,80% dhe komuna e Gjilanit 10,45% të certifikuar.

Lidhur me përfitimet nga përfshirja dhe trajnimi për programin e ECDL-së, rezultatet e studimit tregojnë se nga drejtorët/zv.drejtorët dhe mësimdhënësit e përfshirë në studim para trajnimit për programin e ECDL-së janë theksuar njohuri dhe shkathtësi më të mëdha në përdorimin e internetit, ndërsa trajnimi ka ndihmuar më shumë në zhvillimin e njohurive dhe shkathtësive në programin e Word-it. Megjithatë, nga ndikimi i trajnimit janë evidentuar lëvizje pozitive të përfitimeve në të gjitha programet bazë kompjuterike: Word, Excel, Power Point, Internet, Access.

Sa i përket zbatimit të njohurive dhe shkathtësive të përfituara në praktikën e mësimdhënies dhe nxënies, sipas drejtorëve/zv.drejtorëve të përfshirë në studim reflekton zbatueshmëri në: (i) përgatitjen e materialeve për prezantim dhe prezantimin e

tyre me projektor, (ii) hartimin e raporteve të punës dhe bazës së të dhënave statistikore, (iii) hartimin e planeve të punës, (iv) komunikimin me prindër në e-mail, (v) hartimin e testeve për vlerësim të nxënësve etj.

Sipas mësimdhënësve, zbatimi i përvojave të trajnimit në programin e ECDL-së, në praktikat e mësimdhënies dhe nxënies, është i reflektuar në (i) hulumtimet në internet për materiale mësimore dhe përgatitjen e tyre për mësim, (ii) planifikim të orëve mësimore, (iii) përgatitje të testeve për realizim me nxënës, (iv) prezantim të materialeve, (v) përgatitje e raporteve, (vi) komunikim me kolegë, nxënës, prindër (në shkollat profesionale).

Pavarësisht se një numër relativisht i madh i personelit arsimor i përfshirë në trajnime ka treguar rezultate mesatare në testet e programit të ECDL-së, vërehet zbatim jo i kënaqshëm i njohurive dhe i shkathtësive të fituara në këto praktika. Arsyetimet për moszbatueshmëri të plotë të njohurive dhe shkathtësive të reja në procesin e mësimdhënies dhe nxënies janë të ndryshme, si: ndjenja e pasigurisë për përdorimin e pajisjeve dhe programeve kompjuterike, ndjenja e “rehatisë” me mësimdhënie pa përdorim të teknologjisë së informacionit në procesin arsimor, ndikimi jo i mirë i përdorimit të TIK-t dhe programeve kompjuterike në suksesin e nxënësve, mungesa e pajisjeve të TIK-ut në shkollë etj.

Lidhur me ndikimin që ka trajnimi i mësimdhënësve për programin e ECDL-së në praktikat e mësimdhënies dhe nxënies, drejtorët/zv.drejtorët, mësimdhënësit dhe nxënësit e përfshirë në studim ndajnë opinione të ndryshme. Në përgjithësi, ekziston opinioni se, përveç ndikimit që trajnimi ka pasur te personeli arsimor i përfshirë në këtë program, ai ka ndikuar edhe në punën e nxënësve, sidomos të atyre nxënësve

mësimdhënësit e të cilëve i kanë zbatuar në praktikat e mësimdhënies dhe nxënies njohuritë dhe shkathtësitë e përfituara nga programi i ECDL-së. Te nxënësit ndikimi i këtij programi ka dalë të jetë më i madh në angazhimin e tyre për hulumtimin e materialeve mësimore në internet (Gjuhë amtare, Gjuhë angleze, shkenca shoqërore, shkencat e natyrës, arte, lëndë profesionale), si dhe në forma të ndryshme të komunikimit me e-mail.

Vazhdimi i përkrahjes së mësimdhënësve në zhvillimin e kompetencave të tyre për përdorimin e TIK-ut dhe programeve kompjuterike në procesin e mësimdhënies dhe nxënies është proces që kërkon krijimin e mekanizmave të qëndrueshëm për mbështetje dhe azhurnim të inovacioneve në fushën e TIK-ut. Rol të veçantë duhet të luajnë MASHT-i, DKA-ja dhe shkollat, prandaj, bazuar në rezultatet e studimit dhe në identifikimin e nevojave/kërkesave për mbështetje, rekomandojmë:

- ✚ **MASHT-i** të vazhdojë me trajnimin e të gjithë mësimdhënësve të arsimit parauniversitar të Kosovës për programin e ECDL-së, të mentorojë dhe të monitorojë punën e mësimdhënësve të certifikuar për programin e ECDL-së dhe të iniciojë programe trajnimi për mbështetjen e vazhdueshme të mësimdhënësve në funksion të zbatimit të njohurive dhe shkathtësive të reja të përfituara përmes programit të ECDL-së në procesin e mësimdhënies dhe nxënies.
- ✚ **DKA-të** të pajisin shkollat me infrastrukturë të teknologjisë (kompjuterë, lloptopë, fotokopje, projektorë, bimerë etj.), në rastet kur mungojnë ato, si dhe të themelojnë organizma për mbikëqyrjen dhe funksionalizimin e pajisjeve të TIK-ut në shkollat që

tanimë e kanë një sistem të tillë të pajisjeve; të mbështesin shkollat me sistem funksional të rrjetit të internetit, t'i japin prioritet zhvillimit profesional të stafit të mësimit dhe drejtorëve të shkollave për TIK-un;

- ✚ **Shkollat** të angazhohen për ngritjen/shfrytëzimin e kapaciteteve profesionale brenda shkollave për mbështetjen e mësimit dhe nxënies (trajnimi me bazë në shkollë). Po ashtu, të themelojnë mekanizma për mbikëqyrjen dhe funksionalizimin e pajisjeve të TIK-ut, të iniciojnë bashkëpunimin me prindërit, nxënësit dhe komunitetin e shkollës për fuqizimin e zbatimit të njohurive dhe shkathtësive për TIK dhe programe kompjuterike në procesin e mësimit dhe të nxënies.

I. Hyrje

Raporti paraqet rezultatet e studimit *Trajnimi i mësimdhënësve për programin e ECDL-së (zbatimi dhe ndikimi në mësimdhënie dhe nxënie)*.

Në fokus të studimit ishte personeli arsimor i përfshirë në trajnimin për programin e ECDL-së, kurse qëllimi i studimit ishte analiza e përfshirjes dhe përfitimit të stafit arsimor nga trajnimi për programin e ECDL-së, zbatimi dhe ndikimi i trajnimit në procesin e mësimdhënies dhe nxënies.

Meqenëse që nga viti 2009 MASHT-i ka filluar me realizimin e trajnimit të personelit arsimor për programin e ECDL-së, kemi menduar se tani, pas katër vjetësh të kësaj realizueshmërie, është me rëndësi të vlerësojmë aspekte të përgjithshme të këtij trajnimi, rezultatet e para në shkolla, si dhe zbatueshmërinë dhe ndikimet në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies. Prandaj, mendojmë se studimi sjell të dhëna mjaft të rëndësishme lidhur me aspektet e lartpërmendura, si dhe mund të shërbejë në funksion të avancimit të identifikimit të mundësive për zbatimin praktik të njohurive dhe shkathtësive të reja në proces.

1.1. Konteksti i studimit

Në shoqërinë e sotme, me ndryshime të përshpejtuara, kur njohuritë dyfishohen brenda pak vjetësh, zbatimi i teknologjisë së informimit dhe komunikimit zë vend parësor. Puna efikase me kompjuter tanimë shihet si çelësi i suksesit të çdo individi në profesion dhe në jetë. Përcjellja e proceseve të reja zhvillimore në çdo fushë të jetës, duke përfshirë edhe

zhvillimet në fushën e dijeve dhe arsimimit, janë të lidhura ngushtë me zhvillimin e vazhdueshëm të këtyre njohurive dhe shkathtësive.

Duke marrë për bazë mundësitë e mëdha që ofron teknologjia informative për avancim profesional dhe për zhvillimin e dijeve, MASHT-i e ka përfshirë në politikat strategjike arsimore ngritjen e kapaciteteve të mësimitdhënësve për përdorimin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit në mësimitdhënie dhe nxënie. Kësaj kërkesë dhe nevojë i është dhënë mjaft prioritet në Strategjinë për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar 2007-2017 dhe në Planin Strategjik të Sektorit të Arsimit në Kosovë, 2011-2016.

Në këtë funksion, që nga viti 2009, MASHT-i e ka kontraktuar Universitetin Amerikan të Kosovës (AUK) për realizimin e programit të trajnimit, programin e ECDL-së, me mësimitdhënës dhe përmes trajnimit mësimitdhënësve u jepet mundësia të aftësohen për njohjen e koncepteve themelore të teknologjisë informative dhe për zhvillimin e njohurive dhe shkathtësive të tyre për përdorimin e kompjuterit dhe programeve të tij. Realizimi i programit të trajnimit është i shtrirë në gjithë Kosovën, me mundësi të përfitimit nga të gjithë mësimitdhënësit të angazhuar në arsimin parauniversitar të Kosovës. Deri më tani, këtë program të trajnimit e kanë vijuar përafërsisht 15000 mësimitdhënës të komunave të ndryshme të Kosovës.

Duke u nisur nga perspektivat, mundësitë dhe sfidat e zbatimit të ECDL-së në kurrikula dhe mësimitdhënie, në vitin 2011, IPK-ja e ka realizuar fazën e parë të studimit “*ECDL - mundësi e përfitimit dhe e certifikimit të kompetencave për TIK*” dhe kanë dalë rezultate mjaft të rëndësishme, të bazuara në studimin e përvojave ndërkombëtare (Austrië dhe Zvicrës) për integrimin e ECDL-së në kurrikulat mësimore, studimin e programeve ekzistuese të TIK-ut në arsimin parauniversitar në Kosovë dhe

përfaqësimin e TIK-ut në programet mësimore, si dhe rezultate nga testimi i kompetencave të nxënësve/studentëve për përdorimin e kompjuterit. Rezultatet e studimit janë të publikuara në përmbledhjen e studimeve *“Zhvillimi i kompetencave për TIK dhe Gjuhë angleze – perspektivë për integrim në epokën digjitale* i veçantë (IPK - 2012), i cili ka për qëllim informimin e komunitetit arsimor në Kosovë për çështjet e trajtuara në studim, si dhe nxitjen e një debati të brendshëm të palëve me interes në fushën e arsimit mbi veprimet e nevojshme që duhet të ndiqen për përfshirjen ECDL-së në kurrikula mësimore.

Në vitin 2013, bazuar në misionin e IPK-së dhe planin e punës për vitin 2013, hulumtuesit e IPK-së përcaktuan realizimin e fazës II të studimit *“Trajnimi i mësimdhënësve për programin e ECDL-së, zbatimi dhe ndikimi në mësimdhënie dhe nxënie”*, si prioritet me rëndësi të veçantë dhe aktual me zhvillimet në arsimin parauniversitar, me theks të veçantë për zhvillimet në implementimin e Kornizës së Kurrikulës së Kosovës në arsimin parauniversitar në Kosovë.

Faza e dytë e studimit *“Trajnimi i mësimdhënësve për programin e ECDL-së, zbatimi dhe ndikimi në mësimdhënie dhe nxënie”* përfshin analizën e bazës së të dhënave *TeachECDL - AUK MasterFile 2013*, lidhur me përfshirjen, përfitimet dhe certifikimin e mësimdhënësve të arsimit parauniversitar të Kosovës në programin e ECDL-së, si dhe realizimin e studimit në terren me drejtorë/zv.drejtorë të shkollave, mësimdhënës dhe nxënës të nivelit fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë të arsimit parauniversitar në Kosovë, lidhur me fushën e studimit.

Realizimi i studimit ka lidhshmëri të ngushtë me prioritetet e caktuara nga MASHT-i, veçanërisht me objektiven 5.7. të *Planit strategjik të arsimit në Kosovë (PSAK) 2011-2016*:

Teknologjia e Informimit dhe e Komunikimit, Kornizën e Kurrikulës së Kosovës (2011), e cila promovon qasjen e bazuar në kompetenca, Strategjinë e të nxënit elektronik, si dhe me përkushtimin e Kosovës për plotësimin e Strategjisë Evropiane 2020.

1.2. Metodologjia e studimit

Metodologjia e studimit konsiston në një analizë cilësore dhe sasiore të gjendjes aktuale në fushën e trajnimit për programin e ECDL-së dhe rezultatet në shkolla në raport me këtë trajnim. Të dhënat kualitative janë marrë nga burime të shumta, duke përfshirë të dhënat nga shqyrtimi i literaturës, raporteve narrative të trajnimeve dhe raporteve statistikore. Të dhënat sasiore janë marrë nga pyetësorët e anketës dhe të intervistës, të administruar në shkolla, me drejtorë/zv.drejtorë, mësimdhënës dhe nxënës.

1.2.1. Qëllimi dhe objektivat e studimit

Qëllimi i përgjithshëm i studimit *Trajnimi i mësimdhënësve për programin e ECDL-së (zbatimi dhe ndikimi në procesin e mësimdhënies dhe nxënies)* ishte të kontribuojë në arritjen e objektivave të MASHT-it, që lidhen me zhvillimin e shkathtësive të nxënësve për shekullin 21, në komponentin e TIK-ut, përmes pasqyrimin të të dhënave të përfshirjes dhe përfitimit të stafit arsimor nga trajnimi për programin e ECDL-së, zbatimit në praktikë të njohurive dhe shkathtësive të fituara nga trajnimi dhe ndikimi që ka pasur programi i trajnimit në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies.

Objektivat kryesore të studimit u vendosën:

- Të shqyrtohen dhe të analizohen informatat relevante lidhur me trajnimin e mësimitdhënësve për programin e ECDL-së;
- Të bëhet vlerësimi i zbatimit të njohurive dhe shkathtësive të reja të mësimitdhënësve në procesin e mësimitdhënies dhe të nxënies;
- Të bëhet vlerësimi i ndikimit të zbatimit të njohurive dhe shkathtësive të reja në procesin e mësimitdhënies dhe të nxënies;
- Të evidentohen format e mbështetjes që ofrojnë shkollat në funksion të zbatimit të njohurive dhe shkathtësive të reja në proces;
- Të evidentohen nevojat dhe mundësitë/masat për zhvillimin e kapaciteteve të mësimitdhënësve në fushën e TIK-ut.

1.2.2. Popullacioni dhe mostra

Popullacioni i studimit përfshin drejtorët e shkollave fillore të mesme të ulëta dhe atyre të larta, të e nëntë komunave të Kosovës (Prishtinë, Fushë-Kosovë, Pejë, Prizren, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Mitrovicë dhe Vushtrri), nga të gjitha rajonet Kosovës¹. Mostrën e studimit e përbëjnë drejtorët/zv.drejtorët e shkollave të përfshira në studim, mësimitdhënësit e përfshirë në programin e ECDL-së, si dhe nxënësit e klasave të pesta, të nënta dhe dymbëdhjeta të shkollave përkatëse. Në mostrën e përzgjedhur për realizimin e studimit secili rajon është i përfaqësuar me nga një shkollë fillore (1-5) dhe të mesme të

¹ Lista e komunave dhe shkollave përkatëse të përfshira në studim mund të gjendet te pjesa e shtojcave në fund të librit (shtojca nr.5)

ulët (6-9) me lokacion në fshat dhe një shkollë fillore (1-5) dhe të mesme të ulët (6-9) me lokacion në qytet, si dhe me një shkollë profesionale dhe një gjimnaz. Përveç drejtorit/ zv.drejtorit, secila klasë e përfshirë në studim është e përfaqësuar me 10 mësimdhënës dhe 20 nxënës. Mostra e një rajoni e specifikuar në kategori, lokacion/tip të shkollës për klasë të caktuar, është e paraqitur në tabelën vijuese.

Niveli arsimor	Kategoria	lokacioni		
		fshat	qytet	Gjithsej
Klasa 5	mësimdhënës	10	10	20
	nxënës	20	20	40
Klasa 9	mësimdhënës	10	10	20
	nxënës	20	20	40
Klasa 12	Kategoria	Tipi i shkollës		
		gjimnaz	Shkollë profesionale	Gjithsej
	mësimdhënës	10	10	20
	nxënës	20	20	40

Ndërsa, mostrën e përgjithshme për 7 rajonet e Kosovës e përbëjnë gjithsej 1288 respondentë, me përbërje:

- 28 drejtorë/zv.drejtorë të shkollave;
- 420 mësimdhënës (140 nga klasa e pestë, 140 nga klasa e nëntë dhe 140 nga klasa e dymbëdhjetë);
- 280 nxënës të klasave të pesta;
- 280 nxënës të klasave të nënta;
- 280 nxënës të klasave të dymbëdhjeta.

Instrumentet e hulumtimit

- Baza e të dhënave statistikore për trajnimin e mësimdhënësve për programin e ECDL-së (Teach ECDL- AUK MasterFile 2013);
- Të dhënat statistikore MASHT/SMIA;

- Fletëpyetësi i intervistës;
- Fletëpyetësi i anketës.

Studimi kabinetik prezanton përfshirjen e përgjithshme të stafit arsimor në programin e ECDL-së. Përveç kësaj, për shkollat e përfshira në studim, studimi ofron edhe të dhëna për rezultatet e mësimit në modulet përkatëse të programit, gjë që na shërben për të bërë ndërlidhje me përgjigjet në kërkesat e parashtruara në pyetësorët e realizuar me mësimit dhe nxënës.

Rezultatet e hulumtimit në terren ofrojnë informacione relevante lidhur me objektivat e studimit, në mënyrë të veçantë për ndikimin e trajnimit në zhvillimin e kompetencave të mësimit për përdorimin e TIK-ut, zbatimin të njohurive dhe aftësive të reja të fituara gjatë trajnimit në procesin e mësimit dhe nxënies, mbështetja që ofron shkolla në funksion të zbatimit të njohurive dhe shkathtësive të reja në proces, ndikimi i zbatimit dhe identifikimi i masave për përmirësim të procesit.

Përcaktimi i shkollave për këtë studim është bërë mbi bazën e katër kritereve:

- Secili rajon të jetë i përfaqësuar me një shkollë nga fshati dhe një nga qyteti, me klasën 5-të dhe klasën e 9-të;
- Secili rajon të jetë i përfaqësuar me një gjimnaz dhe një shkollë profesionale, klasa e 12-të;
- Të gjitha shkollat e përfshira të kenë status publik.

Studimi në terren është realizuar gjatë muajve maj dhe qershor 2013. Përzgjedhja e mostrës së nxënësve është bërë krejt rastësore, duke pasur për bazë radhitjen e librit të parë të klasës dhe librit të mesëm, në raftet e shkollës (nga 2 klasë për secilën shkollë), duke filluar me numrin 2 të nxënësit në ditar, për të

vazhduar pastaj me çdo të katërtin nxënës me radhë. Përzgjedhja e mostrës së mësimdhënësve në radhë të parë ka pasur për kriter përzgjedhjen e mësimdhënësve që kanë qenë të përfshirë në programin e trajnimit për ECDL, si dhe përfaqësimi e mësimdhënësve të lëndëve/fushave të ndryshme mësimore.

Çfarë kemi synuar me mostrën e nxënësve?

Me mostrën e nxënësve është synuar të evidentojmë ndikimet e trajnimit të mësimdhënësve të tyre për programin e ECDL-së dhe reflektimin në procesin e mësimdhënies dhe nxënies, gjegjësisht:

- ✓ Kompetencat e nxënësve për përdorimin e programeve bazë kompjuterike dhe mënyra e përfitimit të tyre;
- ✓ Zbatimi i TIK-ut në procesin e mësimdhënies nga ana e mësimdhënësve të tyre;
- ✓ Angazhimi i nxënësve për zbatimin e TIK-ut në procesin e nxënies;
- ✓ Opinionet e nxënësve për rëndësinë e përfitimit të kompetencave për TIK.

Çfarë kemi synuar me mostrën e mësimdhënësve?

Me mostrën e mësimdhënësve kemi synuar të evidentojmë:

- ✓ Ndikimin e trajnimit në ngritjen e kompetencave të tyre për përdorimin e programeve bazë kompjuterike;
- ✓ Zbatimi i TIK-ut në procesin e mësimdhënies dhe nxënies;
- ✓ Identifikimi i mbështetjes që ofron shkolla në funksion të zbatimit të njohurive dhe shkathtësive të reja në proces;
- ✓ Identifikimi i mundësive/masave për avancim të procesit.

Zbatimi i hulumtimit dhe analiza e të dhënave

Synimi ynë ka qenë shfrytëzimi i qasjes sasiore dhe cilësore në realizimin e studimit, duke përfshirë studimin kabinetik, hulumtimin në terren përmes organizimit të punëtorive dhe instrumenteve të hulumtimit me fokus-grupe dhe mostrën e përzgjedhur.

Për analizën e të dhënave teorike u shfrytëzuan metodat e hulumtimit shkencor, si metoda përshkruese, krahasuese, statistikore etj.

Pyetësori i strukturuar u realizua me mostër gjatë muajve maj dhe qershor, ndërsa analiza e të dhënave të grumbulluara përmes administrimit të instrumenteve të krijuara nga ekipi hulumtues u bë përmes programit SPSS -16.

Institucioni dhe personeli

Instituti Pedagogjik i Kosovës është institucion kërkimor – shkencor publik, që merret me hulumtime, trajnime, vlerësime dhe inovacione në fushën e arsimit. Misioni i Institutit Pedagogjik të Kosovës është që t'i ofrojë Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe institucioneve të tjera arsimore mbështetje dhe ekspertizë shkencore e profesionale të mbështetur në rezultatet e punës hulumtuese - kërkimore dhe në praktika të avancuara.

II. Përfshirja, përfitimet dhe certifikimi i personelit arsimor në programin e ECDL-së

Te pjesa e raportit ku është prezantuar metodologjia e studimit kemi potencuar se një ndër instrumentet për realizimin e studimit tonë ka qenë baza e të dhënave statistikore për trajnimin e mësimeve për programin e ECDL-së (TeachECDL- AUK MasterFile, 2013). Në vitin 2012, IPK-ja e ka nënshkruar dokumentin e marrëveshjes për ndarjen e të dhënave mes Institutit për Zhvillim dhe Trajnim në Universitetin Amerikan të Kosovës (AUK/TDI) dhe Institutit Pedagogjik të Kosovës (IPK). Qëllimi i marrëveshjes ishte shkëmbimi i informatave të projektit TeachECDL dhe përdorimi i tyre për qëllime studimi.

Baza e të dhënave TeachECDL përmban një informacion të gjerë për të gjithë stafin arsimor të përfshirë në programin e ECDL-së, i cili, përveç informacioneve personale (emri, mbiemri, gjinia, data e lindjes, vendi, përvoja e punës etj.) për secilin vijues, ofron edhe informacione specifike lidhur me kualifikimin, institucionin ku punon dhe pozitën/angazhimin në institucionin përkatës, vijueshmërinë dhe rezultatet e testimit për secilin modul (numrin e pikëve të shprehura në përqindje), si dhe nivelin/llojin e certifikimit në kuadër të programit.

Për nevoja të studimit, kryesisht janë analizuar, përpunuar dhe krahasuar të dhënat që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me fushën e studimit, si kualifikimi, punëdhënësi, angazhimi, vijueshmëria dhe rezultatet e testimit për secilin modul dhe lloj të certifikimit, ndërsa aspekte të informacionit personal për mësimeve për përfshirë mbeten në besueshmëri dhe të patrajuara në studim. Gjithashtu, për qëllime studimi janë

shfrytëzuar edhe të dhënat statistikore të MASHT-it/SMIA-s për personelin arsimor të nivelit parauniversitar të arsimit.

Pas analizës dhe krahasimit të të dhënave të *TeachECDL* dhe të treguesve statistikorë të SMIA-s, rezulton se nga 28254, sa ka qenë gjithsej numri i personelit arsimor i angazhuar në arsimin parauniversitar në vitin akademik 2012/2013 në nivel vendi (MASHT/SMIA, 2013), në programin e ECDL-së kanë qenë të përfshirë gjithsej 12960 (45,87%) i këtij personeli.




Figura 1. Staf i arsimor 2012/2013 dhe përfshirja në programin e ECDL-së 2009/2013

Nëse mbi baza komunale i krahasojmë këto të dhëna, atëherë rezulton se përqindja më e madhe e përfshirjes ka qenë nga komuna e Mitrovicës (79,07%), pastaj e Prishtinës (64,93%) dhe e Prizrenit (64,00 %), ndërsa krahasuar me numrin e përgjithshëm të personelit arsimor të përfshirë në programin e ECDL-së (12960), përfshirje më të madhe ka komuna e Prishtinës (15,94%), e Prizrenit (11,99%) dhe komuna e Mitrovicës (7,72%), Tabela në vijim pasqyron përfshirjen në raport me të dhënat e SMIA-s- MASHT.

Tabela. 2. Përfshirja në raport me të dhënat e SMIA-s-MASHT-it

Qyteti	Nr. Sipas SMIA-s	Përfshirja në ECDL	% e përfshirjes/të dhënat e SMIA-s për komunë	% e përfshirjes/ numri i përgjithshëm i të përfshirëve në ECDL (12960)
Deçan	573	227	39,62	1,75
Dragash	467	226	48,39	1,74
Drenas	1009	465	46,09	3,59
Ferizaj	1850	841	45,46	6,49
Fushë Kosovë	446	266	59,64	2,05
Gjakovë	1580	813	51,46	6,27
Gjilan	1814	927	51,10	7,15
Hani i Elezit	120	17	14,17	0,13
Istog	645	139	21,55	1,07
Junik	82	2	2,44	0,02
Kaçanik	560	266	47,50	2,05
Kamenicë	690	144	20,87	1,11
Klinë	654	96	14,68	0,74
Lipjan	1057	648	61,31	5
Malishevë	1146	67	5,85	0,52
Mitrovicë	1266	1001	79,07	7,72
Novobërdë	74	15	20,27	0,12
Obiliq	369	233	63,14	1,8
Pejë	1469	678	46,15	5,23
Podujevë	1466	733	50,00	5,66
Prishtinë	3182	2066	64,93	15,94
Prizren	2428	1554	64,00	11,99
Rahovec	864	135	15,63	1,04
Shtërpcë	94	8	8,51	0,06
Shtime	473	138	29,18	1,06
Skenderaj	910	133	14,62	1,03
Suharekë	977	622	63,66	4,8
Viti	786	119	15,14	0,92
Vushtrri	1094	362	33,09	2,79
Gjithsej të identifikuar	28145	12941	45,98	99,85
Të paidentifikuar		19	-	0,15
Gjithsej:		12960		100,00

Bazuar në cilësinë e angazhimit që stafi arsimor ka në institucionet arsimore të këtij niveli, pasqyra e të dhënave TeachECDL informon se, përveç mësimeve të lëndëve/fushave mësimore, në programin e ECDL-së janë të përfshirë edhe drejtorët/zv.drejtorët e shkollave, edukatorë të nivelit parashkollor dhe parafillor, punëtorë profesionalë (pedagogë, psikologë) etj.

Për nga përqindja e përfshirjes së personelit, specifikuar në cilësinë dhe angazhimin e tyre në institucionin përkatës, përqindje më të lartë të përfshirjes në programin e ECDL-së ka nga mësimeve të klasor (30,05%), mësimeve të shkencave të natyrës (12,01%) dhe mësimeve të lëndëve profesionale (9,15%), Tabela në vijim pasqyron të dhënat e përfshirjes sipas lëndës/angazhimit në shkollë.

Tabela 3. Përfshirja sipas lëndës/angazhimit

Lënda/angazhimi	Total	% nga gjithsej të identifikuar (11228)
Zyrtarë	157	1,40
Edukatore	274	2,44
Mësim klasor	3374	30,05
Gjuhë shqipe	942	8,39
Gjuhë e huaj	915	8,15
Matematikë	880	7,84
Shkencat e natyrës	1348	12,01
Shkencat shoqërore	690	6,15
Lëndët profesionale	1027	9,15
Lëndët e artit	314	2,80
Edukata sportive	432	3,85
TIK	388	3,46
Drejtorë/zv.drejtorë	331	2,95
Psikologë/pedagogë	29	0,26
Parashkollor/parafillor	69	0,61
P. profesionale/trajner	42	0,37
Mësim zgjedhor	8	0,07
FMN/mësues udhëtues	8	0,07
Gjithsej të identifikuar	11228	86,64
Të paidentifikuar	1732	13,36
Gjithsej të përfshirë në ECDL		12960

ECDL-ja është kualifikim i pranuar në nivel ndërkombëtar, i cili u mundëson individëve të vërtetojnë dituritë dhe aftësitë e tyre bazike për përdorimin e kompjuterit, përmban 7 module, në të cilat definoohen njohuritë dhe kompetencat e nevojshme për përdorim kompetent të kompjuterit dhe aplikacioneve të zakonshme kompjuterike. Në mënyrë që të arrihet certifikimi për këtë program, individualisht duhet të kalohet testi i standardizuar për secilin nga 7 modulet (testet janë modulare dhe mund të përfundohen sipas radhës së dëshiruar):

- Moduli 1 - Bazat e teknologjisë së informimit dhe komunikimit (ICT);
- Moduli 2 - Shfrytëzimi i kompjuterit dhe menaxhimi i fajllave (Word);
- Moduli 3 - Përpunimi i teksteve (Windows XP);
- Moduli 4 - Kalkulimi i tabelave (Excel);
- Moduli 5 - Baza e të dhënave (Access);
- Moduli 6 - Prezantimet (Power Point);
- Moduli 7- Interneti dhe komunikimi (Internet Explorer & Outlook).

Varësisht nga modulet e programit të kaluar nga kandidati ofrohen edhe certifikata përkatëse. Certifikatat më të njohura për përfitim nga programi i ECDL-së janë:

- *ECDL Start* – dëshmon njohuritë dhe aftësitë praktike për katër module të programit;
- *ECDL Core* – dëshmon njohuritë dhe aftësitë praktike për shtatë module të programit;
- *ECDL Advanced* – përmban katër module të ndërtuara mbi bazën e *ECDL Core*.

Certifikimi i njohurive dhe aftësive mund të bëhet mbi bazën e modulit përkatës, apo njëherazi për të gjitha modulet:

- Word – nivel i avancuar;
- Excel – nivel i avancuar;
- Access – nivel i avancuar;

➤ Power Point – nivel i avancuar.

- *ECDL Expert* – dëshmon realizimin e katër moduleve në nivel të avancuar (ECDL Advanced) nga kandidati dhe e titullon atë përdorues të nivelit ekspert.
- *ECDL eKids* – ku përmes lojës vlerësohen aftësitë bazë të përdoruesve të rinj (në moshë) të kompjuterit.

Programi i trajnimit i ofruar për personelin arsimor të arsimit parauniversitar në Kosovë i përket nivelit të programit *ECDL Core*. Stafi i përfshirë në programin e ECDL-së ka pasur mundësinë të përcjellë 7 modulet e programit për përfitimin e kompetencave të nevojshme për përdorimin e kompjuterit dhe aplikacioneve të zakonshme kompjuterike. Përveç vijimit të ligjëratave dhe aktiviteteve ushtrimore brenda programit, në mënyrë që të arrihet certifikimi për programin e ECDL-së, është dashur që individualisht të kalohet në procesin e testimit për secilin nga 7 modulet e programit. Varësisht nga rezultatet e testimit, vijuesit edhe janë pajisur me certifikatat përkatëse:

- *Certifikata ECDL Start* – të cilën e fiton vijuesi pas përfundimit me sukses të testit (75% e tutje e pikëve të arrira në test) në katër module të programit;
- *Certifikata ECDL Core* - të cilën e fiton vijuesi pas përfundimit me sukses të testit (75% e tutje e pikëve të arrira në test) në shtatë module të programit.

Pas analizës dhe krahasimit të të dhënave të TeachECDL, rezulton se nga numri i përgjithshëm (12960) i personelit arsimor të përfshirë në programin e ECDL-së, 6939 (53,54 %) e tyre kanë arritur të certifikohen për modulet e programeve ECDL Start ose ECDL Core, ndërsa bazuar në llojin e certifikimit të fituar, krahasuar me numrin e përgjithshëm të të certifikuarve, rezulton se 3140 (45,25%) e stafit përfitues në këtë program janë certifikuar për nivelin e *ECDL Start*, ndërsa 3799 (62,44%) janë certifikuar për nivelin e *ECDL Core*.

Tabela në vijim pasqyron të dhënat për certifikimin sipas lëndës/angazhimit, niveleve të certifikimit dhe përfshirjes në program.

Tabela 4. Certifikimi sipas lëndës/angazhimit, niveleve të certifikimit dhe përfshirjes

Lënda/angazhimi	ECDL Start	% në raport me 3140	ECDL Core	% në raport me 3799	Gjithsej	% në raport me 6939	Të përfshirë	% e certifikimit/përfshirja
Zyrtarë	40	1,27	34	0,89	74	1,07	157	47,13
Edukatore	61	1,94	61	1,77	122	1,76	274	44,53
Mësim klasor	762	24,27	1004	26,43	1766	25,45	3374	52,34
Gjuhë shqipe	207	6,59	181	4,76	388	5,59	942	41,19
Gjuhë e huaj	232	7,39	371	9,77	603	8,69	915	65,9
Matematikë	214	6,82	405	10,66	619	8,92	880	70,34
Shk.natyres	287	9,14	306	8,05	593	8,55	1348	43,99
Shk. Shoq.	246	7,83	194	5,11	440	6,34	690	63,77
Lëndët.prof.	246	7,83	413	10,87	659	9,5	1027	64,17
Lëndët e artit	70	2,23	70	1,84	140	2,02	314	44,59
Ed.sportive	113	3,6	80	2,11	193	2,78	432	44,68
TIK	93	2,96	145	3,82	238	3,43	388	61,34
Dr./zv.drejtorë	94	2,99	62	1,63	156	2,25	331	47,13
Psik./pedagogë	5	0,16	10	0,26	15	0,22	29	51,72
Parashk./parafi	28	0,89	17	0,45	45	0,65	69	65,22
P.prof./trajner	8	0,25	17	0,45	25	0,36	42	59,52
Mësim zgjedhor	2	0,06	2	0,05	4	0,06	8	50
Mësues udhëtues	2	0,06	2	0,05	4	0,06	8	50
Të pa identifikuar	430	13,69	425	11,19	855 ²	12,32	1732	49,36
Gjithsej të certifikuar	3140	45,25	3799	62,44	6939	53,54 % (në raport me 12960)		

² Për 855 (12,32%) përfitues, të cilët kanë arritur certifikim në njërin nga nivelet, mungojnë të dhëna për lëndën/ angazhimin e tyre në institucionin përkatës!!

Nga analiza e të dhënave të TeachECDL, mbi bazën e lëndës/angazhimit që stafi arsimor ka në institucionin përkatës, identifikojmë se numri (përqindja) e certifikimit për programin e ECDL-së në raport me përfshirjen e tyre në këtë program rezulton të jetë:

1. Mësimdhënësit e matematikës 619 (70,34%) të certifikuar, nga 880 të përfshirë;
2. Mësimdhënës të gjuhëve të huaja 603 (65,90%) të certifikuar, nga 915 të përfshirë;
3. Mësimdhënës/edukatorët e niveleve parashkollor/ parafillor 45 (65,22%) të certifikuar, nga 69 të përfshirë.

Ndërsa, specifikuar me nivelin e certifikimit kemi:

ECDL Start:

1. Mësimdhënës e ciklit klasor 762 (24,27%) të certifikuar;
2. Mësimdhënës të shkencave të natyrës (Biologji, Fizikë, Kimi) 287 (9,14%) të certifikuar;
3. Mësimdhënës të shkencave shoqërore (Gjeografi, Ed. qytetare, Histori, Pedagogji, Sociologji etj.) 246 (7,83%) të certifikuar dhe mësimdhënës të lëndëve profesionale gjithashtu 246 (7,83%) të certifikuar.

ECDL Core:

1. Mësimdhënës të ciklit klasor 1004 (26,43%) të certifikuar;
2. Mësimdhënës të lëndëve profesionale 413 (10,87%) të certifikuar;
3. Mësimdhënës të matematikës 405 (10,66%) të certifikuar.

Një tjetër qasje e analizës ndaj të dhënave të TeachECDL është edhe krahasimi dhe identifikimi në baza komunale i numrit (përqindjes) të personelit arsimor të certifikuar për programin e ECDL-së në raport me përfshirjen e tyre në këtë program. Mbi këtë specifikë, rezulton se numër (përqindje) më të lartë të të certifikuarve për këtë program ka (tabela 4):

1. Komuna e Ferizajt 392 (84,30%) të certifikuar, nga 841 të përfshirë;
2. Komuna e Gjilanit 653 (70,44%) të certifikuar, nga 927 të përfshirë;
3. Komuna e Suharekës 434 (69,77%) të certifikuar, nga 622 të përfshirë.

Tabela 5. Certifikimi për programin e ECDL-së sipas komunave në raport me përfshirjen

Komuna	ECDL Start	% / 3140	ECDL Core	%/3799	Gjithsej	%/6939	Përfshirja në ECDL	% e certifik./ përfshirja
Deçan	100	3,18	29	0,76	129	1,86	227	56,83
Dragash	61	1,94	66	1,74	127	1,83	226	56,19
Drenas	124	3,95	153	4,03	277	3,99	465	59,57
Ferizaj	174	5,54	218	5,74	392	5,65	841	84,30
F. Kos.	51	1,62	97	2,55	147	2,12	266	55,26
Gjakovë	241	7,68	230	6,05	473	6,81	813	58,18
Gjilan	256	8,15	397	10,45	653	9,41	927	70,44
H. i Elezit	3	0,10	6	0,16	9	0,13	17	0,97
Istog	49	1,56	38	1,00	87	1,25	139	9,39
Junik	1	0,03	1	0,03	2	0,03	2	0,22
Kaçanik	61	1,94	74	1,95	135	1,94	266	14,56
Kamenicë	61	1,94	34	0,89	95	1,37	144	10,25
Klinë	30	0,96	18	0,47	48	0,69	96	5,18
Lipjan	152	4,84	164	4,32	317	4,57	648	34,20
Malishevë	17	0,54	25	0,66	42	0,6	67	4,53
Mitrovicë	201	6,40	195	5,13	396	5,7	1001	42,72
Novobërdë	4	0,13	5	0,13	9	0,13	15	0,97
Obiliq	62	1,97	72	1,90	133	1,93	233	14,35
Pejë	167	5,32	144	3,79	311	4,48	678	33,55
Podujevë	150	4,78	205	5,40	355	5,11	733	48,43
Prishtinë	398	12,68	614	16,16	1013	14,59	2066	49,03
Prizren	339	10,80	531	13,98	871	12,55	1554	56,05
Rahovec	36	1,15	41	1,08	77	1,11	135	57,04
Shtërpçë		-	1	0,03	1	0,01	8	12,50
Shtime	29	0,92	43	1,13	72	1,04	138	52,17
Skenderaj	43	1,37	18	0,47	61	0,88	133	45,86
Suharekë	173	5,51	261	6,87	434	6,25	622	69,77
Viti	42	1,34	26	0,68	68	0,98	119	57,14
Vushtrri	112	3,57	87	2,29	199	2,87	362	54,97
-	3	0,10	6	0,16	10	0,14	19	52,63
Gjithsej:	3140	82,65	3799	54,75	6939	53,57	12960	

Ndërsa, specifikuar me nivelin e certifikimit, kemi:

ECDL Start:

1. Komuna e Prishtinës 398 (12,68%) të certifikuar;
2. Komuna e Prizrenit 531 (13,98%) të certifikuar;
3. Komuna e Gjilanit 256 (8,15%) të certifikuar.

ECDL Core:

1. Komuna e Prishtinës 614 (16,16%) të certifikuar;
2. Komuna e Prizrenit 339 (10,80) të certifikuar;
3. Komuna e Gjilanit 397 (10,45%) të certifikuar.

Përfshirja dhe kalueshmëria në modulet e programit të ECDL-së

Paraprakisht dhamë një informacion se programi i trajnimit, i ofruar për personelin arsimor të arsimit parauniversitar në Kosovë, i përket nivelit të programit *ECDL Core* dhe se stafi i përfshirë e ka pasur mundësinë të përcjellë 7 modulet e programit dhe se, përveç vijimit të ligjëratave dhe aktiviteteve ushtrimore brenda programit, në mënyrë që të arrihet certifikimi për programin e ECDL-së, është dashur që individualisht të kalohet në procesin e testimit të standardizuar për secilin nga 7 modulet e programit.

Meqenëse programi ECDL është një program i standardizuar, atëherë edhe kalueshmëria në modulet përkatëse i është përmbajtur këtij standardi dhe një modul i programit llogaritet si i kaluar në rastin kur kandidati ka arritur rezultat pozitiv në 75% e tutje të kërkesave të testit. Struktura e të dhënave të TeachECDL na ka mundësuar që për qëllimin e studimit të analizojmë dhe nxjerrim informacion edhe më të detajuar lidhur me rezultatet e personelit arsimor të përfshirë në këtë

program specifikash për kalueshmërinë e tyre në modulet përkatëse të programit, tabela 5.

Mbi bazën e këtij kriteri, nga analiza e të dhënave të TeachECDL, rezulton se numër (përqindje) më të lartë të pjesëmarrjes në testim ka pasur te:

1. Moduli 2 - Shfrytëzimi i kompjuterit dhe menaxhimi i fajllave (Word), 8361(64,51%) të testuar;
2. Moduli 3 - Përpunimi i teksteve (Windows XP), 8053 (62,13%) të testuar;
3. Moduli 4 - Kalkulimi i tabelave (Excel), 7500 (57,87%) të testuar.

Ndërlidhur me rezultatin e arritur në testin e standardizuar, rezulton se numër më të madh të të testuarve me arritshmëri nën 75% në kërkesat e testit ka te:

1. Moduli 2 - Shfrytëzimi i kompjuterit dhe menaxhimi i fajllave (Word), 2008 (15,49%) të të testuarve;
2. Moduli 3 - Përpunimi i teksteve (Windows XP), 1734 (13,38%);
3. Moduli 4 - Kalkulimi i tabelave (Excel), 1512 (11,67%) të të testuarve.

Ndërsa, numër më të madh të të testuarve me arritshmëri 75% e tutje në kërkesat e testit ka te:

- I. Moduli 2 - Shfrytëzimi i kompjuterit dhe menaxhimi i fajllave (Word), 6353 (49,02%) të të testuarve;
- II. Moduli 3 - Përpunimi i teksteve (Windows XP), 6319 (48,75%).
- III. Moduli 7- Interneti dhe komunikimi (Internet Explorer & Outlook) , 6017 (46,42%) të të testuarve.

Tabela 6. Përfshirja dhe kalueshmëria në modulet e ECDL-së

Kalueshmëria	M1		M2		M3		M4		M5		M6		M7	
	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%
nën 50%	207	1,60	622	4,80	863	6,66	561	4,33	444	3,43	560	4,32	244	1,88
50%	70	0,54	132	1,02	90	0,69	70	0,54	73	0,56	86	0,66	55	0,42
51-74%	791	6,1	1254	9,68	781	6,03	881	6,80	933	7,20	853	6,58	1021	7,88
JO	1068	8,2	2008	15,49	1734	13,38	1512	11,67	1450	11,19	1499	11,57	1320	10,18
75%	129	1,0	601	4,64	446	3,44	446	3,44	364	2,81	458	3,53	560	4,32
76-80%	241	1,9	1332	10,28	1139	8,79	1157	8,93	975	7,52	1212	9,35	1281	9,88
81-90%	321	2,5	2353	18,15	2375	18,32	2331	17,98	1878	14,49	2472	19,07	2106	16,25
91-99%	201	1,6	1813	13,99	2205	17,01	1876	14,47	1687	13,02	1683	12,99	1800	13,89
100%	39	0,3	254	1,96	154	1,19	178	1,37	178	1,37	88	0,68	270	2,08
PO	931	7,2	6353	49,02	6319	48,75	5988	46,20	5082	39,21	5913	45,62	6017	46,42
Gj.	1999	15,4	8361	64,51	8053	62,13	7500	57,87	6532	50,40	7412	57,19	7337	56,61

Është me rëndësi të përmendet se në të gjitha modulet e programit të ECDL-së, të realizuara me personelin arsimor, numri më i madh i të testuarve që kanë arritur rezultat pozitiv në kërkesat e testit qëndron te 81-90% e arritshmërisë, ndërsa numër (përqindje) më të madh të arritshmërisë, me 100% të realizueshmërisë së kërkesave të testit, ka te Moduli 2, 254 (1,96%), si dhe M3 e M4, nga 178 (1,37%) të të testuarve.

Bazuar në numrin (përqindjen) e kalueshmërisë së të testuarve me arritshmëri 75% e tutje në kërkesat e moduleve të programit të ECDL-së, po japim tabelën në vazhdim me përqindjen e kalueshmërisë sipas moduleve.

Tabela 7. Rangimi sipas numrit (përqindjes) së kalueshmërisë në modulet e ECDL-së

1		2		3		4		5		6		7	
M2		M3		M7		M4		M6		M5		M1	
Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%
6353	49,02	6319	48,75	6017	46,42	5988	46,2	5913	45,62	5082	39,21	931	7,2

III. Rezultatet e studimit në terren

Trajnimi i personelit arsimor për programin e ECDL-së është në hap me përpjekjet për t'u përshtatur me kërkesat e ndryshimeve të përsheptuara në shoqërinë e sotme, ku njohuritë dyfishohen brenda pak vjetësh dhe zbatimi i teknologjisë së informimit dhe komunikimit zë vend parësor për informim dhe ecje krahas ndryshimeve. Puna efikase me kompjuter tanimë shihet si çelësi i suksesit të çdo individi, e në procesin arsimor në veçanti zhvillimi i kompetencave për përdorimin e TIK-ut po bëhet gjithnjë e më tepër i domosdoshëm për të ecur në hap me avancimet e metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe nxënies.

Trajnimi i personelit arsimor për këtë program është gjithashtu me interes të veçantë, për faktin se janë në proces përgatitjet për zbatimin e Kurrikulës së Kosovës dhe, si çdo reformë tjetër në fushën e arsimit, edhe ky zhvillim kërkon kompetenca dhe qasje të re edhe në fushën e teknologjisë së informacionit.

Në këtë fazë të studimit, përmes hulumtimit në terren me mostrën e përzgjedhur për studim, jemi munduar të sigurojmë informacione relevante lidhur me objektivat e studimit, në mënyrë të veçantë për ndikimin e trajnimit në zhvillimin e kompetencave të mësimdhënësve për përdorimin e TIK-ut, zbatimit të njohurive dhe aftësive të reja të fituara gjatë trajnimit në procesin e mësimdhënies, nivelin e mbështetjes që ofron shkolla në funksion të këtij zbatimi, si identifikimi i mundësive për avancim të procesit.

Përshtatur me natyrën e studimit dhe strukturën e mostrës së përfshirë në studim, rezultatet e dala nga përpunimi i informacionit, të siguruara përmes instrumenteve të hulumtimit, po i paraqesim ndarazi, mirëpo duke u përpjekur

që aspektet e veçanta të analizohen, të krahasohen, të interpretohen dhe të prezantohen edhe në formë të integruar.

3.1. Rezultatet e dala nga hulumtimi i realizuar me drejtorë/zv.drejtorë të shkollave

Me mostrën e drejtorëve/zv.drejtorëve të përfshirë në studim është realizuar një pyetësor me gjithsej 47 kërkesa/pyetje. Përveç 13 pyetjeve të para lidhur me të dhënat personale dhe të dhënat për kalueshmëri të moduleve të programit të ECDL-së, 34 pyetjet e tjera ndërlidhen ngushtë me qëllimin dhe objektivat e studimit dhe, varësisht nga kërkesat e tyre, i kemi përmbledhur në pesë faktorë.

3.1.1. Të dhëna personale të drejtorëve/zv.drejtorëve, kalueshmëria në modulet e programit të ECDL-së

Nga 28 shkolla të përfshira në studim, në pyetjet e pyetësorit të anketës për drejtorë/zv.drejtorë janë përgjigjur vetëm 18 prej tyre, dhe, nëse mbi baza komunale dhe të nivelit/profilit të shkollave përfaqësuese e krahasojmë këtë shpërndarje, atëherë kemi këtë strukturë të përgjigjeve. Tabela në vazhdim tregon mostrën sipas niveleve.

Tabela 8. Shpërndarja e mostrës së drejtorëve.zv.drejtorëve të përgjigjur në pyetësor

Shpërndarja e mostrës sipas nivelit/profillit			Gjithsej:	
Filllore dhe e mesme e ulët	Gjimnaz	Shkollë profesionale	Nr	%
9 (50%)	6 (33,3%)	3 (16,7%)	18	100,0

Analiza e të dhënave lidhur me mostrën e përfshirë në hulumtim tregon se 15 (83,3%) e tyre ishin të gjinisë mashkullore dhe 3(16,7%) të asaj femërore, ndërsa mbi baza të nivelit të kualifikimit kemi 11 (61,1%) me studime bazë (fakultet), 5(27,8%) me studime master dhe 2 (11,1%) me studime të doktoratës.

Nga mostra e përgjigjur, të përfshirë në programin e ECDL-së kanë qenë 16 (88,88%), ndërsa specifikuar në module përfshirja dhe kalueshmëria kanë qenë si në tabelën e dhënë.

Tabela 9. Të përfshirë në modulën përkatës

	M1	M2	M3	M4	M5	M6	M7
	13	16	14	14	13	13	14
Të dhëna për modulën përkatës	%	%	%	%	%	%	%
Kam vijuar ligjëratat dhe kam ndërprerë trajnimin		18,8	14,3	21,4	23,1	23,1	21,4
Jam testuar 1 herë dhe kam ndërprerë modulën	7,7	6,2	7,1	7,1	7,7	7,7	7,1
Jam testuar 2 e më shumë herë dhe kam ndërprerë modulën		6,2					
Kam kaluar modulën përkatës	92,3	68,8	78,6	71,4	69,2	69,2	71,4

3.1.2. Niveli i kënaqësisë së drejtorëve/zv.drejtorëve për zbatimin, ndikimin dhe mbështetjen që ofron shkolla në raport me ECDL-në

Analiza e këtij faktori realizohet përmes 3 pyetjeve që kanë të bëjnë me kënaqësinë e drejtorëve/zv.drejtorëve lidhur me zbatimin, ndikimin dhe mbështetjen që ofrohet në shkolla për zbatimin e njohurive dhe shkathtësive të reja të përfituara përmes programit të ECDL-së nga ana e mësimitdhënësve. Për të marrë përgjigjet e udhëheqësve të shkollave për këtë faktor, në pyetësonin e realizuar me ta kemi shtruar pyetje që mundësojnë përgjigje nga niveli 1 (aspak) deri në 4 (plotësisht).

Te analiza e pajtueshmërisë dhe mospajtueshmërisë me pohimet e dhëna në pyetësonë, përqindjet e prezantuara në tabelën vijuese shprehin mendimet që kanë ata për aspekte të ndryshme lidhur me këtë faktor.

<i>Tabela 10. Niveli i kënaqësisë së drejtorëve/zv.drejtorëve për zbatimin, ndikimin dhe mbështetjen që u ofron shkolla mësimitdhënësve në programin e ECDL-së (%)</i>						
<i>4=Plotësisht i kënaqur, 3 = Mesatarisht i kënaqur, 2=Pak i kënaqur, 1= Aspak i kënaqur</i>						
	Pohimi	4	3	2	1	Nr.
1	Unë jam i kënaqur me zbatimin e njohurive dhe shkathtësive të reja nga ana e mësimitdhënësve	27,8	61,1	11,1	-	17
2	Unë jam i kënaqur me ndikimin e njohurive dhe shkathtësive të reja në procesin e mësimitdhënies dhe nxënies	38,9	38,9	22,2	-	18
3	Unë jam i kënaqur me mbështetjen që ofron shkolla në funksion të realizimit të njohurive dhe shkathtësive të reja	22,2	50	27,8	-	18

Nga të dhënat e tabelës paraprake evidentojmë se, krahasuar me nivelet e tjera të kënaqësisë, drejtorët /zv.drejtorët tregojnë përqindje të lartë të të përgjigjurve te niveli mesatar i kënaqësisë në të tri kërkesat e shtruara në pyetësorë (61,1% lidhur me zbatimin, 38,9% kënaqësi mesatare lidhur me ndikimin dhe 50% lidhur me mbështetjen që ofron shkolla në funksion të realizimit të njohurive dhe shkathtësive të reja). Specifikuar në kërkesën/pohimin përkatës, rezulton se drejtorët/zv.drejtorët janë më të kënaqur me zbatimin e njohurive dhe shkathtësive të reja të mësimdhënësve, krahasuar me vetë ndikimin dhe mundësitë për mbështetje.

3.1.3. Zbatimi i njohurive dhe shkathtësive të reja të përfituara përmes programit të ECDL-së nga ana e mësimdhënësve në procesin e mësimdhënies dhe nxënies

Analiza e faktorit të dytë është realizuar përmes 8 pyetjeve të përfshira në pyetësorë dhe ka të bëjë me atë se sa dhe si mësimdhënësit e tyre janë duke zbatuar në praktikën e mësimdhënies dhe nxënies njohuritë dhe shkathtësitë e përfituara përmes trajnimit për programin e ECDL-së, si në rastin e hartimit të planeve të punës, materialeve mësimore, testeve, raporteve, krijimit të databazave (statistika) me kompjuter, hulumtimit të materialeve mësimore (burimeve), komunikimit me prindër, kolegë, nxënës etj.

Pyetjet e shtruara janë pyetje që mundësojnë përgjigje nga 1 (asnjëherë) deri në 5 (çdoherë).

Te analiza e pajtueshmërisë dhe mospajtueshmërisë me pohimet e dhëna në pyetësorë, përqindjet e prezantuara në

tabelën vijuese shprehin mendimet që kanë drejtorët/ zv.drejtorët për aspekte të ndryshme lidhur me këtë faktor.

Tabela në vazhdim pasqyron përqindjet e përgjigjeve lidhur me zbatimin e njohurive dhe shkathtësive përmes programit.

Tabela 11: Zbatimi i njohurive dhe shkathtësive të përfituara përmes programit të ECDL-së në praktikat e mësimit dhe nxënies (%)
5=Çdoherë, 4=Shpeshherë, 3 = Nganjëherë, 2=Rrallëherë, 1= Asnjëherë

Pohimi	5	4	3	2	1	Nr.
Mësimdhënësit hartojnë plane pune me kompjuter	11,8	41,2	41,2	5,9	-	17
Mësimdhënësit hartojnë materiale mësimore me kompjuter	5,9	35,3	35,3	23,5	-	17
Mësimdhënësit hartojnë me kompjuter teste për realizim me nxënës	22,2	50	27,8	-	-	18
Mësimdhënësit prezantojnë materiale /incizime në klasë me projektor	5,5	16,7	55,6	22,2	-	18
Mësimdhënësit dorëzojnë raporte pune të shkruara me kompjuter	17,6	29,4	41,2	5,9	5,9	17
Mësimdhënësit krijojnë databaza (statistika) me kompjuter	12,5	18,8	25	37,5	6,1	16
Mësimdhënësit komunikojnë me mua me e-mail	5,9	52,9	35,5	5,9	-	17
Mësimdhënësit komunikojnë me prindër me e-mail	5,9	17,6	41,2	35,3	-	17

Bazuar në përqindjet më të larta të të përgjigjurve, të paraqitura në tabelën paraprake, mund të themi se, sipas udhëheqësve arsimorë të përfshirë në studim, si rezultat i trajnimit për programin e ECDL-së, mësime të tilla tani kompjuterin dhe programet e tij i zbatojnë më shpesh (*çdoherë* dhe *shpeshherë*) për hartimin e testeve për realizim me nxënës (72,2%), për komunikim me drejtorin/zv.drejtorin në e-mail (58,8%) dhe për hartimin e planeve të punës me kompjuter (53%). Ndërsa, mbetet në nivel jo të kënaqshëm përdorimi i kompjuterit dhe programeve të tij (*rrallëherë* dhe *asnjëherë*) për hartimin e bazës së të dhënave/statistikave (43,6%), komunikimin me prindër (35,3%) dhe hartimi i materialeve mësimore për realizim me nxënës (23,5%).

Për informacion më të detajuar, kemi bërë edhe një krahasim të të dhënave, i kemi krahasuar mendimet e dhëna të drejtorëve lidhur me zbatimin e njohurive dhe shkathtësive të reja të mësime të tilla të përfituara përmes programit të ECDL-së në raport me tipin/profilin e shkollave të përfshira në studim. Për arsye të thjeshtë të leximit dhe interpretimit të informacionit që ofron tabela e krahasimeve, kemi bërë rikodim të shkallëve vlerësuese në tri nivele: 1= *Rrallëherë* dhe *Asnjëherë*, 2= *Nganjëherë* dhe 3= *Shpeshherë* dhe *Çdoherë*.

Tabela 12: Zbatimi i njohurive dhe shkathtësive të përfituara përmes programit të ECDL-së në praktikat e mësimdhënies dhe nxënies në raport me tipin/profilin e shkollës (%)
1= Asnjëherë dhe Rrallëherë, 2= Nganjëherë dhe 3= Shpeshherë dhe Çdoherë

Pohimi	Vlerësimi	Fillore dhe e mesme e ulët	Gjimnaz	Shk. profesionale
Mësimdhënësit hartojnë plane pune me kompjuter	1	11,1	0	0
	2	44,4	20,0	66,7
	3	44,4	80,0	33,3
	Nr	9	5	3
Mësimdhënësit hartojnë materiale mësimore me kompjuter	1	33,3	20,0	0
	2	11,1	40,0	100
	3	55,6	40,0	0
	Nr	9	5	3
Mësimdhënësit hartojnë me kompjuter teste për realizim me nxënës	1	0	0	0
	2	22,2	50,0	0
	3	77,8	50,0	100
	Nr	9	6	3
Mësimdhënësit prezantojnë materiale dhe incizime në klasë me projektor	1	33,4	16,7	0
	2	33,3	83,3	66,7
	3	33,3	0	33,3
	Nr	9	6	3
Mësimdhënësit hartojnë/dorëzojnë raporte pune të shkruara me kompjuter	1	22,2	0	0
	2	22,2	60,0	66,7
	3	55,6	40,0	33,3
	Nr	9	5	3
Mësimdhënësit hartojnë databaza (statistika) me kompjuter	1	44,4	50,0	33,3
	2	22,2	25,0	33,4
	3	33,3	25,0	33,3
	Nr	9	4	3
Mësimdhënësit komunikojnë me drejtorin/zv.drejtorin në e-mail	1	11,1	0	0
	2	33,3	60,0	0
	3	55,6	40,0	100
	Nr	9	5	3
Mësimdhënësit komunikojnë me prindër në e-mail	1	55,6	0	33,3
	2	11,1	100	33,3
	3	33,3	0	33,4
	Nr	9	5	3

Veçuar për qindjen më të lartë të të përgjigjurve të vlerësimi më i shpeshtë i zbatueshmërisë (*shpeshherë dhe çdoherë*) në raport me tipin e shkollës, kemi këtë pasqyrë:

- | | |
|---|---|
| Shkollat
fillore dhe të
mesme të
ulëta | <ul style="list-style-type: none"> - Hartimi i materialeve mësimore (55,6%); - Prezantimi i materialeve dhe incizimeve në klasë me projektor (33,3%); - Hartimi/dorëzimi i raporteve të punës me kompjuter (55,6%); - Hartimi i databazave (statistikave) me kompjuter (33,3%); |
| Gjimnazet | <ul style="list-style-type: none"> - Hartimi i planeve të punës 80%; - Komunikimi me prindër në e-mail 100 %; - Hartimi i testeve për realizim me nxënës (100%); |
| Shkollat
profesionale | <ul style="list-style-type: none"> - Prezantimi i materialeve dhe incizimeve në klasë me projektor (33,3%); - Hartimi i databazave (statistikave) me kompjuter (33,3%); - Komunikimi me drejtorin/zv.drejtorin në e-mail (100%). |

3.1.4. Ndikimi i trajnimit të mësimitdhënësve për programin e ECDL-së në praktikën e mësimitdhënies dhe nxënies

Analiza e këtij faktori përfshin 10 pyetje të pyetësorit dhe ka të bëjë me ndikimet që ka trajnimi i mësimitdhënësve për programin e ECDL-së në praktikën e mësimitdhënies dhe nxënies, në aspektet si: planifikimi dhe përgatitja e mësimitdhënësve për orën mësimore, në përzgjedhjen e teksteve,

burimeve alternative në procesin e mësimdhënies dhe nxënies, ndikimet në rezultatet mësimore të nxënësve, në kryerjen e detyrave të shtëpisë nga ana e nxënësve, në realizimin e projekteve, në informimin e prindërve për procesin dhe suksesin e nxënësve, ndikimin në uljen e braktisjes së shkollës etj. Pyetjet e shtruara janë pyetje që mundësojnë përgjigje nga 4 (plotësisht) deri në 1 (aspak). Te analiza e pajtueshmërisë dhe mospajtueshmërisë me pohimet e dhëna në pyetësorë, përqindjet e prezantuara në tabelën vijuese shprehin mendimet që kanë drejtorët/ zv.drejtorët për aspekte të ndryshme lidhur me këtë faktor, siç janë paraqitur në tabelën në vijim.

Tabela 13: Ndikimi i trajnimit në procesin e mësimdhënies dhe nxënies (%)
4=Plotësisht, 3 = Mesatarisht, 2=Pak, 1= Aspak

Pohimi	4	3	2	1	Nr.
Mësimdhënësit tani janë më mirë të përgatitur për orën mësimore	17,6	70,6	11,8	-	17
Mësimdhënësit zbatojnë më shumë metoda të mësimdhënies	29,4	64,7	5,9	-	17
Mësimdhënësit përdorin më shumë tekste/materiale alternative me nxënës	37,5	43,8	18,8	-	16
Rezultatet mësimore të nxënësve janë më të larta	18,8	68,8	12,5	-	16
Nxënësit i kryejnë më shpesh detyrat e shtëpisë	18,8	75	6,2	-	16
Nxënësit realizojnë së paku nga 2 projekte arsimore për një gjysmëvjetor	25	43,8	31,2	-	16
Nxënësit hulumtojnë dhe sjellin materiale alternative mësimore	17,6	58,8	23,5	-	17
Komunikimi me prindër është më i mirë	12,5	75	12,5	-	16
Prindërit janë më mire të informuar për rezultatet dhe sjelljet e fëmijëve	20	66,7	13,3	-	18
Braktisja e shkollës është ulur dukshëm	58,8	23,5	17,7	-	17

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën paraprake mund të thuhet se, sipas udhëheqësve arsimorë të përfshirë në studim, programi i trajnimit ka pasur një ndikim të madh (*plotësisht* dhe *mesatarisht*) në zbatimin e më shumë metodave të mësimdhënies nga ana e mësimdhënësve (94,1%), në shpeshësinë e kryerjes së detyrave të shtëpisë nga ana e nxënësve (93,8%), në përgatitjen e mësimdhënësve për orën mësimore (88,2%), ndërsa ndikim të ulët (*pak*) ka në angazhimin/realizimin e projekteve (31,2%), në hulumtimin e materialeve mësimore nga ana e nxënësve (23,5%) dhe në përdorin më shumë tekste/materiale alternative me nxënës (18,8%).

Analiza e krahasimit të përgjigjeve të drejtorëve/zv.drejtorëve lidhur me ndikimin e njohurive dhe shkathtësive të reja të mësimdhënësve, të përfituara përmes programit të ECDL-së në procesin arsimor në raport me tipin/profilin e shkollave të përfshira në studim, është e pasqyruar në tabelën x, ku janë prezantuar përqindjet e përgjigjeve në shkallë të vlerësimit: 4 = *plotësisht*, 3 = *mesatarisht*, 2 = *pak*, përderisa për nivelin 1 = *aspak* nuk kemi pasur asnjë të përgjigjur dhe si i tillë nuk prezanton fare në tabelë. Tabela e dhënë më poshtë tregon pasqyron të dhënat sipas niveleve të shkollave.

Tabela 14: Ndikimi trajnimit të mësimitdhënësve në praktikat e mësimitdhënies dhe nxënies në raport me tipin/profilin e shkollave të përfshira në studim (%)
 4=Plotësisht, 3 = Mesatarisht, 2=Pak, 1=Aspak

Pohimi		Filllore dhe e mesme e ulët	Gjimnaz	Shk. profesionale
Mësimitdhënësit tani janë më mirë të përgatitur për orën mësimore	4	25	-	33,3
	3	50	100	66,7
	2	25	-	-
	Nr	8	6	3
Mësimitdhënësit zbatojnë më shumë metodave të mësimitdhënies	4	25	33,3	33,3
	3	62,5	66,7	66,7
	2	12,5	-	-
	Nr	8	6	3
Mësimitdhënësit përdorin më shumë tekste/materiale mësimore alternative me nxënës	4	25	40	66,7
	3	50	60	-
	2	25	-	33,3
	Nr	8	5	3
Rezultatet mësimore të nxënësve janë më të larta	4	12,5	20	33,3
	3	75	60	66,7
	2	12,50	20	-
	Nr	8	5	3
Nxënësit kryejnë më shpesh detyrat e shtëpisë	4	12,5	-	66,7
	3	87,5	80	33,3
	2	-	20	-
	Nr	8	5	3
Nxënësit hulumtojnë dhe sjellin materiale alternative mësimore	4	12,5	-	66,7
	3	62,5	83,3	-
	2	25	16,7	33,3
	Nr	8	6	3
Nxënësit realizojnë së paku 2 projekte arsimore për një gjysmëvjetor	4	12,5	20	66,7
	3	50	60	-
	2	37,5	20	33,3
	Nr	8	5	3
Braktisja është ulur dukshëm	4	50	66,7	66,7
	3	25	33,3	-
	2	25	-	33,3
	Nr	8	5	3
Komunikimi me prindër është më i mirë	4	-	20	33,3
	3	87,5	60	66,7
	2	12,5	20	-
	Nr	8	5	3
Prindërit janë më mirë të informuar për rezultatet dhe sjelljet e nxënësve	4	12,5	25	33,3
	3	62,50	75	66,7
	2	25	-	-
	Nr	8	5	3

Veçuar përqindjen më të lartë të të përgjigjurve te vlerësimi i shkollës së ndikueshmërisë (*plotësisht*), në raport me tipin e shkollës, kemi këtë pasqyrë:

Shkollat fillore dhe të mesme të ulëta	<ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja për orët mësimore (33,3%) - Zbatimi i më shumë metodave të mësimdhënies (33,3%)
Gjymnazet	<ul style="list-style-type: none"> - Ulja e braktisjes së shkollimit (66,7%)
Shkollat profesionale	<ul style="list-style-type: none"> - Përdorim i më shumë teksteve/materialeve mësimore alternative me nxënës (66,7%) - Arritja e rezultateve më të larta me nxënës (33,3%) - Nxënësit i kryejnë më shpesh detyrat e shtëpisë (66,7%) - Hulumtimi/ sjellja e materialeve mësimore alternative nga ana e nxënësve (66,7%) - Realizimi i së paku dy projekteve mësimore nga ana e nxënësve; - Ulja e braktisjes së shkollimit (66,7%) - Përmirësimi i komunikimit me prindër (33,3%) - Informimi i prindërve për rezultatet e nxënësve (33,3%)

3.1.5. Mbështetja që u ofrohet mësimdhënësve për zbatimin e programeve të TIK-ut në procesin e mësimdhënies dhe nxënies

Analiza e këtij faktori përfshin 10 pyetje të parashtruara në pyetësor dhe ka të bëjë me mbështetjen e ofruar mësimdhënësve me aparaturë fizike (kompjuter/llaptop,

fotokopje, grafoskop etj.), si dhe asaj bashkëpunuese (nga drejtori/zv.drejtori, stafi profesional, kolegët, nxënësit, prindër, etj.) në funksion të realizimit praktik të njohurive dhe aftësive të reja.

Te analiza e pajtueshmërisë dhe mospajtueshmërisë me pohimet e dhëna në pyetësor, përqindjet e prezantuara në tabelën vijuese shprehin mendimet që kanë drejtorët/zv.drejtorët për aspekte të ndryshme lidhur me këtë faktor.

Tabela 15: Kushtet/bashkëpunimi që ofron shkolla për realizimin praktik të njohurive dhe shkathtësive (%)
 5=Çdoherë, 4=Shpeshherë, 3 = Nganjëherë, 2=Rrallëherë, 1=Asnjëherë

Pohimi	5	4	3	2	1	Nr.
Për punën e mësimitdhënësve, shkolla ofron kompjuter/laptop	27,8	22,2	16,7	27,8	5,6	18
Për punën e mësimitdhënësve, shkolla ofron grafoskop	11,8	29,4	35,5	17,6	5,9	17
Për punën e mësimitdhënësve, shkolla ofron projektor	38,9	11,1	22,2	22,2	5,6	18
Për punën e mësimitdhënësve, shkolla ofron fotokopje	64,7	23,5	5,9	5,9	-	17
Bashkëpunimi me drejtorin/zv.drejtorin	52,9	17,6	29,4	-	-	17
Bashkëpunimi me pedagogun/psikologun (në rastet kur ka)	10	40	20	10	20	10
Bashkëpunimi me kolegët e TIK-ut	23,5	41,2	29,4	5,9	-	17
Bashkëpunimi me kolegët e së njëjtës lëndë	17,6	35,3	41,2	5,9	-	17
Bashkëpunimi me prindër	6,2	31,2	31,2	25	6,2	16
Bashkëpunimi me nxënës	17,6	41,2	41,2	-	-	17

Bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelën paraprake lidhur me shpeshësinë e ofrimit të mbështetjes nga shkolla, rezulton se në shkollat e përfshira në studim shumë më shpesh (*çdoherë* dhe *shpeshherë*) për mësimdhënës ofrohen shërbimet e fotokopjes (88,2%), ndërsa ka mangësi (*rrallëherë* dhe *asnjëherë*) në ofrimin e kompjuterëve/laptopëve për procesin e mësimdhënies dhe nxënies (33,4%).

Sa i përket bashkëpunimit brenda stafit të shkollës, përqindjet e ofruara nga drejtorët/zv.drejtorët e anketuar orientojnë në atë se në shkollë ekziston një bashkëpunim i lartë mbështetës (*çdoherë* dhe *shpeshherë*) në mes të mësimdhënësve dhe drejtorit/zv.drejtorit të shkollës (70,5%) në funksion të realizimit praktik të njohurive dhe aftësive të reja, kolegët e lëndës së TIK-ut (64,7%) dhe bashkëpunimi me nxënës që njohin më mirë TIK-un dhe programet kompjuterike (58,8%), ndërsa ka nivel të ulët të bashkëpunimit (*rrallëherë* dhe *asnjëherë*) me prindër (31,2%) dhe me punëtorët profesionalë (pedagogun/psikologun) e shkollës (30%), kuptohet në rastet kur shkolla e ka të angazhuar këtë staf profesional.

Analiza e krahasimit të përgjigjeve të drejtorëve/zv.drejtorëve lidhur me ofrimin e mbështetjes nga shkolla në raport me tipin/profilin e shkollave të përfshira në studim është e pasqyruar në tabelën x, ku janë prezantuar përqindjet e përgjigjeve në shkallë të vlerësimit: 1= *asnjëherë* dhe *rrallëherë*, 2= *nganjëherë* dhe 3 = *shpeshherë* dhe *çdoherë*.

Tabela 16. Mbështetja e ofruar në raport me tipin/profilin e shkollave (%)
1= Asnjëherë dhe Rrallëherë, 2= Nganjëherë dhe 3= Shpeshherë dhe Çdoherë

Pohimi		1-5 dhe 1-9	Gjim.	Shk. Prof.
Për punën e mësimdhënësve, shkolla ofron kompjuter /laptop	3	44,4	50	66,7
	2	11,1	33,3	-
	1	44,4	16,7	33,3
	Nr	9	6	3
Për punën e mësimdhënësve, shkolla ofron grafoskop	3	44,4	-	100
	2	22,2	80	-
	1	33,3	20,0	-
	Nr	9	5	3
Për punën e mësimdhënësve shkolla ofron projektor	3	44,4	50	66,7
	2	22,2	33,3	-
	1	33,3	16,7	33,3
	Nr	9	6	3
Për punën e mësimdhënësve shkolla ofron fotokopje	3	88,9	80	100
	2	-	20	-
	1	11,1	-	-
	Nr	9	5	3
Mësimdhënësit kanë bashkëpunim mbështetës me drejtorin e shkollës për realizimin në përfitimeve nga ECDL	3	87,5	33,3	100
	2	12,5	66,7	-
	1	-	-	-
	Nr	8	6	3
Mësimdhënësit kanë bashkëpunim me pedagogun/psikologun	3	25	75	50
	2	50	-	-
	1	25	25	50
	Nr	4	4	2
Mësimdhënësit kanë bashkëpunim me kolegët e lëndës së TIK-ut	3	50,0	66,7	100
	2	37,5	33,3	-
	1	12,5	-	-
	Nr	8	6	3
Mësimdhënësit kanë bashkëpunim me kolegët e së njëjtës lëndë	3	37,5	50	100
	2	50	50	-
	1	12,5	-	-
	Nr	8	6	3
Mësimdhënësit kanë bashkëpunim me nxënës	3	62,5	66,7	33,3
	2	37,5	33,3	66,7
	1	-	-	-
	Nr	8	6	3
Mësimdhënësit kanë bashkëpunim me prindër	3	25	60	33,3
	2	25	40	33,3
	1	50	-	33,3
	Nr	8	5	3

Veçuar përqindjen më të lartë të të përgjigjurve të vlerësimi i të bashkëpunimit (3= *shpeshherë dhe Çdoherë*), në raport me tipin e shkollës, kemi këtë pasqyrë:

Gjimnazet	<ul style="list-style-type: none"> - Bashkëpunim me pedagogun/psikologun (75%) - Bashkëpunim mbështetës me nxënës (66,7%) - Bashkëpunim mbështetës me prindër (60%)
Shkollat profesionale	<ul style="list-style-type: none"> - Ofrimi i kompjuterëve /laptopëve (66,7%) - Ofrimi i grafoskopit (100%) - Ofrimi i projektorit (66,7%) - Ofrimi i fotokopjes (100%) - Bashkëpunim mbështetës me drejtorin e shkollës (100%) - Bashkëpunim mbështetës me kolegët e lëndës së TIK-ut (100%) - Bashkëpunim mbështetës me kolegët e së njëjtës lëndë.

3.1.6. Kërkesat/nevojat e drejtorëve/zv.drejtorëve lidhur me realizimin praktik të njohurive dhe shkathtësive të reja në procesin e mësimdhënies dhe nxënies

Analiza e këtij faktori përfshin 3 pyetje dhe ka të bëjë kryesisht me identifikimin e kërkesave/nevojave të mësimdhënësve për mbështetje shtesë në funksion të realizimit praktik të njohurive dhe aftësive të reja.

Analiza e pajtueshmërisë dhe mospajtueshmërisë me pohimet e dhëna në pyetësorë, përqindjet e prezantuara në tabelën vijuese shprehin mendimet që kanë drejtorët/zv.drejtorët për aspekte të ndryshme lidhur me këtë faktor. Tabela në vazhdim pasqyron përqindjen e përgjigjeve lidhur me kërkesat e mësimitdhënësve për realizimin në praktikë të shkathtësive dhe njohurive në përdorimin e kompjuterit.

Tabela 17: Kërkesat/nevojat e mësimitdhënësve për realizimin praktik të njohurive dhe shkathtësive për përdorimin e kompjuterit.

4=Plotësisht, 3 = Mesatarisht, 2=Pak, 1= Aspak

Pohimi	4	3	2	1	Nr.
Trajnim shtesë, enkas për përdorimin e TIK-ut në procesin e mësimitdhënies dhe nxënies	52,9	33,3	11,8	-	17
Mbështetje të vazhdueshme profesionale në shkollë për zbatimin e programeve të caktuara kompjuterike	75	18,2	6,2	-	16
Pajisjen e shkollës/klasave me kompjuterë/llaptopë dhe pajisjeve përcjellëse	76,5	-	5,9	17,6	17

Bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelën paraprake, përqindja e dhënë orienton për kërkesë të identifikuar (*plotësisht* dhe *mesatarisht*) në të tri aspektet e shtruara në pyetësorë: për mbështetje të vazhdueshme profesionale (93,2%) dhe për trajnim shtesë të mësimitdhënësve (86,2%), ndërsa kjo përqindje bie (*pak* dhe *aspak*) te kërkesa/nevoja për pajisje të shkollave me kompjuterë/llaptopë dhe pajisje përcjellëse (76,5%).

Komente

<i>Tabela 18. Ndonjë koment që mund të jetë i rëndësishëm për përdorimin e TIK-ut në procesin e mësimdhënies dhe nxënies dhe identifikimi i mundësive për avancimin në të ardhmen</i>	Nr.	%
Pajisja e shkollës dhe mësimdhënësve me kompjuterë dhe lloptopë, pastaj të vazhdohet në mënyrë të vazhdueshme me trajnime.	2	18.2
Në shkollë mungojnë mjetet (interneti, grafoskopi, projektori, etj.) për realizimin e këtij programi.	2	18.2
Kërkohej që në kontinuitet me të arriturat në lëmin e TIK-ut të mbahen edhe seminare përkatëse.	1	9.1
Vazhdimin e trajnimit të të gjithë mësimdhënësve.	1	9.1
Disa nga kolegët nuk janë përfshirë në trajnimin e ECDL-së sepse janë të moshës mbimesatare dhe nuk njohin punën me kompjuter.	1	9.1
Pajisja e shkollës me kompjuter para fillimit të trajnimeve, pajisja e mësimdhënësve apo klasave me kompjuter dhe trajnimi të mbahet në shkollë , duke stimuluar pagat e prof. të informatikës, ndërsa provimi të mbahej përmes sistemit digjital.	2	18.2
Jetësimi i njohurive të fituara nga programi i ECDL-së në shkollë do të shtonte atraktivitetin në mësim, shtimin e përgjegjësisë , etj.	1	9.1
Shkollë jonë , në mungesë të klasave (paraleleve), nuk ka kabinete të informatikës , prandaj edhe kompjuterët na mungojnë, mësimdhënësit nuk kanë mundësi të zhvillojnë orën mësimore me kompjuter apo lloptop.	1	9.1
Total	11	100.0

3.2. Rezultatet e dala nga hulumtimi i realizuar me mësimdhënës

Me mostrën e mësimdhënësve të përfshirë në studim është realizuar një pyetësor me gjithsej 85 kërkesa/pyetje. Përveç 15 kërkesave të para lidhur me të dhënat personale dhe të dhënat për kalueshmëri të moduleve të programit të ECDL-së, 53 pyetjet e tjera ndërlidhen ngushtë me qëllimin dhe objektivat e studimit dhe varësisht nga kërkesat e tyre i kemi përmbledhur në pesë faktorë.

3.2.1. Të dhëna personale të mësimdhënësve, kalueshmëria në modulet e programit të ECDL-së

Nga 28 shkolla të përfshira në studim, në pyetjet e pyetësorit të anketës për mësimdhënës janë përgjigjur gjithsej 347 mësimdhënës dhe, nëse mbi baza të nivelit/profilit të shkollave përfaqësuese krahasojmë këtë shpërndarje, rezulton se kemi 18,3% mësimdhënës të angazhuar në nivelin fillor të shkollimit (klasa 1-5), 28,2% të arsimit të mesëm të ulët (klasa 6-9), 25,3% të gjimnazeve dhe 28,2% mësimdhënës të shkollave profesionale (për mësimdhënësit e klasave 6-9 dhe 10-13 është kërkuar përcaktimi për klasat ku mësimdhënësi realizon numër më të madh të orëve mësimore).

Lidhur me specifikat e tjera të mostrës së mësimdhënësve, të dhënat pasqyrojnë pjesëmarrje në studim prej 59,8% të mësimdhënësve të gjinisë femërore dhe 40,2% të asaj mashkullore. Lidhur me moshën dhe nivelin e kualifikimit të mësimdhënësve të përfshirë në studim, rezulton pasqyra e tabelës 19, ndërsa në tabelën 20 është paraqitur struktura e

mostrës së mësimdhënësve mbi baza të fushës/lëndës që e zhvillon në shkolla.

Tabela 19. Mosha dhe kualifikimi i mësimdhënësve të përfshirë në studim (%)

Moshë				Kualifikimi			
25-30	31-40	41-50	mbi 50	Shkollë e lartë	Fakultet	Master	Doktoratë
12,8	24,9	35,6	26,7	24,6	56,5	18,9	0

Tabela 20. Mostra e mësimdhënësve specifikuar në fushën mësimore/lëndën që mbulon në shkolla (%)

Fusha /Lënda mësimore	Nr	%
Mësim klasor	66	19,7
Gjuhë amtare	32	9,6
Gjuhë angleze	31	9,3
Artet	4	1,2
Matematikë	35	10,4
Shkencat e natyrës	51	15,2
Shkencat shoqërore	31	9,3
Teknologji me TIK	23	6,9
Edukatë fizike	7	2,1
Lëndë profesionale	50	14,9
Gjuhë frënge	5	1,5
Gjithsej	335	100

Bazuar në përqindjet e paraqitura në tabelën paraprake rezulton se në strukturën e mostrës së mësimdhënësve përqindje më të lartë të përfshirjes ka nga mësimdhënësit e ciklit klasor (19,70%), të shkencave të natyrës (15,22%) dhe të lëndëve profesionale (14,93%), përderisa më pak të përfshirë në studim janë mësimdhënësit e arteve (muzikë dhe vizatim), 1,19%.

Meqenëse kriter për përzgjedhje të mostrës në studim ka qenë përfshirja e mësimitdhënësve në programin e ECDL-së, atëherë, përmes kërkesave të shtruar në pyetësorë, kemi evidentuar të dhëna për rezultatet e tyre në këtë program, specifikisht informacioni për kalueshmëri në modulën përkatëse të programit. Tabela në vazhdim paraqet të dhënat për kalueshmërinë e moduleve përkatëse nga mësimitdhënësve.

Tabela 21. Të dhënat për kalueshmërinë e moduleve përkatëse nga ana e mësimitdhënësve (%)

Të përfshirë në modulën përkatëse	M1	M2	M3	M4	M5	M6	M7
Të dhëna për modulën përkatëse (nr dhe %)	%	%	%	%	%	%	%
Kam vijuar ligjëratat dhe kam ndërprerë trajnimin	9,7	6,98	7,69	10,03	14,43	9,84	13,51
Jam testuar 1 herë dhe kam ndërprerë modulën	13,5	18,41	15,71	15,21	16,44	18,69	18,58
Jam testuar 2 e më shumë herë dhe kam ndërprerë modulën	4,1	3,17	2,24	2,91	2,01	3,61	3,04
Kam kaluar modulën përkatëse	72,7	71,44	74,36	71,85	67,12	67,87	64,86
Gjithsej	319	315	312	309	298	301	292

Nga të dhënat e tabelës evidentohet se mësimitdhënësve të përfshirë në studim numër (%) më të madh të kalueshmërisë kanë treguar në modulën e tretë - Përpunimi i teksteve (Windows XP), 74,36%; në modulën e parë - Bazat e teknologjisë së informimit dhe komunikimit (ICT) 72,7% dhe në modulën e dytë - Shfrytëzimi i kompjuterit dhe menaxhimi i fajllave (Word) 71,44%.

3.2.2. Njohuritë dhe shkathtësitë e mësimitdhënësve për përdorimin e kompjuterit dhe programeve të tij PARA dhe PAS trajnimit

Analiza e këtij faktori realizohet përmes 8 kërkesave në pyetësorë, që kanë të bëjnë me njohuritë dhe shkathtësitë e mësimitdhënësve për përdorimin e kompjuterit dhe programeve të tij para dhe pas procesit të trajnimit për programin e ECDL-së.

Për të marrë përgjigje në pyetësorin e realizuar me ta kemi shtruar pyetje që mundësojnë përgjigje nga 1 (të pamjaftueshme) në 5 (të larta).

Rezultatet e krahasueshme, përqindjet e prezantuara në tabelën vijuese (tabela x), shprehin mendimet e që kanë mësimitdhënësit lidhur me njohuritë dhe shkathtësitë e tyre për përdorimin e kompjuterit dhe programeve të tij para trajnimit për programin e ECDL-së, si dhe ndikimet që ka pasur trajnimi në ngritjen e kompetencave të tyre për këtë aspekt, të cilat janë të paraqitura në tabelën në vijim.

Tabela 22. Njohuritë dhe shkathtësitë e mësimitdhënësve për përdorimin e kompjuterit dhe programeve të tij PARA dhe PAS trajnimit
5=të larta, 4= të kënaqshme, 3=të mira, 2= të mjaftueshme, 1=të pamjaftueshme

PRARA TRAJNIMIT (%)						
Pohimi	5	4	3	2	1	Gjithsej
Word	14,8	22,12	26,06	14,55	22,42	330
Excel	9,5	17,85	24,62	16	32	325
Power Point	12,9	19,18	17,3	17,61	33,02	318
Internet	19	24,13	17,14	18,41	21,27	315
PAS TRAJNIMIT (%)						
Pohimi	5	4	3	2	1	Gjithsej
Word	42,3	27,9	16	9,7	4,1	330
Excel	32,1	34,3	18,2	9,4	6,0	318
Power Point	40,7	25,6	19,2	10,1	4,4	317
Internet	43,7	26,3	17,7	8,5	3,8	316

Të dhënat e tabelës paraprahe pasqyrojnë lëvizje të konsiderueshme, sa i përket përqindjes së përgjigjeve, prej shkallës së vlerësimit maksimal 5 (njohuri dhe shkathtësi të larta) deri te ai minimal 1 (njohuri dhe shkathtësi të pamjaftueshme), në të dy fazat e përdorimit të kompjuterit dhe programeve të tij: PARA dhe PAS trajnimit të mësimdhënësve për programin e ECDL-së.

Specifikuar në përqindjen më të lartë të mësimdhënësve që janë përgjigjur për programin përkatës kompjuterik, rezulton se PARA trajnimit, mësimdhënësit kanë treguar njohuri dhe shkathtësi të konsiderueshme (të larta dhe të kënaqshme) për programin Internet (43,13%), përderisa nivel të ulët (të mjaftueshme dhe të pamjaftueshme) të njohurive dhe shkathtësive të programi Power Point (50,63%).

PAS trajnimit të mësimdhënësve për programin e ECDL-së, kemi lëvizje të përcaktimeve për nivelin e njohurive dhe shkathtësive, meqenëse te vlerësimi i lartë (të larta dhe të kënaqshme) përqindje më të lartë të atyre që janë përgjigjur kemi te programi Word (70,02%), ndërsa nivel më të ulët të njohurive dhe shkathtësive (të mjaftueshme dhe të pamjaftueshme) kemi për programin Excel (15,4%).

Ky krahasim i të dhënave orienton në ndikimet pozitive që ka pasur trajnimi i mësimdhënësve për programin e ECDL-së, sidomos kur kihet parasysh se të gjitha të dhënat e paraqitura në tabelën paraprahe eidentojnë lëvizje pozitive në nivelet e përfitimit të mësimdhënësve për të gjitha programet kompjuterike të parashtruara në tabelë.

3.2.3. Zbatimi i TIK-ut dhe programeve të tij nga ana e mësimdhënësve

Analiza e këtij faktori realizohet përmes 15 kërkesave dhe ka të bëjë me atë se sa dhe si mësimdhënësit janë duke zbatuar në praktikat e mësimdhënies dhe nxënies njohuritë dhe shkathtësitë për përdorimin e përfituara përmes trajnimit për

programin e ECDL-së, si në rastin e planifikimit të orëve mësimore, përgatitjes së materialeve mësimore, hartimit të testeve për realizim me nxënës, raporteve, krijimit dhe mbajtjes së bazës së të dhënave (statistikave) me kompjuter, hulumtimit të materialeve mësimore (burimeve), komunikimit me prindër, kolegë, nxënës, angazhimin i nxënësve për përdorimin e TIK-ut dhe programet e tij për qëllime arsimore.

Pyetjet e shtruara janë pyetje që mundësojnë përgjigje nga 1 (asnjëherë) në 5 (çdoherë).

Analiza e pajtueshmërisë dhe mospajtueshmërisë së mësimdhënësve lidhur me zbatimin praktik të njohurive dhe shkathtësive për përdorimin e pajisjeve të TIK-ut dhe programeve kompjuterike dhe të dhënat e përfituara janë të prezantuara në tabelën 23 dhe shprehin mendimet që kanë mësimdhënësit për këtë faktor.

Tabela 23. Zbatimi i njohurive dhe shkathtësive të reja në praktikat e mësimdhënies dhe nxënies (%)
5=Çdoherë, 4=Shpeshherë, 3 = Nganjëherë, 2=Rrallëherë, 1=Asnjëherë

Pohimi	5	4	3	2	1	Gjithsej
Planifikim të orëve mësimore	23,2	31,0	25,0	10,2	10,5	332
Përgatitje të materialeve mësimore	29,3	33,8	21,7	9,8	5,5	328
Përgatitje të testeve për realizim me nxënës	55,7	21,2	11,1	6,8	5,2	325
Prezantim të materialeve, incizimeve në klasë	12,7	14,6	23,6	16,4	32,7	330
Përgatitje të raporteve	33,1	19,8	20,1	9,6	17,5	314
Krijimin dhe mirëmbajtjen e databazave (statistikave)	21,2	21,5	19,3	14,3	23,7	321
Hulumtimin e materialeve mësimore	37,0	36,7	15,5	5,5	5,5	330
Komunikim me kolegë, nxënës, prindër	20,5	34,0	26,2	8,7	10,5	332

Të dhënat e prezantuara në tabelën paraprake reflektojnë mendimin e mësimitdhënësve lidhur me zbatimin praktik të njohurive dhe shkathtësive të reja në procesin e mësimitdhënies dhe nxënies dhe, bazuar në përqindjen më të lartë të mësimitdhënësve përgjigjur, këto të dhëna pasqyrojnë nivel të lartë (*çdoherë* dhe *shpeshherë*) të zbatimit për hartimin e testeve për realizim me nxënës (76,9%), përderisa nivel i ulët i zbatimit (*rrallëherë* dhe *asnjëherë*) për prezantimin e materialeve dhe incizimeve në klasë (me projektor, bimer, etj.) Për informim më të detajuar lidhur me zbatimin e njohurive dhe shkathtësive të reja në procesin e mësimitdhënies dhe nxënies, i kemi krahasuar edhe të dhënat e fituara nga pyetësorët e realizuar me mësimitdhënës, specifikuar mbi bazën e llojit/profilin të shkollave përkatëse dhe rezultatet e fituara i kemi pasqyruar në tabelën në vijim.

Tabela 24. Zbatimi i njohurive dhe shkathtësive të reja në praktikat e mësimdhënies dhe nxënies specifikuar në tipin/profilin e shkollës përkatëse(%)

1= Rrallëherë dhe Asnjëherë, 2= Nganjëherë dhe 3= Shpeshherë dhe Çdoherë

Pohimi	Vlerësimi	1-5	1-9	Gjim.	Shk.pof.
Planifikim të orëve mësimore	3	50,8	44,6	55,4	66,3
	2	30,5	22,8	19,3	28,4
	1	18,6	32,6	25,3	5,3
	Nr	59	92	83	95
Për përgatitjen e materialeve mësimore	3	63,3	52,8	62,2	74,5
	2	23,3	25,8	17,1	20,2
	1	13,3	21,3	20,7	5,3
	Nr	60	89	82	94
Përgatitje të testeve për realizim me nxënës	3	72,9	78,4	67,5	87,4
	2	13,6	10,2	15,0	7,4
	1	13,6	11,4	17,5	5,3
	Total	59	88	80	95
Prezantim të materialeve, incizimeve në klasë	3	20,3	23,1	27,4	36,6
	2	33,9	19,8	22,6	22,6
	1	45,8	57,1	50,0	40,9
	Nr	59	91	84	93
Përgatitjen e raporteve	3	55,6	40,5	53,8	62,4
	2	24,1	25,0	16,3	16,1
	1	20,4	34,5	30,0	21,5
	Nr	54	84	80	93
Krijimin dhe mirëmbajtjen e databazave (statistikave)	3	52,6	31,8	41,0	50,0
	2	14,0	17,0	20,5	24,4
	1	33,3	51,1	38,6	25,6
	Nr	57	88	83	90
Hulumtimin e materialeve mësimore	3	83,1	67,0	70,2	78,5
	2	10,2	16,5	17,9	2,2
	1	6,8	16,5	11,9	19,4
	Nr	59	91	84	93
Komunikim me kolegë, nxënës, prindër	3	52,5	52,7	48,2	97,2
	2	30,5	19,8	28,9	4,2
	1	16,9	27,5	22,9	67,7
	Nr	64	90	82	93

Specifikuar në tipin/profilin e shkollës përkatëse, mësimdhënësit deklarojnë zbatim më të shpeshtë të njohurive

dhe shkathtësive të reja në procesin e mësimdhënies (*çdoherë dhe shpeshherë*) në aspektet përkatëse:

Shkollat fillore dhe të mesme të ulëta	<ul style="list-style-type: none"> - Krijimin dhe mirëmbajtjen e databazave (statistikave) 52, 6% - Hulumentimin e materialeve mësimore 83,1%
Shkollat profesionale	<ul style="list-style-type: none"> - Planifikim të orëve mësimore 66,3%; - Për përgatitjen e materialeve mësimore me 74,5% - Përgatitje të testeve për realizim me nxënës 87,4% - Prezantim të materialeve , incizimeve në klasë 36,6% - Përgatitjen e raporteve 62,4% - Komunikim me kolegë, nxënës, prindër 97,2%

Përveç zbatimit të njohurive dhe shkathtësive të reja nga ana e mësimdhënësve, në pyetësorë janë shtruar kërkesa edhe lidhur me atë se sa mësimdhënësit i angazhojnë nxënësit e tyre për përdorimin e TIK-ut dhe programeve të tij, për qëllime arsimore, si: përgatitja e detyrave mësimore, hulumentimi i materialeve mësimore, informimi për karrierë, komunikimi për detyrat dhe përmbajtjet arsimore etj.

Analiza e të dhënave lidhur me këtë angazhim e nxënësve, të dhënat e përfituara janë të prezantuara në tabelën x dhe shprehin mendimet që kanë mësimdhënësit për këtë faktor.

Tabela 25. Angazhimi i nxënësve për përdorimin e TIK-ut dhe programeve të tij në mësimnxënie (%)
5=Çdoherë, 4=Shpeshherë, 3 = Nganjëherë, 2=Rrallëherë, 1= Asnjëherë

Pohimi	5	4	3	2	1	Gjithsej
Për përgatitjen e detyrave mësimore	4,9	20,3	33,1	20	21,7	305
Për hulumtimin e materialeve mësimore në internet	12,9	41,2	28,3	9,8	7,8	318
Për përgatitje të materialeve për prezantim me Power Point	5,9	12,2	26,7	13,9	41,3	100
Për informim në karrierë në internet	10,4	19,2	30,6	15,3	24,5	303
Për komunikim në ‘Messenger’ lidhur me detyrat mësimore	3,8	14,4	20,2	22,4	39,2	307
Për komunikim në e-mail lidhur me shkollën	5,6	15	23,5	23,2	32,7	306
Për komunikim në ‘Facebook’ ose ‘Twiter’	1,9	11,8	16,9	19,5	49,9	308

Të dhënat e tabelës reflektojnë informacion lidhur me angazhimin e nxënësve për përdorimin e TIK-ut dhe programeve kompjuterike për mësimnxënie dhe bazuar në përqindjen më të lartë të nxënësve të përgjigjur, rezulton se mësimdhënësit angazhojnë nxënësit e tyre mjaft shpesh (*çdoherë* dhe *shpeshherë*) për hulumtimin e materialeve mësimore në internet (54,1%), ndërsa shumë pak (*rrallëherë*

dhe *asnjëherë*) për shfrytëzimin e komunikimit përmes ‘Facebook’-ut dhe ‘Twiter’-it për qëllime arsimore (68,9%).

Për informacion më të detajuar, kemi krahasuar shpeshhtësinë e angazhimit të nxënësve nga ana e mësimitdhënësve në raport me fushën/lëndën mësimore që mësimitdhënësi i caktuar e realizon me nxënës.

Të dhënat e fituara prezantojnë këtë pasqyrë:

- **Mësimitdhënësit e ciklit klasor**, më shpesh (*çdoherë* dhe *shpeshherë*) i angazhojnë nxënësit për hulumtimin e materialeve mësimore në internet (48,4%), përderisa më pak (*rrallëherë* dhe *asnjëherë*) për përgatitje të materialeve për prezantim me Power Point (88,7%);
- **Mësimitdhënësit e gjuhës amtare**, më shpesh (*çdoherë* dhe *shpeshherë*) i angazhojnë nxënësit për hulumtimin e materialeve mësimore në internet (69,2%), përderisa më pak (*rrallëherë* dhe *asnjëherë*) përderisa më pak (*rrallëherë* dhe *asnjëherë*) për përgatitje të materialeve për prezantim me Power Point (78,3%);
- **Mësimitdhënësit e gjuhës angleze**, më shpesh (*çdoherë* dhe *shpeshherë*) i angazhojnë nxënësit për hulumtimin e materialeve mësimore në internet (48,3%), përderisa më pak (*rrallëherë* dhe *asnjëherë*) për komunikim në ‘Facebook’ ose ‘Twiter’ lidhur me detyrat mësimore (71,4%);
- **Mësimitdhënësit e arteve** (vizatim, muzikë), më shpesh (*çdoherë* dhe *shpeshherë*) i angazhojnë nxënësit për hulumtimin e materialeve mësimore në internet (70%), përderisa më pak (*rrallëherë* dhe *asnjëherë*) për përgatitje të materialeve për prezantim me Power Point, për informim

në karrierë dhe për komunikim në e-mail dhe ‘Messenger’ për detyrat mësimore (75%);

- **Mësimdhënësit e matematikës**, më shpesh (*çdoherë* dhe *shpeshherë*) i angazhojnë nxënësit për informim në karrierë në internet (31,3%), përderisa më pak (*rrallëherë* dhe *asnjëherë*) për komunikim në ‘Facebook’ dhe ‘Twitter’ lidhur me detyrat mësimore (71%);
- **Mësimdhënësit e shkencave të natyrës** (Fizikë, Biologji, Kimi), më shpesh (*çdoherë* dhe *Shpeshherë*) i angazhojnë nxënësit për hulumtimin e materialeve mësimore në internet (66,7%), përderisa më pak (*rrallëherë* dhe *asnjëherë*) për komunikim në ‘Facebook’ dhe ‘Twitter’, lidhur me detyrat mësimore (54,5%);
- **Mësimdhënësit e shkencave shoqërore** (Gjeografi, Edukatë qytetare, Psikologji, Sociologji, Jeta dhe puna) më shpesh (*çdoherë* dhe *Shpeshherë*) i angazhojnë nxënësit për hulumtimin e materialeve mësimore në internet (51,7%), përderisa më pak (*rrallëherë* dhe *asnjëherë*) për komunikim në ‘Facebook’ dhe ‘Twitter’, lidhur me detyrat mësimore (69%);
- **Mësimdhënësit e teknologjisë me TIK** më shpesh (*çdoherë* dhe *shpeshherë*) i angazhojnë nxënësit për hulumtimin e materialeve mësimore në internet (70%), përderisa më pak (*rrallëherë* dhe *asnjëherë*) për komunikim në ‘Facebook’ ose ‘Twitter’ lidhur me detyrat mësimore (73,7%);
- **Mësimdhënësit e edukatës fizike** më shpesh (*çdoherë* dhe *shpeshherë*) i angazhojnë nxënësit për komunikim në ‘Messenger’ lidhur me detyrat mësimore (20%), përderisa

më pak (*rrallëherë* dhe *asnjëherë*) për përgatitje të materialeve për prezantim me Power Point (80%).

- **Mësimdhënësit e lëndëve profesionale** më shpesh (*çdoherë* dhe *shpeshherë*) i angazhojnë për hulumtimin e materialeve mësimore në internet (63,8%), përderisa më pak (*rrallëherë* dhe *asnjëherë*) për komunikim në ‘Facebook’ ose ‘Twiter’ lidhur me detyrat mësimore (65,2%).

Nga ky krahasim i të dhënave evidentohet një angazhim mjaft i madh i nxënësve nga mësimdhënësit, pothuajse të të gjitha fushave/lëndëve, për përdorim të TIK-ut dhe programeve kompjuterike për hulumtimin e materialeve mësimore në internet, ndërsa vërehet një mangësi e madhe e angazhimit në shfrytëzimin e portaleve digjitale komunikuese (e-mail, ‘Facebook’, ‘Twiter’ etj.), për qëllime arsimore, në rastin konkret për komunikim ndërmjet nxënësve për përmbajtjet dhe detyrat mësimore.

Të dhëna më të detajuara lidhur me këtë krahasimin ofron tabela në vazhdim.

Tabela 26. Angazhimi i nxënësve krahasuar me profilin/lëndën mësimore të mësimdhënësve të anketuar (%)

1= Rrallëherë dhe Asnjëherë, 2= Nganjëherë dhe 3= Shpeshherë dhe Çdoherë

Pohimi	Vlerësimi	Mësues klase	Gj.amtare	Gj.angleze	Arte	Matematikë	Shk. e natyrës	Shk. shoq.	Teknologji me TIK	Ed.fizike	Lëndë profesionale
Për përgatitjen e detyrave mësimore	1	50,8	48	37,9	50	60	48,8	24,1	4,8	75	28,9
	2	33,3	20	34,5	25	33,3	31,7	48,3	28,6	25	33,3
	3	15,9	32	27,6	25	6,7	19,5	27,6	66,7	-	37,8
	Nr	63	25	29	4	30	41	29	21	4	45
Për hulumtimin e materialeve mësimore	1	32,8	3,8	13,8	25	27,3	15,6	10,3	5	33,3	8,5
	2	18,8	26,9	37,9	-	42,4	17,8	37,9	25	50	27,7
	3	48,4	69,2	48,3	75	30,3	66,7	51,7	70,0	16,7	63,8
	Nr	64	26	29	4	33	45	29	20	6	47
Për përgatitjen e materialeve për prezantim	1	88,7	78,3	57,7	75	56,3	44,4	32,1	10	80	34,8
	2	8,1	13,0	30,8	-	31,3	22,2	60,7	35	20	37
	3	3,2	8,7	11,5	25	12,5	33,3	7,1	55	-	28,3
	Nr	62	23	26	4	32	45	28	20	5	46
Për informim në karrierë	1	55,6	32	50	75	50	28,3	37,9	15,8	25	25
	2	31,7	40	25	-	18,8	37,0	20,7	26,3	75	38,6
	3	12,7	28	25	25	31,3	34,8	41,4	57,9	-	36,4
	Nr	63	25	28	4	32	46	29	19	4	44
Për komunikim në 'Messenger'	1	69,2	73,1	70,4	75	65,6	46,7	64,3	45	60	52,2
	2	15,4	19,2	11,1	-	21,9	22,2	32,1	20	20	23,9
	3	15,4	7,7	18,5	25	12,5	31,1	3,6	35	20	23,9
	Nr	65	26	27	4	32	45	28	20	5	46
Për komunikim në e-mail	1	67,7	70,8	66,7	75	62,5	43,2	48,3	35	50	42,2
	2	17,7	16,7	14,8	-	18,8	34,1	27,6	40	50	22,2
	3	14,5	12,5	18,5	25	18,8	22,7	24,1	25	-	35,6
	Nr	62	24	27	4	32	44	29	20	6	45
Për komunikim në 'Facebook' ose 'Twiter'	1	76,2	76	71,4	50	71	54,5	69	73,7	66,7	65,2
	2	11,1	12	17,9	25	9,7	18,2	24,1	26,3	33,3	10,9
	3	12,7	12	10,7	25	19,4	27,3	6,9	-	-	23,9
	Nr	63	25	28	4	31	44	29	19	6	46

Në pyetjen pse ata (mësimdhënësit) nuk i zbatojnë pajisjet e TIK-ut dhe programet kompjuterike në procesin mësimor, mësimdhënësit janë përgjigjur:

- ✓ Nuk e ndiej ende veten të sigurt për përdorimin e pajisjeve dhe programeve kompjuterike (28,9%);
- ✓ Ndihem më rehat në mësimdhënie pa përdorim të teknologjisë së informacionit në procesin arsimor (29,6%);
- ✓ Përdorimi i teknologjisë së informacionit në mësimdhënie ndikon negativisht në suksesin e nxënësve (2,6%);
- ✓ Nxënësit nuk u përgjigjen kërkesave për përdorim të teknologjisë së informacionit në punën e tyre arsimore (15%);
- ✓ Mungojnë këto pajisje në shkolla (23%).

Të dhënat e evidentuara pasqyrojnë qartë mosgatishmërinë e mësimdhënësve për zbatim të njohurive dhe shkathtësive të reja të fituara përmes programit të ECDL-së në procesin e mësimdhënies dhe nxënies, duke vënë në radhë të parë pasigurinë dhe ndjenjën e rehatisë në mësimdhënie pa zbatimin e këtyre teknologjive në njërën anë dhe theksimin e mungesës së këtyre pajisjeve në anën tjetër.

3.2.4. Mbështetja që u ofrohet mësimdhënësve për zbatimin e njohurive dhe shkathtësive të përfituara përmes programit të ECDL-së në praktikën e mësimdhënies dhe nxënies

Për të shkuar edhe më tutje në identifikimin e ndikimit të trajnimit të mësimdhënësve për programin ECDL-së në procesin e mësimdhënies dhe nxënies, në pyetësorin e realizuar

me mësimdhënës kemi shtruar kërkesa edhe lidhur me atë se çfarë mbështetje fizike dhe bashkëpunuese ofron shkolla për mësimdhënësit në funksion të zbatimit praktik të njohurive dhe shkathtësive të reja. Ky faktor u realizua përmes 10 pyetjeve që mundësojnë përgjigje që shkojnë nga 1 (asnjëherë) në 5 (çdoherë).

Analiza e pajtueshmërisë dhe mospajtueshmërisë së mësimdhënësve lidhur me mbështetjen dhe të dhënat e përfituara janë të prezantuara në tabelën 27 dhe shprehin mendimet që kanë mësimdhënësit për këtë faktor.

Tabela 27. Kushtet që ofron shkolla për zbatimin e njohurive dhe shkathtësive të reja (%)

5=Çdoherë, 4=Shpeshherë, 3 = Nganjëherë, 2=Rrallëherë, 1=Asnjëherë

Pohimi	5	4	3	2	1	Gjith.
Kompjuter/laptop	16,2	10,1	15,3	13,2	45,2	327
Grafoskop	5,5	3,6	7,5	7,5	75,9	307
Projektor	14,6	7,1	12,1	10,6	55,6	322
Fotokopje	38,3	17,9	16,4	12,5	14,9	329

Bazuar në përqindjen më të lartë të mësimdhënësve të përgjigjur, të prezantuar në tabelën paraprake, rezulton se për zbatimin praktik të njohurive dhe shkathtësive të reja nga ana e mësimdhënësve shumë më shpesh (çdoherë dhe shpeshherë) shkollat ofrojnë fotokopje (56,2%), krahasuar me aparaturën tjetër të TIK-ut, ndërsa përqindje e lartë e të përgjigjurve (78,3%) është evidentuar te mungesa e ofrimit (rrallëherë dhe asnjëherë) të projektorit/bimerit për përdorim nga mësimdhënësit.

Të dhënat e ofruara në tabelën paraprake japin një informacion të përgjithshëm lidhur me atë se çfarë kushtesh ofrojnë shkollat në mbështetje të mësimdhënësve për realizimin me sukses të procesit të mësimdhënies dhe nxënies, përfshirë edhe zbatimin e TIK-ut dhe programeve të tij në funksion të avancimit të këtij procesi. Për të pasur një pasqyrë sa më të detajuar për këtë faktor, ne kemi bërë një krahasim të këtyre të dhënave me tipin/llojin e shkollës prej nga vijnë mësimdhënësit e anketuar dhe e kemi paraqitur në tabelën në vazhdim.

Tabela 28. Kushtet që ofron shkolla për zbatimin e njohurive dhe shkathtësive të reja krahasuar me tipin/profilin e shkollës përkatëse (%)
1= Rrallëherë dhe Asnjëherë, 2= Nganjëherë dhe 3= Shpeshherë dhe Çdoherë

Pohimi	Vlerësimi	Filllore	E mesme e ulët	Gjimnaz	Sh. Profesional e
Kompjuter/laptop	1	66,1	61,1	53,6	55,0
	2	17,0	17,8	14,3	13,2
	3	17,0	21,1	32,1	31,9
	Nr	59	90	84	91
Projektor	1	87,3	88,2	88,5	71,3
	2	9,1	3,5	6,4	11,5
	3	3,6	8,2	5,1	17,2
	Nr	55	85	78	87
Fotokopje	1	19,7	25,3	32,9	29,4
	2	11,5	8,8	18,3	26,1
	3	68,9	65,9	48,8	44,6
	Nr	61	45	82	92

Nëse i analizojmë me kujdes të dhënat e krahasuara në tabelën paraprake, evidentojmë se në funksion të zbatimit praktik të

njohurive dhe shkathtësive të reja për zbatimin e TIK-ut dhe programeve kompjuterike në procesin e mësimdhënies dhe nxënies nga shkollat ofrohet:

- **Kompjuteri/llaptopi** më shpesh (*çdoherë* dhe *Shpeshherë*) ofrohet nga gjimnazet (32,1%), përderisa më pak (*rrallëherë* dhe *asnjëherë*) te shkollat fillore dhe ato të mesme të ulëta (66,1%);
- **Projektori** më shpesh (*çdoherë* dhe *shpeshherë*) ofrohet te shkollat profesionale (17,2%), përderisa më pak (*rrallëherë* dhe *asnjëherë*) te gjimnazet (88,5%);
- **Fotokopja** më shpesh (*çdoherë* dhe *shpeshherë*) ofrohet te shkollat fillore (68,9%), përderisa më pak (*rrallëherë* dhe *asnjëherë*) te gjimnazet (32,9%).

Bazuar në këtë krahasim, mund të themi se mësimdhënësit e angazhuar në nivelin e arsimit të mesëm të ulët kanë më pak mundësi të zbatojnë në praktikë njohuritë dhe shkathtësitë e fituara nga trajnimit për programin e ECDL-së, meqenëse shkollat e këtij niveli shumë më pak ofrojnë kushte/infrastrukturë të TIK-ut, krahasuar me shkollat e nivelit fillor dhe atij të mesëm të lartë (gjimnazet dhe shkollat profesionale).

Më tutje kemi vazhduar me hulumtimin e alternativave të mësimdhënësve për përdorim të pajisjeve të teknologjisë së informacionit në procesin arsimor, në rastet kur shkollat nuk i ofrojnë këto pajisje. Në pyetjet e shtruara në pyetësor, ne kemi synuar të informohemi me format alternative që ata i zbatojnë në raport me gjetjen e zgjidhjes për zbatim të njohurive të reja në procesin e mësimdhënies dhe nxënies. Të dhënat e fituara nga analiza e përgjigjeve të tyre janë të paraqitura në tabelën në vazhdim.

Tabela 29. Alternativat kur shkolla nuk ofron aparaturën e TIK-ut (%)
5=Çdoherë, 4=Shpeshherë, 3 = Nganjëherë, 2=Rrallëherë, 1=Asnjëherë

Pohimi	5	4	3	2	1	Nr.
Unë shfrytëzoj kompjuterin/ lllaptopin privat	25,2	26,1	16,5	14	18,2	322
Unë shfrytëzoj kompjuterin/llaptopin privat, të kolegëve	0,9	4,1	17,6	19,2	58,2	318
Unë shfrytëzoj kompjuterin/llaptopin me pagesë (internet kafe, etj)	1,9	6,8	10,6	13,5	67,2	310
Unë shfrytëzoj fotokopjen private	17,5	18,8	30	14,6	19,1	320
Unë shfrytëzoj fotokopje me pagesë	16,4	17	30	13,6	23	317
Unë shfrytëzoj projektor privat	3,2	3,2	8,7	10,6	74,3	312

Të dhënat e pasqyruara në tabelën paraprake orientojnë në informacionin që mësimdhënësit shumë më shpesh (*çdoherë* dhe *shpeshherë*) janë të detyruar të përdorin kompjuterin/ lllaptopin privat (51,3%) dhe fotokopje private (36,3%), ndërsa shumë më pak (*rrallëherë* dhe *asnjëherë*) e shfrytëzojnë projektorin privat (84,9%) dhe kompjuter/llaptop me pagesë – internet-kafe, etj. (80,7%) për qëllime të mësimdhënies.

Sa i përket mbështetjes bashkëpunuese që mësimdhënësit kanë brenda shkollës në funksion të realizimit praktik të njohurive dhe shkathtësive të reja, vlen të përmendet deklarimi i tyre për bashkëpunim të shpeshtë (*çdoherë* dhe *shpeshherë*) që ata kanë me drejtorin/zv.drejtorin e shkollës (49,8%), me kolegët e së njëjtës lëndë (47,8%) dhe me kolegët e lëndës së TIK-ut (46,7%) në funksion të këtij zbatimi, ndërsa mbetet ende në nivel të ulët bashkëpunimi me bashkëpunëtorët profesionalë - psikologun/pedagogun (62,3%) në këtë funksion.

Ndoshta ky mosbashkëpunim edhe mund të arsyetohet me faktin se në shumë shkolla të përfshira në studim mungon angazhimi/punësimi i një stafi të tillë profesional dhe kjo ka reflektuar edhe në përgjigjen e një numri të madh të mësimitdhënësve për këtë mosbashkëpunim, duke mos e potencuar mungesën e tyre në shkolla dhe pamundësinë për të pasur ndihmën e tyre edhe për aspekte të mbështetjes për zbatim të njohurive dhe shkathtësive të reja në proces. Për më shumë, shikon tabelë në vazhdim.

Tabela 30. Mbështetja bashkëpunuese brenda shkollës në funksion të zbatimit të njohurive dhe shkathtësive të reja në procesin e mësimitdhënies dhe nxënies (%)

5=Çdoherë, 4=Shpeshherë, 3 = Nganjëherë, 2=Rrallëherë, 1=Asnjëherë

Pohimi	5	4	3	2	1	Nr.
Drejtorin/zv.drejtorin	24,9	24,9	21,4	13,3	15,5	309
Pedagogun/psikologun	10,7	10,4	16,6	8,3	54	289
Kolegët/mësimitdhënësit e TIK-ut	23,2	23,5	26,7	14,3	12,4	315
Kolegët e së njëjtës lëndë	23,9	23,9	25,2	12,3	14,8	310
Nxënës që njohin mirë TIK-un	13,7	20,3	24,5	15,7	25,8	306

3.2.5. Ndikimi i trajnimit të mësimitdhënësve për programin e ECDL-së në procesin e mësimitdhënies dhe nxënies

Analiza e këtij faktori realizohet përmes 10 pyetjeve të shtruara në pyetësor dhe ka të bëjë me atë se sa ka ndikuar trajnimi i tyre për programin e ECDL-së në praktikat e tyre të mësimitdhënies dhe nxënies, si përgatitja për orën mësimore, përdorimi i më shumë metodave të mësimitdhënies, përdorimi i më shumë teksteve/materialeve alternative me nxënës, ndikimi në rezultatet mësimore të nxënësve, në shpeshhtësinë e kryerjes

së detyrave të shtëpisë nga ana e nxënësve, në bashkëpunimin me prindër, zvogëlimin e braktisjes në shkollë, etj.

Pyetjet e shtruara janë pyetje që mundësojnë përgjigje nga 4 (plotësisht) në 1 (aspak).

Analiza e pajtueshmërisë dhe mospajtueshmërisë së mësimdhënësve lidhur me zbatimin praktik të njohurive dhe shkathtësive për përdorimin e pajisjeve të TIK dhe programeve kompjuterike dhe të dhënat e përfituara janë të prezantuara në tabelën 31 dhe shprehin mendimet që kanë mësimdhënësit për këtë faktor.

Tabela 31. Ndikimi i trajnimit të mësimdhënësve në procesin e mësimdhënies dhe nxënies (%)

4=Plotësisht, 3 = Mesatarisht, 2=Pak, 1= Aspak

Pohimi	4	3	2	1	Nr.
Unë jam më mirë e përgatitur për orën mësimore	58,7	25	12	4,2	308
Unë përdor më shumë metoda të mësimdhënies	58,6	31,7	5,5	4,2	309
Unë përdor më shumë tekste/materiale alternative me nxënës	52,1	33,2	10,3	4,3	301
Rezultatet mësimore të nxënësve janë më të larta	26,4	39,5	24,7	9,3	291
Nxënësit kryejnë më shpesh detyrat e shtëpisë	36	36	20,3	7,7	300
Nxënësit realizojnë së paku nga 2 projekte arsimore për një gjysmëvjetor	34,3	33,6	21,2	11	292
Nxënësit hulumtojnë dhe sjellin material alternative mësimore	39,1	22,7	27	11,3	282
Komunikimi me prindër është më i mirë	36,7	33,7	19,8	9,8	297
Prindërit janë më mirë të informuar për rezultatet dhe sjelljet e fëmijëve në shkollë	36,6	33,7	19,9	9,8	297
Braktisja e shkollës është ulur dukshëm	39,1	22,6	27	11,3	282

Nga të dhënat e paraqitura në tabelë mund të thuhet se, sipas mësimdhënësve të përfshirë në studim, programi i trajnimit ka pasur një ndikim të madh (*plotësisht* dhe *mesatarisht*) në zbatimin e më shumë metodave të mësimdhënies nga ana e mësimdhënësve (90,3%), në përdorimin e më shumë teksteve, materialeve alternative me nxënës (85,3%) dhe në përgatitjen më të mirë për orën mësimore (83,7%), ndërsa ndikim të ulët (*pak*) ka në hulumtimin dhe sjelljen e materialeve alternative mësimore (38,3%), në ngritjen e rezultateve mësimore (34%) dhe në angazhimin/realizimin e projekteve arsimore (32,2%). Krahasimi i përgjigjeve të mësimdhënësve lidhur me ndikimin e zbatimit të njohurive dhe shkathtësive të reja të përfituara përmes programit të ECDL-së në procesin arsimor, në raport me tipin/profilin e shkollave të përfshira në studim, është i pasqyruar në tabelën x, ku janë prezantuar përqindjet e përgjigjeve në shkallë të vlerësimit: 4 = *Plotësisht*, 3 = *Mesatarisht*, 2 = *Pak*, përderisa për nivelin 1 = *Aspak* nuk kemi pasur asnjë të përgjigjur dhe si i tillë nuk prezantohet fare në tabelë.

Tabela 32. Ndikimi i trajnimit të mësimitdhënësve në procesin e mësimitdhënies dhe nxënies, specifikuar në tipin/profilin e shkollës përkatëse (%)
4=Plotësisht, 3 = Mesatarisht, 2=Pak, 1=Aspak

Pohimi	Vlerësi mi	1-5	6-9	Gjim.	Shk. profesion.
Trajnimi më ka ndihmuar sepse unë jam më mirë e përgatitur për orën mësimore	4	65,5	51,2	55,1	66,3
	3	21,8	33,3	24,4	20,2
	2	12,7	15,5	20,5	13,5
	Nr	55	84	78	89
Unë përdor më shumë metoda të mësimitdhënies	4	69,1	61,3	51,9	55,6
	3	25,5	28,8	36,7	33,3
	2	5,5	10,0	11,4	11,1
	Nr	55	80	79	81
Rezultatet mësimore të nxënësve janë më të larta	4	67,9	58,0	46,8	42,4
	3	25,0	28,4	35,1	42,4
	2	7,1	13,6	18,2	15,3
	Nr	56	81	77	85
Unë përdor më shumë tekste/materiale alternative me nxënës	4	61,4	61,4	53,8	59,8
	3	28,1	31,3	30,0	36,8
	2	10,5	7,2	16,3	3,4
	Nr	57	83	80	87
Nxënësit kryejnë më shpesh detyrat e shtëpisë	4	57,1	56,4	40,8	33,7
	3	26,8	33,3	34,2	41,9
	2	16,1	10,3	25,0	24,4
	Nr	56	78	76	86
Nxënësit realizojnë së paku nga 2 projekte arsimore për një gjysmëvjetor	4	16,7	33,3	28,6	25,3
	3	46,3	37,3	39,0	37,3
	2	37,0	29,3	32,5	37,3
	Nr	54	75	77	83
Nxënësit hulumtojnë dhe sjellin materiale alternative mësimore	4	33,3	45,6	40,5	25,6
	3	38,9	31,6	31,6	43,0
	2	27,8	22,8	27,8	31,4
	Nr	54	79	79	86
Komunikimi me prindër është më i mirë	4	48,2	32,9	30,1	30,6
	3	25,0	42,1	32,9	32,9
	2	26,8	25,0	37,0	36,5
	Nr	56	76	73	85
Prindërit janë më mire të informuar për rezultatet dhe sjelljet e fëmijëve	4	51,8	41,6	28,0	31,0
	3	30,4	32,5	32,0	39,1
	2	17,9	26,0	40,0	29,9
	Nr	56	77	75	87
Braktisja e shkollës është ulur dukshëm	4	52,8	45,9	36,1	26,8
	3	13,2	25,7	18,1	30,5
	2	34,0	28,4	45,8	42,7
	Nr	53	74	72	82

Specifikuar në tipin/profilin e shkollës përkatëse, mësimdhënësit deklarojnë ndikim më të lartë të njohurive dhe shkathtësive të reja në procesin e mësimdhënies (plotësisht) në aspektet përkatëse:

- | | |
|--|--|
| | <ul style="list-style-type: none"> - Përdorimi i më shumë metodave të mësimdhënies (61,9%) - Rezultatet mësimore janë më të larta (67,9%) - Kryerja më e shpeshtë e detyrave të shtëpisë (57,1%) |
| Shkollat fillore dhe të mesme të ulëta | <ul style="list-style-type: none"> - Hulumtimi i materialeve mësimore nga ana e nxënësve (45,6%) - Komunikimi me prindër (48,2%) - Informimi më i mirë i prindërve për rezultatet dhe sjelljet e nxënësve (51,8%) - Ulja e shkallës së braktisjes së shkollës (52,8%) |
| Gjimnazet | <ul style="list-style-type: none"> - Realizimi i së paku 2 projekteve mësimore nga ana e nxënësve (33,3%) |
| Shkollat profesionale | <ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja për orët mësimore (66,3%) - Përdorim i më shumë teksteve/materialeve mësimore alternative me nxënës (61,4%) |

3.2.6. Kërkesat/nevojat e mësimitdhënësve për realizimin praktik të njohurive dhe shkathtësive të reja në praktikat e mësimitdhënies dhe nxënies

Analiza e këtij faktori përfshin 3 pyetje dhe ka të bëjë kryesisht me identifikimin e kërkesave/nevojave të mësimitdhënësve për mbështetje shtesë në funksion të realizimit praktik të njohurive dhe aftësive të reja.

Analiza e pajtueshmërisë dhe mospajtueshmërisë me pohimet e dhëna në pyetësor, përqindjet e prezantuara në tabelën vijuese shprehin mendimet që kanë mësimitdhënësit për aspekte të ndryshme lidhur me këtë faktor. Tabela në vazhdim pasqyron kërkesat e mësimitdhënësve sipas përqindjes.

Tabela 33. Kërkesat/nevojat e mësimitdhënësve për zbatimin në praktikë të njohurive dhe shkathtësive të reja në proces (%)
4=Plotësisht, 3 = Mesatarisht, 2=Pak, 1= Aspak

Pohimi	4	3	2	1	Nr.
Mendoj se kam nevojë për trajnim shtesë, enkas për përdorimin e TIK-ut në procesin e mësimitdhënies dhe nxënies	37,2	25	20,1	17,8	304
Mbështetje të vazhdueshme profesionale në shkollë për zbatimin e programeve të caktuara kompjuterike	53,4	26	13	7,9	292
Sigurim të kompjuterëve/ lloptopëve dhe pajisjeve përcjellëse në klasa	63,1	12,3	24,3	0,3	292

Bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelë, përqindja e dhënë orienton për kërkesë të identifikuar (*plotësisht* dhe *mesatarisht*) në të tri aspektet e shtrura në pyetësorë: për mbështetje të vazhdueshme profesionale (79,4%) dhe për pajisje të shkollave

me kompjuterë/laptopë dhe pajisje përcjellëse (75,4%), ndërsa kjo përqindje bie (*pak dhe aspak*) te nevoja për trajnim shtesë e mësimdhënësve (62,2%).

3.3. Rezultatet e dala nga hulumtimi i realizuar me nxënës

Strukturën e mostrës së nxënësve të përfshirë në studim e përbëjnë nxënësit e shkollave fillore - klasat e pesta, të shkollës së mesme të ulët - klasat e nënta dhe nxënësit e shkollës së mesme të lartë - klasat e 12-ta.

Tabela në vijim tregon numrin dhe përqindjen e nxënësve të përfshirë në studim, sipas klasave - niveleve.

Tabela 34. Struktura e mostrës së nxënësve të përfshirë në studim(%)

Klasa e pestë		Klasa e nëntë		Klasa e dymbëdhjetë			
				gjimnaz		Shk.profesionale	
Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
249	33.6	247	33,3	79	10,7	166	22,4

Sa i përket gjinisë së mostrës së nxënësve të përfshirë në studim, rezulton se nxënës të gjinisë femërore janë 50,47%, ndërsa ajo mashkullore prej 49,53%. Specifikuar në vendbanimin e nxënësve të përfshirë në studim, rezulton të kemi 30,77% të nxënësve me vendbanim në fshat, ndërsa 69,23% në qytet.

Me mostrën e nxënësve është realizuar një pyetësor i tipit të kombinuar (pyetje të hapura dhe me alternativa) dhe, përveç informacionit të përgjithshëm për nxënësit e përfshirë në studim, në pyetësor kemi shtruar edhe pyetje që lidhen drejtpërdrejt me fushën e studimit, apo pyetje për të përfituar informacion anësor nga nxënësit lidhur me aspekte të

ndryshme, që ndërlidhen me fushën e studimit dhe që plotësojnë informacionin, të cilin ne dëshirojmë ta sigurojmë nga anketimi.

3.3.1. Rezultatet e hulumtimit të realizuar me nxënësit e klasës së pestë

Në pyetjen e shtruar në pyetësoin e realizuar me nxënësit e klasës së pestë, lidhur me njohuritë dhe shkathtësitë e tyre për përdorim të TIK-ut dhe programeve bazë kompjuterike, kemi marrë informacione mjaft optimiste për këto aspekte, detajet e të cilave janë prezantuar në tabelën në vijim.

<i>Tabela 35. Përdorimi i programeve kompjuterike nga nxënësit (%)</i>	Pohimi	
	Po%	Gjithsej
Unë mund të shkruaj tekste me kompjuter	87,4	247
Unë mund të vizatoj dhe të ngjyros forma të ndryshme me kompjuter	84,5	245
Unë mund të luaj lojëra me kompjuter	93,9	247
Unë mund të komunikoj me e-mail	91,8	245

Rezultatet e pasqyruara në tabelë pohojnë një përqindje të lartë të përdorimit të programeve bazë për realizimin e lojërave kompjuterike (93,9%) dhe komunikimit me e-mail (91,8%). Në pyetjen se ku dhe si e kanë mësuar ata përdorimin e këtyre programeve, analiza e pyetësoit orienton në përfitimin e tyre në shtëpi dhe me përkrahjen e prindërve (48,8%), në shtëpi dhe në mënyrë të pavarur (29,2%), në shkollë (19,6%), në kurse për kompjuter (2,1%) dhe në internet-kafe (0,4%).

Lidhur me atë se sa mësimdhënësit i zbatojnë teknologjinë e informacionit dhe programet kompjuterike në praktikatat e tyre

të mësimdhënies dhe nxënies, të dhënat e fituara nga pyetësi i realizuar me nxënës ofrojnë këtë pasqyrë, të dhënë në tabelë.

<i>Tabela 35. Zbatimi i TIK dhe i programeve kompjuterike në procesin e mësimdhënies dhe nxënies(%)</i>	Pohimi	
	Po %	Gjithsej
Mësimdhënësit e Gjuhës shqipe	31,7	246
Mësimdhënësit e Gjuhës angleze	31,2	247
Mësimdhënësit e Matematikës	25,3	245
Mësimdhënësit e Artit/vizatimit	21	243
Mësimdhënësit e Edukatës muzikore	29,1	244

Të dhënat e fituara reflektojnë përqindje të ulët të zbatimit të TIK dhe programeve kompjuterike nga ana e mësimdhënësve, megjithatë, bazuar në këtë pasqyrë të përqindjeve, evidentohet zbatim pak më i theksuar nga mësimdhënësit e lëndëve gjuhësore (Gjuhë shqipe dhe Gjuhë angleze), përderisa ka pasqyrim më të ulët të zbatimit të lëndët e artit (Vizatim dhe Muzikë).

Angazhimi i nxënësve për përdorimin e TIK-ut dhe programeve kompjuterike për qëllime arsimore është identifikuar përmes tri pyetjeve të shtuara në pyetësor, rezultatet e së cilave janë paraqitur në tabelën në vijim.

<i>Tabela 36. Angazhimi i nxënësve për përdorim të TIK-ut dhe programeve kompjuterike për qëllime arsimore(%)</i>	Pohimi	
	Po%	Gjithsej
Për hulumtim të materialeve mësimore në internet	13,6	198
Për kryerjen e detyrave të shtëpisë me kompjuter	17,5	249
Kur mësimdhënësit më angazhojnë për të kryer detyra të shtëpisë me kompjuter, unë i kryej ato	71,9	243

Të dhënat e tabelës paraprake reflektojnë në përqindje të ulët lidhur me angazhimin e nxënësve për përdorimin e TIK-ut për qëllime arsimore. Në rastin kur ndodh ky angazhim, nxënësit deklarojnë gatishmëri të lartë të zbatimit, si në rastin e kryerjes së detyrave të shtëpisë me kompjuter (71,91%). Në rastet kur nuk ndodh ky angazhim i nxënësve nga ana e mësimitdhënësve, bazuar në përqindjen më të lartë të përgjigjeve, rezulton se nxënësit përdorin më shpesh (*çdoherë* dhe *shpeshherë*) TIK-un dhe programet kompjuterike për të komunikuar me shokë/shoqe në e-mail, ‘Facebook’, ‘Twiter’, etj. (30,49%), ndërsa më rrallë (*rrallëherë* dhe *asnjëherë*) ndodh ky zbatim për realizimin e detyrave mësimore (49,79%). Tabela në vijim paraqet të dhënat në përqindje.

Tabela 37. Përdorimi i TIK-ut dhe programeve kompjuterike nga nxënësit jashtë angazhimeve nga ana e mësimitdhënësve(%)
5=Çdoherë, 4=Shpeshherë, 3 = Nganjëherë, 2=Rrallëherë, 1=Asnjëherë

Pohimi	5	4	3	2	1	Nr.
Për kryerjen e detyrave mësimore	8,2	18,8	23,3	17,6	32,2	245
Për hulumtimin e materialeve mësimore	24,1	22,8	17,0	16,2	19,9	241
Për komunikim në e-mail, ‘Facebook’, ‘Twiter’ etj.	30,5	16,7	20,7	14,6	17,5	246
Për lojëra	13,4	14,2	24,7	16,6	31,2	247

Tabela 38. Profesionit i dëshiruar nga nxënësit në të ardhmen (%)

Frizer	2,2	Artist	3,1	Historian	,4
Mjek	28,9	Muzikant	2,2	Ushtar	,4
Ekonomist	3,1	Këngëtar	,9	Marinar	,4
Mësues	19,3	Inxhinier	4,8	Letrar	1,3
Veterinar	,9	Farmacist	1,3	Futbollist	7,9
Arkitekt	5,7	Studiues i Gj. angleze	,9	Polic	3,5
Biznesmen	1,8	Inxhinier i TIK	,9	Sportist	2,6
Jurist	1,3	Arkitekt	2,2	Instruktor	,4
Matematikian	,9	Dentist	,4	Doganier	,4
Pilot	,9	Basketbollist	,4	Xheodet	,4
Gjithsej					249

Pasqyra e tabelës mbi përcaktimin e nxënësve për profesionin e dëshiruar për të ardhmen jep një orientim për një llojlojshmëri të profileve dhe profesioneve të nxënësve të tanishëm – mjekëve, inxhinierëve, arkitektëve, mësimdhënësve, artistëve, etj., të së ardhmes, prandaj edhe zgjon ndërgjegjen dhe motivimin tonë për një angazhim më të madh në përgatitjen maksimale të këtyre fëmijëve për të ardhmen, përfshirë edhe përgatitjen e tyre në fushën e TIK-ut dhe teknologjive të tjera bashkëkohore.

3.3.2. Rezultatet e hulumtimit të realizuar me nxënësit e klasës së nëntë

Evidentimi i njohurive dhe shkathtësive të nxënësve për programet kompjuterike orienton në informacionin se nxënësit e klasës së nëntë kanë njohuri dhe aftësi më të larta (*të larta* dhe *të kënaqshme*) për programin Internet (90,6%) dhe programin Word (62,7%), përderisa nivel më të ulët (*të*

mjaftueshëm dhe *të pamjaftueshëm*) të njohurive dhe shkathtësive deklarohen te programi Power Point (23,8%) dhe te programi Excel (23,1%). Tabela në vazhdim paraqet njohuritë e nxënësve për programet kompjuterike në përqindje.

Tabela 38. Njohuritë dhe shkathtësitë e nxënësve për përdorimin e programeve kompjuterike(%)
 5= Të larta, 4= të kënaqshme, 3= Të mira, 2=Të mjaftueshme, 1=Të pamjaftueshme

Programi	5	4	3	2	1	Nr.
Word	27	35,7	28,2	6,2	2,9	241
Excel	13,6	27,7	35,5	13,6	9,5	242
P. Point	25	27	24,2	16,4	7,4	247
Internet	70,3	20,3	4,5	1,6	3,3	246

Lidhur me përfitimin e njohurive dhe aftësive, nxënësit janë deklaruar për përvetësimin e tyre në mënyrë të pavarur, në shtëpi (39,4%), përmes përkrahjes së anëtarëve të familjes (29,5%) dhe përmes programeve në shkollë (27,4%), ndërsa deklarojnë përqindje të ulët për vijimin e kurseve (2,5%) dhe internet kafeve (1,2%), për këtë qëllim.

Lidhur me atë se sa mësimdhënësit e tyre i zbatojnë teknologjinë e informacionit dhe programet kompjuterike në praktikat e tyre të mësimdhënies dhe nxënies, të dhënat e fituara nga pyetësi i realizuar i kemi paraqitur në tabelë.

Tabela 39. Zbatimi i programeve kompjuterike nga mësimdhënësit e lëndëve përkatëse (%)

Programi/lënda mësimore	Word	Power Point	Excel	Internet	Asnjërin	Nr.
Informatikës	59,7	10,3	8,2	8,2	13,6	243
Lëndëve gjuhësore	13,7	3,3	7,9	7,9	67,2	241
Lëndëve shkencore	5,4	1,7	6,7	13,8	72,4	239
Lëndëve të artit	8,8	6,3	3,4	10,1	71,4	238

Të dhënat e fituara reflektojnë përqindje të ndryshme sa i përket zbatimit të programeve kompjuterike nga ana e mësimeve. Bazuar në përqindjen më të lartë për programin përkatës evidentohet ky zbatim:

- ✓ Mësimeve të lëndës së informatikës - Word (59,7%);
- ✓ Mësimeve të lëndëve gjuhësore – Word (13,7%);
- ✓ Mësimeve të lëndëve shkencore – Internet (13,8%);
- ✓ Mësimeve të lëndëve të arteve – Word (8,8%).

Te përqindja e moszbatimit të njërës nga programet e përmendura kompjuterike përqindje më të lartë ka te lëndët shkencore (72,4%), lëndët e artit (71,4%) dhe lëndët gjuhësore (67,2%), përderisa te lënda e Informatikës kjo përqindje është më e ulët.

Sa i përket përdorimit të pajisjeve të TIK-ut nga ana e mësimeve të tyre në procesin mësimor, nxënësit deklarojnë përdorim të lartë të kompjuterit në këtë proces (32,5%), gjatë zhvillimit të përmbajtjeve mësimore, përdorim të projektorit gjatë gjithë orës (29,4%) dhe të grafoskopit gjatë zhvillimit të përmbajtjeve mësimore (8,7%), ndërsa përqindje më të lartë të moszbatimit të pajisjeve në asnjërën fazë të orës mësimore paraqesin te përdorimi i grafoskopit (81,8%). Përdorimi sipas fazave të orës është paraqitur edhe në tabelë.

Tabela 40. Përdorimi i pajisjeve të TIK-ut nga ana e mësimeve specifikuar në fazat e përdorimit (%)

Pohimi	Në fazën hyrëse të orës	Gjatë gjithë orës	Gjatë zhvillimit të përmbajtjes	Gjatë vlerësimit	Nuk përdoret	Nr.
Kompjuteri	6,2	21	32,5	5,3	35	243
Projektori	4,5	29,4	25,5	2,9	37,6	245
Grafoskopi	3,3	4,1	8,7	2,1	81,8	242

Lidhur me angazhimin e nxënësve nga mësimdhënësit për përdorimin e TIK dhe programeve kompjuterike për qëllime arsimore, nxënësit kanë deklaruar angazhim më të shpeshtë (*çdoherë* dhe *shpeshherë*) për hulumtimin e materialeve mësimore në internet (29,9%) dhe për informim në karrierë përmes internetit (26,4%), ndërsa potencohet angazhim më i rrallë (*rrallëherë* dhe *asnjëherë*) për komunikim në e-mail ose ‘Messenger’ lidhur me detyrat mësimore (84,7%) dhe për komunikim në ‘Facebook’ ose ‘Twiter’ lidhur me shkollën (78,5%).

Tabela 41. Angazhimi i nxënësve nga mësimdhënësit e tyre për përdorimin e TIK dhe programeve kompjuterike në procesin e nxënies (%)

5=Çdoherë, 4=Shpeshherë, 3 = Nganjëherë, 2=Rrallëherë, 1= Asnjëherë

Pohimi	5	4	3	2	1	Nr
Për përgatitjen e detyrave mësimore me kompjuter	3,3	8,6	29,4	22,9	35,9	245
Për hulumtimin e materialeve mësimore në internet	5,3	24,6	33,2	20,5	16,4	246
Për përgatitjen e materialeve për prezantim me Power Point	2	6,9	17,6	18,8	54,7	243
Për informim në karrierë në internet	12,8	13,6	20,7	16,9	36	242
Për komunikim në e-mail ose ‘Messenger’ lidhur	2,5	4,5	8,3	13,2	71,5	242
Për komunikim në ‘Facebook’ ose ‘Twiter’	6,2	5	10,3	13,2	65,3	242

Të dhënat e tabelës paraprake reflektojnë në përqindje të lartë lidhur me përdorimin e programeve kompjuterike në rastet kur ata angazhohen nga mësimdhënësit e tyre. Në rastet kur nuk ndodh ky angazhim, bazuar në përqindje më të lartë të të përgjigjurve, rezulton se nxënësit i përdorin më shpesh (çdoherë dhe shpeshherë) TIK-un dhe programet kompjuterike për komunikim në 'Facebook' ose 'Twiter' (76,8%), ndërsa më rrallë (rrallëherë dhe asnjëherë) ndodh zbatimi për informim në karrierë në internet (83,8%). Shikoni tabelën në vazhdim.

Tabela 42. Përdorimi i TIK-ut dhe programeve kompjuterike nga nxënësit jashtë angazhimeve nga ana e mësimdhënësve (%)
 5=Çdoherë, 4=Shpeshherë, 3 = Nganjëherë, 2=Rrallëherë, 1=Asnjëherë

Pohimi	5	4	3	2	1	Nr.
Për detyra mësimore	16	35,4	32,5	6,2	9,9	243
Për hulumtimin e materialeve mësimore në internet	18,4	31,6	32	8,2	9,8	244
Për përgatitjen e materialeve për prezantim me Power Point	4,9	11,5	24,6	21,7	37,3	244
Për informim në karrierë në internet	14,6	14,6	16,7	54,1	29,7	246
Për komunikim në 'Messenger'	26,8	24	15,4	19,9	13,8	246
Për komunikim në e-mail	23,9	20,2	25,9	18,1	11,9	243
Për 'Facebook' ose 'Twiter'	59,2	17,6	9	7,8	6,5	245
Për lojëra	17,1	19,9	26,4	23,2	13,4	246

3.3.3. Rezultatet e hulumtimit të realizuar me nxënësit e klasës së dymbëdhjetë

Evidentimi i njohurive dhe shkathtësive të nxënësve për programet kompjuterike orienton në informacionin se nxënësit e klasës së dymbëdhjetë kanë njohuri dhe aftësi më të larta (*të larta dhe të kënaqshme*) te programi Internet (85,5%) dhe programi Excel (65,6%), përderisa nivel më të ulët (*të mjaftueshëm dhe të pamjaftueshëm*) të njohurive dhe shkathtësive deklarohen te programi Power Point (12,5%) dhe te programi Excel (23,1%).

Tabela 43. Njohuritë dhe shkathtësitë e nxënësve për përdorimin e programeve kompjuterike (%)
5= Të larta, 4= të kënaqshme, 3= Të mira, 2=Të mjaftueshme, 1=Të pamjaftueshme

Programi	5	4	3	2	1	Nr.
Word	32,4	34,5	23,9	6,3	2,9	240
Excel	26,9	38,7	24,4	8,8	1,3	238
P. Point	37,3	26,6	23,7	7,1	5,4	241
Internet	61,7	23,8	7,5	2,9	4,2	240

Lidhur me përfitimin e njohurive dhe aftësive, nxënësit janë deklaruar për përvetësimin e tyre në shkollë (38,7%), në mënyrë të pavarur në shtëpi (35,7%), përmes përkrahjes së anëtarëve të familjes (14,3%), ndërsa deklarojnë përqindje të ulët për internet kafe (6,3%) dhe për vijimin e kurseve (5%) për këtë qëllim.

Lidhur me atë se sa mësimdhënësit e tyre zbatojnë teknologjinë e informacionit dhe programet kompjuterike në praktikën e tyre të mësimdhënies dhe nxënies, të dhënat e fituara nga pyetësori me nxënës ofrojnë këtë pasqyrë, të paraqitur në tabelë.

Tabela 44. Zbatimi i programeve kompjuterike nga mësimeve të lëndëve përkatëse specifikuar në tipin/profilin e shkollës (%)

Programi/lëndë a mësimore	Word		Power Point		Excel		Internet		Nr.
	Gj.	Sh.p	Gj.	Sh.p	Gj.	Sh.p	Gj.	Sh.p	
Informatikës	36,5	63,5	20,5	79,5	30,1	69,9	35,5	64,5	237
Lëndëve gjuhësore	35,4	64,6	50	50	8,3	91,7	20	80	239
Lëndëve shkencore	37,5	62,5	55,2	44,8	26,6	73,1	7,9	92,1	236
Lëndëve të artit	33,3	66,7	18,5	81,5	17,6	82,4	20	80	231

Të dhënat e fituara reflektojnë përqindje të ndryshme sa i përket zbatimit të programeve kompjuterike nga ana e mësimeve të lëndëve përkatëse. Bazuar në përqindjen më të lartë për programin përkatës mbi specifikën e profilit të shkollës evidentohet kjo zbatueshmëri:

Lënda	Gjimnazet	Shkollat profesionale
Informatikë	Word (36,5%)	Power Point (79,5%)
Lëndët gjuhësore	Power Point (50%)	Excel (91,7%)
Lëndët shkencore	Power Point (55,2%)	Internet (92,1%)
Artet	Word (33,3%)	Excel (82,4%)

Sa i përket përdorimit të pajisjeve të TIK-ut nga ana e mësimeve të lëndëve përkatëse në procesin mësimor, nxënësit deklarojnë përdorim të lartë të kompjuterit (30,5%), si dhe të

projektorit (31,3%) gjatë zhvillimit të përmbajtjeve mësimore, ndërsa përqindje më të lartë të moszbatueshmërisë së pajisjeve në asnjërën fazë të orës mësimore paraqesin te përdorimi i grafoskopit (82,3%).

Tabela 45. Përdorimi i pajisjeve të TIK-ut nga ana e mësimdhënësve, specifikuar në fazat e përdorimit (%)

Pohimi	Në fazën hyrëse të orës	Gjatë gjithë orës	Gjatë zhvillimit të përmbajtjes	Gjatë vlerësimit	Nuk përdoret	Nr.
Kompjuteri	6,2	23,9	30,5	4,1	35,1	243
Projektori	4,1	16,6	31,1	3,7	44,4	245
Grafoskopi	2,2	4,8	9,5	1,3	82,3	231

Lidhur me angazhimin e nxënësve nga mësimdhënësit e tyre për përdorimin e TIK-ut dhe programeve kompjuterike për qëllime arsimore, nxënësit kanë deklaruar angazhim më të shpeshtë (*çdoherë* dhe *shpeshherë*) për përgatitjen e detyrave mësimore (33,8%), ndërsa potencohet angazhim më i rrallë (*rrallëherë* dhe *asnjëherë*) për komunikim në ‘Facebook’ ose ‘Twiter’ lidhur me shkollën (74,3%) dhe për komunikim në e-mail ose ‘Messenger’ lidhur me detyrat mësimore (68,4%).

Tabela 46. Angazhimi i nxënësve nga mësimdhënësit e tyre për përdorimin e TIK-ut dhe programeve kompjuterike në procesin e nxënies (%)

5=Çdoherë, 4=Shpeshherë, 3 = Nganjëherë, 2=Rrallëherë, 1=Asnjëherë

Pohimi	5	4	3	2	1	Nr.
Për përgatitjen e detyrave mësimore me kompjuter	7,9	25,9	31,4	15,1	19,7	243
Për hulumtimin e materialeve mësimore në internet	10	25,8	27,5	18,3	18,3	240
Për përgatitjen e materialeve për prezantim me Power Point	7,4	13,3	26,4	20,2	32,2	242
Për informim në karrierë në internet	5	10,7	21,9	19	43,4	242
Për komunikim në e-mail/ 'Messenger' lidhur me detyrat	4,5	10,7	16,4	13,5	54,9	244
Për komunikim në 'Facebook' ose 'Twiter'	5	8,7	12	13,6	60,7	242

Të dhënat e tabelës paraprahe reflektojnë në përqindje lidhur me angazhimin e nxënësve nga mësimdhënësit e tyre për përdorimin e TIK-ut për qëllime arsimore, në rastin kur ndodh ky angazhim. Në rastet kur nuk ndodh ky angazhim i nxënësve nga ana e mësimdhënësve, bazuar në përqindjen më të lartë të të përgjigjurve, rezulton se nxënësit i përdorin më shpesh (*çdoherë* dhe *shpeshherë*) TIK-un dhe programet kompjuterike për detyra mësimore (51,1%), ndërsa më rrallë (*rrallëherë* dhe *asnjëherë*) ndodh ky zbatim për përgatitjen e materialeve për prezantim me Power Point (44,8%).

Tabela 47. Përdorimi i TIK-ut dhe programeve kompjuterike nga nxënësit jashtë angazhimeve nga ana e mësimitdhënësve
 5=Çdoherë, 4=Shpeshherë, 3 = Nganjëherë, 2=Rrallëherë, 1=Asnjëherë

Pohimi	5	4	3	2	1	Nr.
Për detyra mësimore	16,5	34,6	26,7	9,9	12,3	243
Për hulumtimin e materialeve mësimore në internet	15,6	30	32,1	11,9	10,3	243
Për përgatitjen e materialeve për prezantim me Power Point	11,2	16,2	27,8	20,7	24,1	241
Për informim në karrierë në internet	18,2	19	23,6	19,8	19,4	242
Për komunikim në 'Messenger'	21	21	23	18,1	16,9	243
Për komunikim në e-mail	23,5	24,3	23	15,6	13,6	243
Për 'Facebook' ose 'Twiter'	47,7	32,5	7,8	4,9	7	243
Për lojëra	9,1	8,7	15,7	28,9	37,6	242

Pasqyra e tabelës mbi përcaktimin e nxënësve për profesionin e dëshiruar për të ardhmen jep një orientim për një llojllojshmëri të profileve dhe profesioneve të nxënësve të tanishëm - astronomëve, biznesmenëve, arkitektëve etj., të së ardhmes, prandaj edhe zgjon përgjegjësinë dhe motivimin tonë për një angazhim më të madh në përgatitjen maksimale të këtyre të rinjve për të ardhmen, përfshirë edhe përgatitjen e tyre në fushën e TIK-ut dhe teknologjive të tjera bashkëkohore.

<i>48. Përcaktimi për profesionin e ardhshëm, specifikuar në profilin e shkollës aktuale/përkatëse</i>		
Pohimi	gjimnaz	shkollë profesionale
Ekonomik	8,8	17,2
Astronomi	1,5	
Inxh. kompjuterike	17,6	9,0
Biznes		,8
Arkitekturë	4,4	6,6
Mjekësi	5,9	7,4
Fakultet teknik	19,1	9,0
Arte	1,5	4,1
Psikologji	1,5%	4,9
Punëtor –profesion		3,3
Dogana dhe shpedicion		,8
Edukim	8,8	2,5
Fakulteti Filozofik	7,4	4,1
Juridik	2,9	11,5
Kimi	1,5	1,
Gazetari		1,6
Veterinari	1,5	1,6
Gjuhë e huaj	5,9	2,5
Fotograf	2,9	,
Dizajn		2,5
IT		,8
Sport		1,6
Matematikë financiare	5,9	
Fakulteti i Bujqësisë	1,5	2,5
Gjithsej	68	122

IV. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Rezultatet e studimit ofrojnë të dhëna mjaft të rëndësishme lidhur me trajnimin e stafit arsimor për programin e ECDL-së, zbatimin e njohurive dhe shkathtësive të përfituara përmes këtij programi në procesin e mësimdhënies dhe nxënies, ndikimet e para, si dhe kërkesat/nevojat për avancim të këtij procesi në të ardhmen.

Vlerësimi i studimit

Studimi është i bazuar në metodologjinë hulumtuese kuantitative dhe kualitative.

Shembuj të mirë të sigurimit të bazës së informacionit për fushën e studimit ishin bashkëpunimi me realizuesin e programit të trajnimit për ECDL-në, gjegjësisht marrëveshja me AUK-un në funksion të ofrimit të bazës statistikore *TeachECDL - AUK MasterFile 2013*, për qëllime të studimit. Një shembull tjetër i mirë ishte realizimi i studimit me mostrën e faktorëve kryesorë në procesin arsimor: drejtorët/zv.drejtorët, mësimdhënësit dhe nxënësit, dhe marrja e informacionit për aspektet e përfshira në studim drejtpërdrejt në shkolla.

Aspekt tjetër që vlen të përmendet është edhe bashkëpunimi i ngushtë brenda IPK-së, në funksion të realizimit të studimit, përfshirë hartimin e instrumenteve të studimit, realizimin e hulumtimit në terren, analizën e dokumentimit të të dhënave etj.

Gjetjet më të rëndësishme të studimit

Të gjeturat më të rëndësishme nga studimi janë përmbledhur në këtë raport, i cili është përgatitur me qëllim të pasqyrimin të (i) përfshirjes dhe përfitimit të stafit arsimor të arsimit

parauniversitar nga trajnimi për programin e ECDL-së, (ii) zbatimit të njohurive dhe shkathtësive të reja për TIK-un në procesin e mësimdhënies dhe nxënies, (iii) ndikimeve të para të trajnimit për këtë program në procesin e mësimdhënies dhe nxënies, dhe (iv) identifikimit të mundësive për avancim të zbatimit dhe ndikimit sa më efektiv të njohurive dhe shkathtësive të reja për TIK-un, të përfituara përmes programit të ECDL-së në procesin e mësimdhënies dhe nxënies në të ardhmen.

Nga analiza, krahasimi dhe diskutimi i rezultateve i kemi gjetjet si në vijim:

- Nga 28254, sa ka qenë gjithsej numri i personelit arsimor i angazhuar në arsimin parauniversitar në vitin akademik 2012/2013 në nivel vendi, në programin e ECDL-së kanë qenë të përfshirë gjithsej 12960 (45,87%).
- Nga numri i përgjithshëm (12960) i personelit arsimor të përfshirë në programin e ECDL-së, 6939 (53,54 %) e tyre kanë arritur të certifikohen për modulet e programit (ECDL Start ose ECDL Core), ndërsa bazuar në llojin e certifikimit të fituar, krahasuar me numrin e përgjithshëm të të certifikuarve, rezulton se 3140 (45,25%) e stafit përfitues në këtë program janë certifikuar për nivelin e *ECDL Start*, ndërsa 3799 (62,44%) janë certifikuar për nivelin e *ECDL Core*.
- Krahasuar mbi bazat komunale, përqindja më e madhe e përfshirjes në programin e ECDL-së ka qenë nga komuna e Mitrovicës (79,07%), Prishtinës (64,93%) dhe Prizrenit.
- Nga numri i përgjithshëm (12960) i personelit arsimor të përfshirë në programin e ECDL-së, 6939 (53,54 %) e tyre kanë arritur të certifikohen për modulet e programit ECDL Start, ose ECDL Core.

- Certifikimi në raport me përfshirjen, bazuar mbi bazën e lëndës/angazhimit në shkollë, ka qenë: mësimdhënës të matematikës 619 (70,34%), mësimdhënës të gjuhëve të huaja 603 (65,90%) dhe mësimdhënës/edukatorë të nivelit parashkollor/parafillor 45 (65,22%).
- Sipas llojit të certifikimit, përqindje më të lartë të të certifikuarve për nivelin ECDL Start kemi nga mësimdhënësit e ciklit klasor, 762 (24,27%), mësimdhënësit e shkencave të natyrës (Biologji, Fizikë, Kimi) dhe mësimdhënësit e shkencave shoqërore (Gjeografi, Ed. qytetare, Histori, Pedagogji, Sociologji etj.) 287 (9,14%), si dhe mësimdhënësit e lëndëve profesionale 246 (7,83%), ndërsa për nivelin ECDL Core kemi mësimdhënësit e ciklit klasor 1004 (26,43%), mësimdhënësit e lëndëve profesionale 413 (10,87%) dhe mësimdhënësit e Matematikës 405 (10,66%) të certifikuar.
- Krahasuar mbi bazën e vijuesve, përqindje më të lartë të të certifikuarve ka komuna e Ferizajt, 392 (84,30%) të certifikuar, komuna e Gjilanit 653 (70,44%) dhe komuna e Suharekës 434 (69,77%) të certifikuar.
- Krahasuar me nivele të certifikimit, përqindje më të lartë të të certifikuarve ka:
 - ECDL Start: Komuna e Prishtinës 398 (12,68%), komuna e Prizrenit 531 (13,98%) dhe komuna e Gjilanit 256 (8,15%) të certifikuar;
 - ECDL Core: Komuna e Prishtinës 614 (16,16%), komuna e Prizrenit 339 (10,80) dhe komuna e Gjilanit 397 (10,45%) të certifikuar;
 - Kalueshmëria e përgjithshme në modulet e programit të ECDL-së (përfundimi i modulit përkatës) ka qenë:
 - ✓ Moduli 1 - Bazat e teknologjisë së informimit dhe komunikimit (ICT): 7,2%;

- ✓ Moduli 2 - Shfrytëzimi i kompjuterit dhe menaxhimi i fajllave (Word): 49,2%;
 - ✓ Moduli 3 - Përpunimi i teksteve (Windows XP): 48,75%;
 - ✓ Moduli 4 - Kalkulimi i tabelave (Excel): 46,20%;
 - ✓ Moduli 5 - Baza e të dhënave (Access): 39,21%;
 - ✓ Moduli 6 - Prezantimet (Power Point): 45,62%;
 - ✓ Moduli 7- Interneti dhe komunikimi (Internet Explorer & Outlook): 46,42%.
- **Drejtorët/zv.drejtorët e shkollave të përfshira në studim (bazuar në përqindjen e fituar në shkallën më të lartë të vlerësimit) deklarojnë:**
 - Kënaqësi të lartë në zbatimin e njohurive dhe shkathtësive të reja të mësimdhënësve, krahasuar me vetë ndikimin dhe mundësitë për mbështetje.
 - Zbatim të njohurive dhe shkathtësive të reja të mësimdhënësve të përfituara përmes programit të ECDL-së: hartimi i materialeve mësimore, prezantimi i materialeve dhe incizimeve në klasë me projektor, hartimi/dorëzimi i raporteve të punës dhe databazave (statistikave) me kompjuter (shkollat fillore dhe të mesme të ulëta). Hartimi i planeve të punës dhe komunikimi me prindër në e-mail (në gjimnaze) dhe hartimi i testeve për realizim me nxënës, prezantimi i materialeve dhe incizimeve në klasë me projektor, hartimi i databazave (statistikave) me kompjuter dhe komunikimi me drejtorin/zv.drejtorin në e-mail (në shkollat profesionale).
 - Ndikim të zbatimit të njohurive dhe shkathtësive të reja nga ana e mësimdhënësve, si: përgatitja më e mirë për orët mësimore, zbatimi i më shumë metodave të mësimdhënies (te shkollat fillore dhe të mesme të

ulëta); ulje të braktisjes (te gjimnazet) dhe përdorim të më shumë teksteve/materialeve mësimore alternative me nxënës, arritje e rezultate më të larta me nxënës, realizim më i shpeshtë i detyrave të shtëpisë nga ana e nxënësve, hulumtimi/sjellja e materialeve mësimore alternative nga ana e nxënësve, realizimi i së paku 2 projekteve mësimore nga ana e nxënësve, ulja e braktisjes së shkollimit, përmirësimi i komunikimit me prindër, informimi i prindërve për rezultatet e nxënësve (te shkollat profesionale).

- Ofrimi i mbështetjes me pajisje të TIK-ut dhe asaj bashkëpunuese për mësimdhënësit, në funksion të zbatimit praktik të njohurive dhe shkathtësive të reja të përfituara në programin e ECDL-së, si bashkëpunimi mbështetës nga ana e nxënësve dhe prindërve që i njohin mirë TIK-un dhe programet kompjuterike (gjimnazet). Ofrimi pajisjeve teknologjike (kompjuter, llaptop, projektor), bashkëpunimi mbështetës nga drejtori/zv. drejtori i shkollës, bashkëpunimi mbështetës me kolegët e lëndës së TIK-ut dhe bashkëpunimi mbështetës me kolegët e së njëjtës lëndë (shkollat profesionale).
- Evidentim të nevojave/kërkesave për mbështetje të vazhdueshme profesionale dhe trajnim shtesë të mësimdhënësve në funksion të zbatimit të njohurive dhe shkathtësive të reja nga ana e mësimdhënësve.

- **Mësimdhënësit e shkollave të përfshira në studim (bazuar në përqindjen e fituar në shkallën më të lartë të vlerësimit) deklarojnë:**

Para trajnimit për programin e ECDL-së:

- Njohuri dhe shkathtësi të mira për përdorimin e programit të Internetit, ndërsa mangësi në përdorimin e programit Power Point;

Pas trajnimit për programin e ECDL-së:

- Njohuri dhe shkathtësi të mira për përdorimin e programit Word, ndërsa mangësi në përdorimin e programit Excel. Duhet potencuar se pas trajnimit lëvizje pozitive për nivelin e njohurive dhe shkathtësive kemi të gjitha programet!
- Zbatim të njohurive dhe shkathtësive të reja të mësimdhënësve, të përfituara përmes programit të ECDL-së, si: krijimi dhe mirëmbajtja e databazave, hulumtimi i materialeve mësimore (shkollat fillore dhe të mesme të ulëta) dhe planifikim të orëve mësimore, përgatitje e materialeve mësimore, përgatitje e testeve për realizim me nxënës, prezantim i materialeve, incizimeve në klasë, përgatitje e raporteve, komunikim me kolegë, nxënës, prindër (shkollat profesionale).
- Angazhimi i nxënësve për përdorimin e TIK-ut në procesin e mësimnxënies:
- Mësimdhënës të ciklit klasor, për hulumtimin e materialeve mësimore në internet;
- Mësimdhënës të Gjuhës amtare, për hulumtimin e materialeve mësimore në internet;
- Mësimdhënës të Gjuhës angleze, për hulumtimin e materialeve mësimore në internet;
- Mësimdhënës të Arteve (vizatim, muzikë), për hulumtimin e materialeve mësimore në internet;
- Mësimdhënës të Matematikës, për informim në karrierë në internet;
- Mësimdhënës të shkencave të natyrës (Fizikë, Biologji, Kimi), për hulumtimin e materialeve mësimore;

- Mësimdhënës të shkencave shoqërore (Gjeografi, Edukatë qytetare, Psikologji, Sociologji, Jeta dhe puna), për hulumtimin e materialeve mësimore në internet;
- Mësimdhënës të teknologjisë me TIK, për hulumtimin e materialeve mësimore në internet;
- Mësimdhënës të Edukatës fizike, për komunikim
- në 'Messenger' lidhur me detyrat mësimore;
- Mësimdhënës të lëndëve profesionale, për hulumtimin e materialeve mësimore në internet.
- Arsyetim për moszbatim të plotë të njohurive dhe shkathtësive të reja në procesin e mësimdhënies dhe nxënies, si ndjenja pasigurisë për përdorimin e pajisjeve dhe programeve kompjuterike, ndjenja e rehatisë me mësimdhënie pa përdorim të teknologjisë së informacionit në procesin arsimor, ndikimi i përdorimit të TIK-t dhe programeve kompjuterike në suksesin e nxënësve, mungesa e pajisjeve në shkolla etj.
- Ndikim të zbatimit të njohurive dhe shkathtësive të reja nga ana e mësimdhënësve si: përdorimi i më shumë metodave të mësimdhënies, rezultate më të larta mësimore nga ana e nxënësve, kryerja më e shpeshtë e detyrave të shtëpisë, hulumtimi i materialeve mësimore nga ana e nxënësve, komunikimi me prindër, informimi më i mirë i prindërve për rezultatet dhe sjelljet e nxënësve, ulja e shkallës së braktisjes së shkollës (shkollat fillore dhe të mesme të ulëta), realizimi i së paku 2 projekteve mësimore nga ana e nxënësve (gjimnazet), përgatitja për orët mësimore, përdorim i më shumë teksteve/materialeve mësimore alternative me nxënës(shkollat profesionale).
- Ofrimi i mbështetjes me pajisje të TIK-ut dhe asaj bashkëpunuese për mësimdhënësit në funksion të zbatimit praktik të njohurive dhe shkathtësive të reja të

përfituara në programin e ECDL-së, si: Ofrimi i fotokopjes (në shkolla fillore dhe të mesme të ulëta), ofrimi i kompjuterëve/laptopëve (në gjimnaze) dhe ofrimi i projektorit (në shkolla profesionale).

- Evidentim të nevojave/kërkesave për mbështetje të vazhdueshme profesionale dhe pajisje të shkollave me *kompjuterë/laptopë dhe pajisje përcjellëse*, në funksion të zbatimit të njohurive dhe shkathtësive të reja nga ana e mësimitdhënësve.

Deklarimet e nxënësve të klasës së pestë (bazuar në përqindjet, te vlerësimi maksimal kemi):

- Zbatimi i TIK-ut dhe programeve kompjuterike nga mësimitdhënësit e lëndëve gjuhësore dhe të matematikës;
- Angazhimi i nxënësve nga ana e mësimitdhënësve për përdorimin e TIK-ut dhe programeve kompjuterike për kryerjen e detyrave të shtëpisë;
- Përdorimi i TIK-ut dhe programeve kompjuterike jashtë angazhimit nga mësimitdhënësit për komunikuar me shokë/shoqe në e-mail, 'Facebook', 'Twiter'.

Deklarimet e nxënësve të klasës së nëntë (bazuar në përqindjet, te vlerësimi maksimal kemi):

- Zbatimi i TIK-ut dhe programeve kompjuterike nga mësimitdhënësit e lëndës së Informatikës;
- Angazhimi i nxënësve nga ana e mësimitdhënësve për përdorimin e TIK-ut dhe programeve kompjuterike për hulumtimin e materialeve mësimore në internet;
- Përdorimi i TIK-ut dhe programeve kompjuterike jashtë angazhimit për komunikuar me shokë/shoqe në e-mail, 'Facebook', 'Twiter'.

Deklarimet e nxënësve të klasës së dymbëdhjetë (bazuar në përqindjet, te vlerësimi maksimal kemi:

- Zbatimi i TIK-ut dhe programeve kompjuterike nga mësimdhënësit e lëndëve shkencore;
- Angazhimi i nxënësve nga ana e mësimdhënësve për përdorimin e TIK-ut dhe programeve kompjuterike për hulumtimin e materialeve mësimore në internet;
- Përdorimi i pajisjeve të TIK-ut, si projektori dhe kompjuteri, nga ana e mësimdhënësve në procesin e mësimdhënies;
- Angazhimi i nxënësve nga ana e mësimdhënësve për përdorimin e TIK-ut dhe programeve kompjuterike për përgatitjen e detyrave mësimore;
- Përdorimi i TIK-ut dhe programeve kompjuterike jashtë angazhimit për detyra mësimore.

Rekomandime

Vazhdimi i përkrahjes së mësimdhënësve në zhvillimin e kompetencave të tyre për përdorimin e TIK-ut dhe programeve kompjuterike në procesin e mësimdhënies dhe nxënies është proces që kërkon krijimin e mekanizmave të qëndrueshëm, për përkrahje të vazhdueshme dhe azhurnim të inovacioneve në fushën e TIK-ut. Rol të veçantë duhet të luajnë MASHT-i, DKA-të dhe shkollat.

Bazuar në gjetjet e studimit (të pasqyruara në raport), mund të nxirren këto rekomandime:

MASHT-i të vazhdojë trajnimin e të gjithë mësimdhënësve të arsimit parauniversitar të Kosovës për programin e ECDL-së, si dhe të mentorojë dhe monitorojë punën e mësimdhënësve të certifikuar për programin e ECDL-së. Të iniciojë programe

trajnimi për mbështetjen e vazhdueshme të mësimit në funksion të zbatimit të njohurive dhe shkathtësive të reja, të përfituara përmes programit të ECDL-së, në procesin e mësimit dhe nxënies.

DKA-të të pajisin shkollat me infrastrukturë të teknologjisë (kompjuterë, llaptopë, fotokopje, projektorë, bimerë etj.), në rastet kur mungojnë ato, si dhe të themelojnë organizma për mbikëqyrjen dhe funksionalizimin e pajisjeve të TIK-ut në shkollat që tashmë e kanë një sistem të tillë të pajisjeve. Të mbështesin shkollat me sistem funksional të rrjetit të internetit, t'i japin prioritet zhvillimit profesional të stafit të mësimit dhe drejtorëve të shkollave për TIK-un, të iniciojnë bashkëpunim me prindërit, nxënësit dhe komunitetin e shkollës për fuqizimin e zbatimit të njohurive dhe shkathtësive për TIK dhe programe kompjuterike në procesin e mësimit dhe nxënies.

Shkollat të angazhohen për ngritjen/shfrytëzimin e kapaciteteve brenda shkollave për përdorimin e TIK-ut në procesin e mësimit dhe nxënies (trajnimi me bazë në shkollë); të themelojnë mekanizma për mbikëqyrjen/funksionalizimin e pajisjeve të TIK-ut, të cilët tashmë i posedojnë shkollat, por që për arsye të ndryshme janë jashtë përdorimit ose nuk janë në shfrytëzim fare nga mësimit.

Referencat

1. Universiteti Amerikan në Kosovë (2013), TeachECDL - AUK MasterFile, 2013.
2. Instituti Pedagogjik i Kosovës (82012), Zhvillimi i kompetencave për TIK dhe gjuhë angleze, perspektivë për integrim në epokën digjitale.
3. European Computer Driving License (ECDL), <http://www.aukonline.org/>
4. MASHT (2011): Korniza e Kurrikulës, Prishtinë.
5. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë: Planet dhe programet mësimore të lëndës mësimore, Teknologjia me TIK (klasat 6 -9 dhe klasat 10- 12/13), Prishtinë.
6. Qeveria e Republikës së Kosovës (2010), Plani i Veprimit 2010 për Implementimin e Partneritetit Evropian për Kosovën, Prishtinë.
7. UNESCO (2005): *ICT in Schools*.
8. Studie zum Europäischen Computerführerschein ECDL (2008): *Schüler finden schneller in der Beruf-* DLGI Bonn, . www.pressebox.de/pressemeldungen/dlgi.
9. Trajnimi dhe certifikimi në programin ECDL-AUK, 2010 <http://www.cactus.com>.
10. Vildane Kelmendi (2009), Promovimi i mundësive të bashkëpunimit në TIK dhe dialogut rreth politikave me Shtetet e Ballkanit Perëndimor, CACTTUS – zyra në Kosovë.
11. Wolfgang Vaupel und Bernd Hoffmann: Ausstattung für das Lernen mit neuen Medien, www.e-nitiative.nrw.de

Shtojca

Shtojca 1. Pyetësor për drejtorë/zv.drejtorë

I nderuar drejtor/zv.drejtor,

Instituti Pedagogjik i Kosovës është duke realizuar studimin *Trajnimi i mësimitdhënësve për programin e ECDL-së (zbatimi dhe ndikimi në mësimitdhënie dhe nxënie)*.

Qëllimi i pyetësorit është të vlerësojë ndikimin e trajnimit të mësimitdhënësve për programin e ECDL-së në përdorimin e TIK-ut në procesin e mësimitdhënies dhe nxënies. Informacioni që do të jepni është anonim dhe do të përdoret vetëm për arsye studimi.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!

1	Tipi i shkollës	1	Filllore (1-5)
		2	E mesme e ulët (6-9)
		3	Gjimnaz
		4	Shkollë profesionale

2	Gjinia	1	femërore
		2	maskullore

3	Mosha	1	25-30 vjeç
		2	31 – 40 vjeç
		3	41 -50 vjeç
		4	mbi 50 vjeç

4	Kualifikimi im profesional- niveli i fundit	1	Shkollë e lartë
		2	Fakultet
		3	Studimet MASTER
		4	Doktoratë

5	Programi ECDL: Në Modulin 1- Bazat e teknologjisë së informimit dhe komunikimit (ICT)	1	Kam vijuar ligjëratat
		2	Jam testuar 1 herë
		3	Jam testuar dy herë e më shumë
		4	Kam kaluar modulin përkatës
6	Në Modulin 2- Shfrytëzimi i kompjuterit dhe menaxhimi i fajllave (Windows XP)	1	Kam vijuar ligjëratat
		2	Jam testuar 1 herë
		3	Jam testuar dy herë e më shumë
		4	Kam kaluar modulin përkatës
7	Në Modulin 3- Përpunimi i teksteve (Word)	1	Kam vijuar ligjëratat
		2	Jam testuar 1 herë
		3	Jam testuar dy herë e më shumë
		4	Kam kaluar modulin përkatës
8	Në Modulin 4- Kalkulimi i tabelave (Excel)	1	Kam vijuar ligjëratat
		2	Jam testuar 1 herë
		3	Jam testuar dy herë e më shumë
		4	Kam kaluar modulin përkatës
9	Në Modulin 5- Baza e të dhënave (Access)	1	Kam vijuar ligjëratat
		2	Jam testuar 1 herë
		3	Jam testuar dy herë e më shumë
		4	Kam kaluar modulin përkatës
10	Në Modulin 6- Prezantimet (Power Point)	1	Kam vijuar ligjëratat
		2	Jam testuar 1 herë
		3	Jam testuar dy herë e më shumë
		4	Kam kaluar modulin përkatës

11	Në modulën 7 -Interneti dhe komunikimi (Internet Explorer & Outlook)	1	Kam vijuar ligjëratat
		2	Jam testuar 1 herë
		3	Jam testuar dy herë e më shumë
		4	Kam kaluar modulën përkatës

4= Plotësisht, 3= Mesatarisht, 2= Pak, 1= Aspak

12	Unë jam i kënaqur me zbatimin e njohurive dhe shkathtësive të reja nga ana e mësimitdhënësve.	4	3	2	1
13	Unë jam i kënaqur me ndikimin e njohurive dhe shkathtësive të reja në procesin e mësimitdhënies dhe nxënies.	4	3	2	1
14	Unë jam i kënaqur me mbështetjen që ofron shkolla në funksion të realizimit të njohurive dhe shkathtësive të reja.	4	3	2	1

5 = Çdoherë, 4 = Shpeshherë, 3 = Nganjëherë, 2 = Rrallëherë, 1 = Asnjëherë

15	Mësimitdhënësit hartojnë plane pune me kompjuter.	5	4	3	2	1
16	Mësimitdhënësit hartojnë materiale mësimore me kompjuter.	5	4	3	2	1
17	Mësimitdhënësit hartojnë me kompjuter teste për realizim me nxënës.	5	4	3	2	1
18	Mësimitdhënësit prezantojnë materiale dhe incizime në klasë me projektor.	5	4	3	2	1
19	Mësimitdhënësit dorëzojnë raporte pune të shkruara me kompjuter.	5	4	3	2	1
20	Mësimitdhënësit krijojnë databaza(statistika) me kompjuter.	5	4	3	2	1
21	Mësimitdhënësit kompjuterin e përdorin për hulumtimin e materialeve mësimore.	5	4	3	2	1
22	Mësimitdhënësit komunikojnë me mua me e-mail.	5	4	3	2	1
23	Mësimitdhënësit komunikojnë me prindër me	5	4	3	2	1

e-mail.					
---------	--	--	--	--	--

4= Plotësisht, 3= Mesatarisht, 2= Pak, 1= Aspak					
24	Mësimdhënësit tani janë më mirë të përgatitur për orën mësimore.	4	3	2	1
25	Mësimdhënësit zbatojnë më shumë alternative të mësimdhënies.	4	3	2	1
26	Mësimdhënësit përdorin më shumë tekste/materiale alternative me nxënës.	4	3	2	1
27	Rezultatet mësimore të nxënësve janë më të larta.	4	3	2	1
38	Nxënësit kryejnë më shpesh detyrat e shtëpisë.	4	3	2	1
39	Nxënësit realizojnë së paku nga 2 projekte arsimore për një gjysmëvjetor.	4	3	2	1
30	Nxënësit hulumtojnë dhe sjellin material alternative mësimore.	4	3	2	1
31	Komunikimi me prindër është më i mirë.	4	3	2	1
32	Prindërit janë më mirë të informuar për rezultatet dhe sjelljet e fëmijëve.	4	3	2	1
33	Braktisja e shkollës është ulur dukshëm.	4	3	2	1

5 = Çdoherë, 4 =Shpeshherë, 3 =Nga njëherë, 2 = Rrallëherë, 1 =Asnjëherë						
34	Për punën e mësimdhënësve, shkolla ofron kompjuter/laptop.	5	4	3	2	1
35	Për punën e mësimdhënësve, shkolla ofron grafoskop.	5	4	3	2	1
36	Për punën e mësimdhënësve, shkolla ofron projektor.	5	4	3	2	1
37	Për punën e mësimdhënësve, shkolla ofron fotokopje.	5	4	3	2	1
38	Mësimdhënësit kanë bashkëpunim mbështetës me drejtorin e shkollës.	5	4	3	2	1
39	Mësimdhënësit kanë bashkëpunim mbështetës me pedagogun, psikologun.	5	4	3	2	1
40	Mësimdhënësit kanë bashkëpunim mbështetës me kolegët – mësimdhënësit e	5	4	3	2	1

	TIK-ut.					
41	Mësimdhënësit kanë bashkëpunim mbështetës me kolegët e së njëjtës lëndë.	5	4	3	2	1
42	Mësimdhënësit kanë bashkëpunim mbështetës me prindër.	5	4	3	2	1

4= Plotësisht, 3= Mesatarisht, 2= Pak, 1= Aspak						
43	Mendoj se mësimdhënësit kanë nevojë për trajnime shitesë, enkas për përdorimin e TIK-ut, në procesin e mësimdhënies dhe nxënies.	4	3	2	1	
44	Mbështetje të vazhdueshme profesionale në shkollë për zbatimin e programeve të caktuara kompjuterike.	4	3	2	1	
45	Sigurim të kompjuterëve/laptopëve dhe pajisjeve përcjellëse në klasa.	4	3	2	1	

46. Ndonjë koment apo sugjerim që do të mund të jetë i dobishëm për përdorimin e TIK-ut në procesin mësimor dhe identifikimi i mundësive për avancimin e përdorimit të TIK në procesin mësimor:

Shtojca 2. Pyetësor për mësimdhënës

Të nderuar mësimdhënës, ju lutem plotësojeni pyetësorin e mëposhtëm!

Instituti Pedagogjik i Kosovës është duke realizuar studimin *Trajnimi i mësimdhënësve për programin e ECDL-së, zbatimin dhe ndikimin në mësimdhënie dhe nxënie*.

Qëllimi i pyetësorit është të vlerësojë ndikimin e trajnimit të mësimdhënësve për programin e ECDL-së në përdorimin e TIK-ut në procesin e mësimdhënies dhe nxënies. Informacioni që do të jepni është anonim dhe do të përdoret vetëm për arsye studimi.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!

Plotëso pyetësorin duke rrethuar një prej numrave para alternativave të dhëna.			
1	Tipi i shkollës ku jap mësim	1	Filllore
		2	E mesme e ulët
		3	Gjimnaz
		4	Shkollë profesionale
2	Gjinia	1	femërore
		2	mashkullore
3	Mosha	1	25-30 vjeç
		2	31 – 40 vjeç
		3	41 -50 vjeç
		4	mbi 50 vjeç
4	Kualifikimi profesional- niveli i fundit	1	Shkollë e lartë
		2	Fakultet
		3	Studimet MASTER

		4	Doktoratë
5	Klasat ku jap mësim (për mësimdhënësit e klasave 6-9 dhe 10-13, klasat në të cilat keni më shumë orë mësimore)	1	1-5
		2	6-7
		3	8-9
		4	10 -13
6	Fusha/lënda mësimore që unë e mbaj/ligjëroj në shkollë	1	Mësim klasor
		2	Gjuhë amtare
		3	Gjuhë angleze
		4	Artet
		5	Matematikë
		6	Shkencat natyrore
		7	Shkencat shoqërore
		8	Teknologji me TIK
		9	Edukatë fizike
		10	Lëndë profesionale

7	Programi ECDL: Në Modulin 1- Bazat e teknologjisë së informimit dhe komunikimit (ICT)	1	Kam vijuar ligjëratat
		2	Jam testuar 1 herë
		3	Jam testuar më shumë se dy herë
		4	Kam kaluar modulën përkatës
8	Në Modulin 2 - Shfrytëzimi i kompjuterit dhe menaxhimi i fajllave (Windows XP)	1	Kam vijuar ligjëratat
		2	Jam testuar 1 herë
		3	Jam testuar më shumë se dy herë
		4	Kam kaluar modulën përkatës

9	Në Modulin 3 - Përpunimi i teksteve (Word)	1	Kam vijuar ligjëratat
		2	Jam testuar 1 herë
		3	Jam testuar më shumë se dy herë
		4	Kam kaluar modulën përkatës
10	Në Modulin 4- Kalkulimi i tabelave (Excel)	1	Kam vijuar ligjëratat
		2	Jam testuar 1 herë
		3	Jam testuar më shumë se dy herë
		4	Kam kaluar modulën përkatës
11	Në Modulin 5- Baza e të dhënave (Access)	1	Kam vijuar ligjëratat
		2	Jam testuar 1 herë
		3	Jam testuar më shumë se dy herë
		4	Kam kaluar modulën përkatës
12	Në Modulin 6- Prezantimet (Power Point)	1	Kam vijuar ligjëratat
		2	Jam testuar 1 herë
		3	Jam testuar më shumë se dy herë
		4	Kam kaluar modulën përkatës
13	Në modulën 7 -Interneti dhe komunikimi (Internet Explorer & Outlook)	1	Kam vijuar ligjëratat
		2	Jam testuar 1 herë
		3	Jam testuar më shumë se dy herë
		4	Kam kaluar modulën përkatës

5 = të larta, 4= të kënaqshme, 3= të mira, 2= të mjaftueshme, 1= të pamjaftueshme						
14	PARA TRAJNIMIT, njohuritë dhe shkathtësitë e mia për përdorimin e programit Word kanë qenë:	5	4	3	2	1
15	PARA TRAJNIMIT, njohuritë dhe shkathtësitë e mia për përdorimin e programit EXCEL kanë qenë:	5	4	3	2	1
16	PARA TRAJNIMIT, njohuritë dhe shkathtësitë e mia për përdorimin e programit POWER POINT kanë qenë:	5	4	3	2	1
17	PRARA TRAJNIMIT, njohuritë dhe shkathtësitë e mia për përdorimin e INTERNETIT kanë qenë:	5	4	3	2	1
18	PAST RAJNIMIT, njohuritë dhe shkathtësitë e mia për përdorimin e programit WORD janë:	5	4	3	2	1
19	PAS TRAJNIMIT, njohuritë dhe shkathtësitë e mia për përdorimin e programit EXCEL janë:	5	4	3	2	1
20	PAS TRAJNIMIT, njohuritë dhe shkathtësitë e mia për përdorimin e programit POWER POINT janë:	5	4	3	2	1
21	PAS TRAJNIMIT, njohuritë dhe shkathtësitë e mia për përdorimin e INTERNETIT janë:	5	4	3	2	1

5 = Çdoherë, 4 =Shpeshherë, 3 =Nganjëherë, 2 = Rrallëherë, 1 =Asnjëherë						
22	Tani, kompjuterin unë e përdor për planifikim të orëve mësimore.	5	4	3	2	1
23	Tani, kompjuterin unë e përdor për përgatitje të materialeve mësimore.	5	4	3	2	1
24	Tani, kompjuterin unë e përdor për përgatitje të testeve për realizim me	5	4	3	2	1

	nxënës.					
25	Tani, kompjuterin unë e përdor për prezantim të materialeve, incizimeve në klasë.	5	4	3	2	1
26	Tani, kompjuterin unë e përdor për përgatitje të raporteve.	5	4	3	2	1
27	Tani, kompjuterin unë e përdor për krijimin dhe mirëmbajtjen e databazave(statistikave).	5	4	3	2	1
28	Tani, kompjuterin unë e përdor për hulumtimin e materialeve mësimore.	5	4	3	2	1
29	Tani, kompjuterin unë e përdor për komunikim me kolegë, nxënës, prindër.	5	4	3	2	1

5 = Çdoherë, 4 =Shpeshherë, 3 =Nganjëherë, 2 = Rrallëherë,1 =Asnjëherë						
30	Për punën time, shkolla ofron kompjuter/llaptop.	5	4	3	2	1
31	Për punën time, shkolla ofron grafoskop.	5	4	3	2	1
32	Për punën time, shkolla ofron projektor.	5	4	3	2	1
33	Për punën time, shkolla ofron fotokopje.	5	4	3	2	1
34	Kur shkolla nuk ofron, unë e përdor kompjuterin/llaptopin privat.	5	4	3	2	1
35	Kur shkolla nuk ofron, unë e përdor kompjuterin/llaptopin e kolegëve.	5	4	3	2	1
36	Kur shkolla nuk ofron, unë e përdor kompjuterin/llaptopin me pagesë (internet kafe, etj.)	5	4	3	2	1
37	Kur shkolla nuk ofron, unë përdor	5	4	3	2	1

	fotokopje private					
38	Kur shkolla nuk ofron, unë përdor fotokopje me pagesë	5	4	3	2	1
39	Kur shkolla nuk ofron, unë përdor projektor privat.	5	4	3	2	1

40	Unë nuk i përdor pajisjet kompjuterike (kompjuterin, llaptopin, projektorin, grafoskopin) në mësim sepse:	1	Nuk e ndiej veten ende të sigurt për përdorimin e teknologjisë së informacionit në procesin mësimor.
		2	Ndihem më rehat me mësimdhënie pa përdorim të teknologjisë së informacionit në procesin arsimor.
		3	Përdorimi i teknologjisë së informacionit në mësimdhënie ka ndikuar negativisht në suksesin e nxënësve.
		4	Nxënësit nuk i përgjigjen kërkesave për përdorim të teknologjisë së informacionit në punën e tyre arsimore

5 = Çdoherë, 4 = Shpeshherë, 3 = Nganjëherë, 2 = Rrallëherë, 1 = Asnjëherë						
41	Tani unë i angazhoj nxënësit për përgatitjen e detyrave mësimore me kompjuter:	5	4	3	2	1

42	Unë i angazhoj nxënësit për hulumtimin e materialeve mësimore në internet:	5	4	3	2	1
43	Unë i angazhoj nxënësit për përgatitje të materialeve për prezantim me Power Point:	5	4	3	2	1
44	Unë i angazhoj nxënësit për informim në karrierë në internet:	5	4	3	2	1
45	Unë i angazhoj nxënësit për komunikim në 'Messenger' lidhur me detyrat mësimore:	5	4	3	2	1
46	Unë i angazhoj nxënësit për komunikim në e-mail lidhur me shkollën:	5	4	3	2	1
47	Unë i angazhoj nxënësit për komunikim në 'Facebook' ose 'Twitter' lidhur me shkollën:	5	4	3	2	1

5 = Çdoherë, 4 = Shpeshherë, 3 = Nganjëherë, 2 = Rrallëherë, 1 = Asnjëherë

48	Unë kam bashkëpunim mbështetës me drejtorin e shkollës për realizim në praktikë të njohurive të fituara në programin e ECDL-së:	5	4	3	2	1
49	Unë kam bashkëpunim mbështetës me pedagogun, psikologun për realizim në praktikë të njohurive të fituara në programin e ECDL-së:	5	4	3	2	1
50	Unë kam bashkëpunim mbështetës me kolegët – mësimitdhënësit e TIK-ut për realizim në praktikë të	5	4	3	2	1

	njohurive të fituara në programin e ECDL-së:					
51	Unë kam bashkëpunim mbështetës me kolegët e së njëjtës lëndë për realizim në praktikë të njohurive të fituara në programin e ECDL-së:	5	4	3	2	1
52	Unë kam bashkëpunim mbështetës me prindër për realizim në praktikë të njohurive të fituara në programin e ECDL-së:	5	4	3	2	1
53	Unë kam bashkëpunim mbështetës me nxënës që njohin TIK-un për realizim në praktikë të njohurive të fituara në programin e ECDL-së:	5	4	3	2	1

4= Plotësisht, 3= Mesatarisht, 2= Pak, 1= Aspak						
54	Trajnimi më ka ndihmuar, sepse unë jam më mirë e përgatitur për orën mësimore:	4	3	2	1	
55	Unë përdor më shumë alternativa të mësimdhënies:	4	3	2	1	
56	Unë përdor më shumë tekste/materiale alternative me nxënës:	4	3	2	1	
57	Rezultatet mësimore të nxënësve janë më të larta:	4	3	2	1	
58	Nxënësit kryejnë më shpesh detyrat e shtëpisë:	4	3	2	1	
59	Nxënësit realizojnë së paku nga 2 projekte arsimore për një gjysmëvjetor:	4	3	2	1	
60	Nxënësit hulumtojnë dhe sjellin material alternative mësimore:	4	3	2	1	

61	Komunikimi me prindër është më i mirë:	4	3	2	1
62	Prindërit janë më mire të informuar për rezultatet dhe sjelljet e fëmijëve:	4	3	2	1
63	Braktisja e shkollës është ulur dukshëm:	4	3	2	1

64	Mendoj se kam nevojë për trajnime shtesë, enkas për përdorimin e TIK-ut në procesin e mësimdhënies dhe nxënies:	4	3	2	1
65	Mbështetje të vazhdueshme profesionale në shkollë për zbatimin e programeve të caktuara kompjuterike:	4	3	2	1
66	Sigurim të kompjuterëve/llaptopëve dhe pajisjeve përcjellëse në klasë:	4	3	2	1

Shtojca 3. Pyetësor për nxënës - 5

Të nderuar nxënës, ju lutem plotësojeni pyetësorin e mëposhtëm!

Instituti Pedagogjik i Kosovës është duke realizuar studimin *Trajnimi i mësimdhënësve për programin e ECDL-së, zbatimi dhe ndikimi në mësimdhënie dhe nxënie*.

Qëllimi i pyetësorit është të vlerësojë ndikimin e trajnimit të mësimdhënësve për programin e ECDL-së në përdorimin e TIK-ut në procesin e mësimdhënies dhe nxënies. Informacioni që do të jepni është anonim dhe do të përdoret vetëm për arsye studimi.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!

I. Plotëso pyetësorin duke rrethuar një prej numrave para alternativave të dhëna.

1	Lokacioni i shkollës suaj	1	fshat
		2	qytet
2	Gjinia	1	femër
		2	mashkull
3	Unë mund të shkruaj tekste me kompjuter	1	po
		2	jo
4	Unë mund të vizatoj dhe të ngjyros forma të ndryshme me kompjuter	1	Po
		2	jo
5	Unë mund të luaj lojëra me kompjuter	1	po
		2	jo
6	Unë mund të komunikoj me e-mail	1	Po
		2	jo
7	Njohuritë dhe shkathtësitë për përdorimin e programeve kompjuterike i kam fituar:	1	Në shkollë
		2	Në shtëpi dhe në mënyrë të pavarur
		3	Në shtëpi dhe me

			përkrahjen e të tjerëve
		4	Në kurse për përdorimin e kompjuterit
		5	Në internet-kafe
8	Kurse për përdorimin e kompjuterit që kam ndjekur:	1	një
		2	dy
		3	mbi tre
		4	asnjë
9	NË LËNDËN E GJUHËS SHQIPE, mësimdhënësi e përdor kompjuterin në mësimdhënie.	1	po
		2	jo
10	NË LËNDËN E GJUHËS ANGLEZE, mësimdhënësi e përdor kompjuterin në mësimdhënie.	1	po
		2	jo
11	NË LËNDËN E MATEMATIKËS mësimdhënësi e përdor kompjuterin në mësimdhënie.	1	po
		2	jo
12	NË LËNDËN E ARTIT mësimdhënësi e përdor kompjuterin në mësimdhënie.	1	po
		2	jo
13	NË LËNDËN E MUZIKËS mësimdhënësi e përdor kompjuterin në mësimdhënie.	1	po
		2	jo
14	Unë e përdor kompjuterin për hulumtim të materialeve mësimore në internet.	1	po
		2	jo
15	Unë e përdor kompjuterin për kryerjen e detyrave të shtëpisë me kompjuter.	1	po
		2	jo
16	Kur mësimdhënësit më angazhojnë për të kryer detyra të shtëpisë me kompjuter, unë i kryej ato.	1	po
		2	jo
17	Jashtë shkollës, unë e përdor kompjuterin për kryerjen e detyrave mësimore.	1	po
		2	jo
18	Jashtë shkollës, unë e përdor kompjuterin për hulumtimin e materialeve mësimore në internet.	1	po
		2	jo

19	Jashtë shkollës ,unë e përdor kompjuterin për komunikim në e-mail, ‘Facebook’, ‘Twiter’ etj.	1	po
		2	jo

20. Çfarë dëshironi të bëheni/studioni në të ardhmen?

Shtojca 4. Pyetësor për nxënës të klasës së 9-të dhe klasës së 12-të

Të nderuar nxënës, ju lutem plotësojeni pyetësin e mëposhtëm!

Instituti Pedagogjik i Kosovës është duke realizuar studimin *Trajnimi i mësimdhënësve për programin e ECDL-së, zbatimi dhe ndikimi në mësimdhënie dhe nxënie*.

Qëllimi i pyetësit është të vlerësojë ndikimin e trajnimit të mësimdhënësve për programin e ECDL-së në përdorimin e TIK-ut në procesin e mësimdhënies dhe nxënies. Informacioni që do të jepni është anonim dhe do të përdoret vetëm për arsye studimi.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!

I. Plotëso pyetësin duke rrethuar një prej numrave para alternativave të dhëna.

1	Tipi i shkollës	1	Gjimnaz
		2	Shkollë profesionale

2	Gjini a	1	femër
		2	maskull
5= Të larta, 4= Të kënaqshme, 3= Të mira, 2 = Të mjaftueshme, 1 = Të pamjaftueshme			

3	Njohuritë dhe shkathtësitë e mia për përdorimin e programit WORD janë :	5	4	3	2	1
4	Njohuritë dhe shkathtësitë e mia për përdorimin e programit EXCEL janë :	5	4	3	2	1
5	Njohuritë dhe shkathtësitë e mia për përdorimin e programit POWER POINT janë:	5	4	3	2	1
6	Njohuritë dhe shkathtësitë e mia për përdorimin e INTERNETIT janë:	5	4	3	2	1

5 =Word, 4 = Power Point, 3 = Excel, 2 = Internet, 1 = Asnjërin						
7	Mësimdhënësit e lëndës së INFORMATIKËS në klasën time përdorin më së shpeshti programin:	5	4	3	2	1
8	Mësimdhënësit e LËNDËVE GJUHËSORE në klasën time përdorin më së shpeshti programin:	5	4	3	2	1
9	Mësimdhënësit e LËNDËVE SHKENCORE në klasën time përdorin më së shpeshti programin:	5	4	3	2	1
10	Mësimdhënësit e LËNDËVE ARTISTIKE në klasën time përdorin më së shpeshti programin:	5	4	3	2	1
11	Mësimdhënësit e lëndës së INFORMATIKËS në klasën time përdorin më së shpeshti programin:	5	4	3	2	1

5= Gjatë gjithë orës, 4= Vetëm në fazën hyrëse të orës mësimore,3= Vetëm gjatë zhvillimit të temës, 2= Vetëm gjatë vlerësimit, 1= Nuk përdoret fare						
12	Mësimdhënësit në klasën time më së shpeshti KOMPJUTERIN e përdorin:	5	4	3	2	1

13	Mësimdhënësit në klasën time më së shpeshti PROJEKTORIN e përdorin:	5	4	3	2	1
14	Mësimdhënësit në klasën time më së shpeshti GRAFOSKOPIN e përdorin:	5	4	3	2	1
5 = Çdoherë, 4 = Shpeshherë, 3 = Nganjëherë, 2 = Rrallëherë, 1 = Asnjëherë						
15	Mësimdhënësit më angazhojnë mua për përgatitjen e detyrave mësimore me kompjuter:	5	4	3	2	1
16	Mësimdhënësit më angazhojnë mua për hulumtimin e materialeve mësimore në internet:	5	4	3	2	1
17	Mësimdhënësit më angazhojnë mua për përgatitje të materialeve për prezantim me Power Point:	5	4	3	2	1
18	Mësimdhënësit më angazhojnë mua për informim në karrierë në internet:	5	4	3	2	1
19	Mësimdhënësit më angazhojnë mua për komunikim në 'Messenger' lidhur me detyrat mësimore:	5	4	3	2	1
20	Mësimdhënësit më angazhojnë mua për komunikim në e-mail lidhur me shkollën:	5	4	3	2	1
21	Mësimdhënësit më angazhojnë mua për komunikim në 'Facebook' ose 'Twitter' lidhur me shkollën:	5	4	3	2	1
22	JASHTË SHKOLLËS, unë e përdor kompjuterin për detyra mësimore:	5	4	3	2	1

23	JASHTË SHKOLLËS, unë e përdor kompjuterin për hulumtimin e materialeve mësimore në internet:	5	4	3	2	1
24	JASHTË SHKOLLËS, unë e përdor kompjuterin për përgatitjen e materialeve mësimore për prezantim me Power Point:	5	4	3	2	1
25	JASHTË SHKOLLËS, unë e përdor kompjuterin për informim në karrierë në internet.	5	4	3	2	1
26	JASHTË SHKOLLËS, unë e përdor kompjuterin për komunikim në 'Messenger'.	5	4	3	2	1
27	JASHTË SHKOLLËS, unë e përdor kompjuterin për komunikim në e-mail:	5	4	3	2	1
28	JASHTË SHKOLLËS , unë e përdor kompjuterin për komunikim në 'Facebook' ose 'Twiter':	5	4	3	2	1
29	JASHTË SHKOLLËS , unë e përdor kompjuterin për lojëra:	5	4	3	2	1

30. Profesioni në të ardhmen

Shtojca 5. Komunat dhe shkollat përkatëse të përfshira në hulumtim

Komunat dhe shkollat përkatëse të përfshira në hulumtim	
Prishtinë	Sami Frashëri
	Gjin Gazuli
	Emin Duraku
	Vllëzërit Frashëri
Pejë	Bedri Pejani
	Ali Hadri
	Asdreni
	Skender Çeku
Prizren	Remzi Ademaj
	po po Marsi
	Mustafa Bakiu
	Naim Frashëri
Gjakovë	Hajdar Dushi
	Nexhmedin Nixha
	Emin Duraku
	Gjergj Fishta
Gjilan	Zenel Hajdini
	Arbëria
	Selami Hallaqi
	Ibrahim Uruqi
Ferizaj	Shemsedin Hashani
	Pjetër Bogdani
	Tefik Çanga
	Ismail Qemaili
Mirtovicë	Frang Bardhi
	Arkitekt Sinani
	A.Z.Çajupi
	Enver Hadri

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

37.09(496.51)(047)

Dervisholli-Zylfiu, Haxhere

Trajnimi i mësimdhënësve për programin e ECDL-së (zbatimi dhe ndikimi në mësimdhënie dhe nxënie): raport i studimit kërkimor / Haxhere Dervisholli-Zylfiu. – Prishtinë: Instituti Pedagogjik i Kosovës, 2013. – 126 f. : ilustr.; 22 cm.

Shkurtesat : f. 5. - Referencat : f. 104

ISBN 978-9951-591-09-6